

# Mid'hat Frashëri

BIBLIOTEKA

949.65

F.84

**SHQIPTARË DHE SLLAVË**




Shtëpia Botuese  
"LUMO SKËNDO"

949.65  
F84

Mid'hat Frashëri

SHQIPTARË  
DHE SLLAVË

Me parathënie të studiuesit  
EUGEN SHEHU



Shtëpia Botuese "Lumo Skëndo"  
Tiranë, 1999

## **Mid'hat Frashëri** **apostull i shqiptarizmës**

*Për herë të parë, në Lozanë kam shkuar në pranverën e vitit 1986. Qyteti buzë liqenit më bëri për vehte, duke më lënë një përshtypje gati-gati të papërballueshme. Shtëpitë e stilit gjermanik ndanë udhëve të pastra, fshiheshin mes gjelbërimit të paanë, sikur të kishin frikë prej zhurmave të metropolit. Krejt i ri në moshë, i larguar prej gurëve dhe drurëve të Gostivarit, i ndjekur prej UDB-së jugosllave, ndërtesat e Lozanës, gjithsesi, do të më ngjanin se ruanin plot mistere brenda tyre.*

*Për hir të së vërtetës, duhet të them se më vonë, disa vite më pas, kam mësuar se në njërin prej këtyre shtëpive, në pranverën e vitit 1919 Mid'hati ynë i madh kishte shkruar, pothuajse me një frymë, veprën madhore "Shqiptarë dhe Sllavë" për ta botuar po në këtë qytet në Librarinë Qendrore të Nacionaliteteve. Pak kohë më parë, ndërsa lexoja "Letra mbi një udhëtim në Zvicër", nisa të mësoja gati përmendësh disa rrjeshta të Mid'hatit të tilla, si:*

*"Disa vise malore më sjellin përpara syve Tomoricën. Por të them të vërtetë Tomorri më ngjan se ka një bukuri dhe madhështi më të madhe. Edhe liqeni i Ohrit*

është më i bukur se liqeni Lemman i Lozanës, për të cilën Volteri ka shkruar se është më i bukuri liqen i dheut...<sup>(1)</sup> Sigurisht ky apostull i shqiptarizms, nuk do të mund të fshihte asnjherë dimensionin fluid dhe njerëzor të mallit për Atdheun e vet. Gjithsesi, rasti fatlum e solli që unë të marr nismën dhe të botoj "Shqiptarë e Sllavë", duke krijuar raporte krejt intime me veprën e Mid'hatit dhe vetë Lozanën, të parë, së fundi, nën një dritë tjetër.

Veprat esseistike të Mid'hatit, veçmas, si këto të llojit "Shqiptarë dhe Sllavë" përbëjnë kulme.

Ato u ngjajnë atyre lumenjve që gurgullojnë plot jetë, zajeve të shkretëtirave dogmatike të viteve që na i vranë diktaturat. Kohrat provuan se lumenj të tillë nuk mund të shterrin, sepse të vërtetat e mëdha janë ngjizur me shpirtin e popullit.

Përse Mid'hati ynë zgjodhi pikërisht Lozanën dhe Librarinë e Nacionaliteteve për të publikuar veprën e tij? A mund të pranohet një fakt i tillë si rastësi? Le të thërrasim në ndihmë historinë!

Është pranuar, tanimë, se mbarimi i Lutës së Parë Botërore, shpuri "fitimtarët" në ngazëllimin iluzor për hegjemoni të reja. Rrethanat e krijuara ua lehtësonin këto pririje, edhe pse rrezikonin drejt për se drejti territore dhe popuj krejt të pafajshëm e të pafuqishëm. Në këto momente, Shqipëria u gjend krejtësisht e lakmuar prej fqinjëve, për më tepër nën diktatin e fuqive të mëdha. Është kjo arsyeja që mbarimi i vitit 1918 e gjen vendin tonë në një valë të gjerë të shpërthimit të manifestimeve kundër pushtimit të huaj, si dhe të kërkesave për bash-

kimin e krejt trojeve tona etnike. Madje, nga disa grupe patriotësh, u kalua në kërkesa, që, të gjitha krahinat shqiptare të mbetura jashtë kufijve politikë të caktuar padrejtësisht në vitin 1913 të viheshin nën kontrollin e ushtrive fituese të luftës.

Përballë trilleve të fatit historik, shqiptarët ndjenë, së pari, nevojën e një qeverie, e cila, tek e mbramja, do të drejtonte popullin drejt një pavarësie të re dhe përgjithësisht në rrjedhat e bashkimit kombëtar. E rëndësishme shihej, gjithashtu, në planin diplomatik qëndrimi që duhej të mbanin anëtarët e kësaj qeverie në Kongresin e Paqes në Paris, i cili ishte, thuhajse, në prag.

Një grup atdhetarësh, në fillim të dhjetorit 1918, propozuan Shkodrën për mbajtjen e një kuvendi me përfaqësues nga e gjithë Shqipëria, ku mund të zgjidhej një qeveri e përkohshme. Por ishte ushtaraku francez Furtu, që e komandonte garnizonin ndërraleat, i cili nuk e lejoi mbajtjen e këtij kuvendi.

Gjithsesi, përpjekjet e parreshtura u kurorëzuan në Kongresin e Durrësit më 25 dhjetor 1918. Në këtë kongres nuk u lejuan të vinin përfaqësuesit e Vlorës, nga komanda italiane, pasi populli trim vlonjat kishte organizuar një muaj më parë më 28 nëntor një manifestim të fuqishëm, kundër synimeve aneksioniste italiane. Gjithashtu, nuk u përfaqësuan këtu as Korça dhe Pogradeci të pushtuara prej francezëve, as Luma dhe Peshkopia të robëruara prej serbit. I përshëndetur dhe i mbështetur prej rretheve përparimtare të kohës, Kongresi i Durrësit do të zgjidhte qeverisë e përkohshme e pas kësaj

## *Apostull i Shqiptarizmës*

---

përbërjen e delegacionit për në Konferencën e Paqes në Paris. Në krye të këtij delegacioni u caktua kryeministri Turhan Pasha, ndërsa anëtarë do të ishin Mehmet Konica, Mid'hat Frashëri, Mihal Turtulli dhe Luigj Bumçi. Historiografia komuniste, jo pa qëllim ka lënë në heshtje veprimtarinë e gjerë të birit të Frashërlinjve. Për më tepër, (për humor të saj, natyrisht) e ka cilësuar Mid'hatin, si pro amerikan, pa u thelluar në atë se ndjenjat e tij ndaj demokracisë amerikane i rritën së tepërmi nivelet e veprimtarisë diplomatike të tij.

Përpos të tjerave, atdhetarë nga e gjithë Shqipëria të mbledhur në Durrës, u deklaruan haptaz dhe të vendosur që, jo vetëm të mos e njihnin, por edhe të luftonin me çfarëdo mjeti vendimet e marra nga Traktati i Fshehtë i Londrës, vendime këto që cënonin tërësinë territoriale të Shqipërisë. U quajt jo vetëm e turpshme, por edhe e mbrapshtë pika VI e këtij traktati, e cila i njihnte Italisë sovranitetin mbi Vlorën dhe rrethinat. Njëherazi në pikën VII theksohej se Italia nuk mund të kundërshtonte pushtimin prej grekëve të Shqipërisë së Jugut dhe asaj të Veriut nga serbët dhe malazezët.

Por le të kthehemi sërish tek Lozana, duke përsiatuar rreth çështjes kombëtare.

Fundlufta e parë botërore kishte mbledhur në këtë qytet të qetë në dukje, lobe të fuqishme serbe dhe bullgare. Ashtu sikur ndër edhe grekët në Gjenevë, këto lobe kishin ndërtuar me kohë institucione të një nacionalizmi paranojak, ekstrem, që shpërfillnin në mënyrë të hapur historinë, që shkëlqin mbi kufoma shqiptarësh

të vrarë barbarisht, që endeshin të murrëtyer nëpër flakët e qindra fshatrave të bëra gërmadha prej Malit të Zi deri në Prevezë. Ndërkaq prej kohësh, këto institucione ishin deklaruar në rrethet diplomatike të Europës për aneksim të tokave shqiptare, duke ngritur në sistem fallsifikimin apo, më mirë të themi, masakrimin e historisë si dhe realitetin e dhimbshëm shqiptar.

Ripushtimi i Kosovës nga forcat serbe dhe franceze në vjeshten e vitit 1918 u ndërthur egërsisht me terrorin e dhunë të pashembullt. Pushteti policor i vendosur ngrii gjyqet e vdekjes me kompetenca të pakufizuara, duke çuar para skuadrave të pushkatimit mijëra shqiptarë që nuk mund të mbroheshin dot prej procedurave ligjore. Për të këmbyer rrënjësisht përbërjen etnike të popullsisë në trojet e lashta shqiptare, u sollën nën mburojë të një legjislacioni "in extremis" elementë të shumë sllavë. Dekretligji i 15 shkurtit të vitit 1919, i cili u dha tokën çifçinjve, pati aspekte të një denigrimi total për shqiptarët. Ndërsa këta u lanë me pak tokë ose pa gjë fare, ishin çifçinjët sllavë dhe të tjerë, që duke marrë sasira të mëdha të tokave më pjellore dhe duke patur një sërë lehtësish tatimore prej shtetit të tyre, nuk vonuan të ritnin pretendimet nga dita në ditë. Kolonët serbë po instaloheshin në këto kohë në pikat strategjike të trojeve shqiptare. Pasi u sistemuan në tokat më të mira në brezin kufitar me Shqipërisë, ata i kthyen sytë nga zonat urbane. Dhunshëm, me mënyra nga më të egrat ata nisën vendosjen e kolonëve edhe në vijën Vranjë-Shkup-Tetovë-Gostivar-Kërçovë dhe Strugë. Projekti i kahmotshëm për

## *Apostull i Shqiptarizmës*

---

serbizimin e Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore po vihej në jetë me të gjitha mjetet dhe mënyrat. Ndërkaq, në Lozanë, makina propagandistike e këtij projekti u binte me të gjitha forcat, borive të "Staraja Sërbisë".

Gjithsesi, përballë kësaj gjendjeje nuk mund të heshtnin shqiptarët që jetonin prej shekujsh në trojet e tyre në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi. Në Kushte të ilegalitetit, në majin e vitit 1918 ishte formuar Komiteti "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës". Po në tetor të këtij viti, forcat e luftëtarëve popullorë të udhëhequr nga Azem Galica, sulmuan trimërisht forcat austro-hungareze në Pejë, duke vrrarë me qindra e duke zënë rob mbi 1200 ushtarë dhe oficerë. Në Gjakovë, pikërisht, në këto momente u ngrit flamuri shqiptar. Ndërkohë ishte paria e këtij qyteti që me anën e protestave dhe deklaratave të bëra, shpalli se nuk mund të pranonte që trupat malazeze të vendosnin pushtetin e tyre. Me 12 gusht të 1919-tës, Komiteti "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës" i dërgonte ushtarakut Fortu një protestë kundër vendimit të qeverisë së Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, që bënte fjalë për dëbimin e shqiptarëve nga Kosova, sepse kishin marrë pjesë në kryengritjen e prillit të atij viti.

Më ndjesinë e thellë që e karakterizonte, Mid'hat Frashëri sigurisht, ka parandjerë sizmikën shpërthyesë të ngjarjeve që po afroheshin. Ndaj duke publikuar dhe botuar "Shqiptarë dhe Sllavë" në Lozanë, ai njëherësh kryente dy misione:

E para, iu përgjigj shkencërisht dhe trimërisht apologjetëve që gërmonin pa reshtur në përrallat për



*"Serbinë e Vjetër" dhe e dyta,... këmbanat bien për ata  
qe dëgjojnë. Europa, natyrisht, nuk ishte e shurdhër.*

*Pothuaj i vetëm përballë institucioneve të fqinjëve  
ballkanikë, përpos të tjerave, Mid'Hati do t'u kujtonte  
shqiptarëve të atyre kohërave se trashëgonte njohuri të  
gjera enciklopedike prej Samiut, urtësi e mall Shqipërie  
prej Naimit, e njëherazi energji e stoicizëm, të falura  
prej atij të tij, Abdyl Frashërit. Në rrafshin e përpjekjeve  
për një ridimensionim të historisë, për një vështrim real  
të kulmeve të saj, larg ngarkesave emocionale, Mid'hati  
kryen një punë të përsosur për evidentimin e doku-  
menteve si dhe të vlerave të mëdha shpirtërore që rezonoi  
Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Kësisoj, në "Kalendarin  
Kombiar" te drejtuar prej vitit në vitet 1926 dhe 1928,  
boton rrëfimet e Gjergj-Çakos, Gani Frashërit dhe Rifat  
Frashërit për këtë lidhje.*

*Boton disa zbulime të dokumentacioneve për  
periudhën në fjalë tek "Dituria" më 1928, si dhe një  
analizë tepër konstruktive rreth librit "Liga e Prizrenit"  
të autorit Kristo Dako. Rreth këtyre dokumenteve,  
ndihmohet, natyrisht, edhe prej shënimeve që i ati,  
Abdyli i pat lënë në turqisht, greqisht dhe frëngjisht. Pas  
kërkimeve dhe një durimi pa kufi, ai zbulon në arkivat  
gjermane dhe boton për të parën herë në shqip  
"Memorandumin" që iu paraqit prej Abdyl Frashërit dhe  
Mehmet Vrionit, Fuqive të Mëdha të asaj kohe, në të  
cilin shprehen qartë mendimet e Lidhjes Shqiptare të  
Prizrenit për tërësinë territoriale të shtetit shqiptar në  
kuadrin e zhbërjes së Perandorisë Osmane. Ndërkohë,*

## *Apostull i Shqiptarizmës*

---

në studimet e tij "Rilindja Shqiptare", "E drejta për Shqipërisë", "Rivendikimet shqiptare", "Burimet e historisë shqiptare", Mid'hati ynë përpiket për të gjetur mundësi të mëdha shpjeguese, për ta drejtuar lexuesin drejt thelbit të proceseve historike të atdheut të vet. Evoluimin dhe emancipimin e ideve të atdhetarëve, të diplomatëve dhe, përgjithësisht të elitës shqiptare, ai e vështron dhe e analizon kurdoherë në kuadrin e evenimenteve ballkanike, nisur, pikërisht nga përzierja e çuditshme shekullore e kodeve morale të këtyre popujve fqinjë dhe gjaknxehtë. Nuk është e vështirë të dallosh në këto analiza intuitën e Mid'hatit për të nxjerrë në pah dilemat e së ardhmes shqiptare.

Ndërsa ke mbaruar së shfletuari "Shqiptarë dhe Sllavë" i pari mendim që të bën për vehte është pikërisht ai, që Mid'hat Frashëri mbetet, padyshim, ndër themeluesit tanë të historiografisë dhe të analizës historike. Nëse mjaft vepra të tij, nëse mjaft ligjërata të mbajtura në Paris a Gjenevë, tërhoqën vëmendjen e intelektualëve dhe diplomatëve potencialë të Europës të viteve 20-të, kjo vjen, pa dyshim, nga qartësia dhe pjekuria meditative e këtij apostulli të shqiptarizmës në pasqyrimin, vlerësimin dhe ardhmërinë e situatave tepër të vështira që kalonte vendi i tij. Në çdo fjalë të birit të Frashërlinjve (veçmas në ato kundër grekëve dhe serbëve) nuk mund të gjesh askund qarje, ankesa apo dënosa patetike. I madhi Mid'hat e kishte kuptuar prej kohësh, se vetëm përmes dinjitetit; aktit të mençur diplomatik, e pse jo, edhe të trimërisë së popullit, çështja

shqiptare do të mund të merrej në konsideratë prej fuqive të kohës. Kjo është e vetmja rrugë e atyre popujve të vegjël që e duan lirinë. Në këtë rrugë, ai ishte dhe mbeti kalorës nderi gjer në çastin e mbramë.

Me këtë vepër, për t'i rrëfyer Europës, gjithçka që lidhej me fatet e popullit të vet, Mid'hati rreket të vlerësojë mjaft situata e ngjarje, duke u bazuar në shumanshmërinë e burimeve. Lexuesi i vëmendshëm i kësaj esseje historike s'e ka të vështirë të shohë se për të ndriçuar një realitet ekzistues, autori iu drejtohet tri-katër burimeve, që ndonëse diku largohen e diku afrohen midis tyre, ata, gjithsesi, janë të pakundërshtueshëm në rrafshin e vlerave historike që përcjellin. Jo rrallë, Mid'hati gjykon, duke risjellë të vërteta të pamohueshme të cituara prej autorëve të huaj, të ndryshëm. Por, madje, edhe kur gjykon ai të habit. Ai kurrë nuk fyen askënd, nuk çirret, nuk merret me ato ç'ka mund të nënkuptohen prej cinizmave të të huajve që me dashje apo jo, kanë dashur të nëpërkëmbin historinë. Gjykimi i tij rrjedh kurdoherë përmes një shtrati të qetë për t'u derdhur në detin e së vërtetës. Ja, si shprehet konkretisht: "Autoktonisë të shqiptarëve u kundërvihen sllavët e ardhur prej shumë larg; serbi, djepi i të cilëve është përtej Karpateve dhe bullgari i ardhur nga Azia me gjuhë të huazuar. Këto dy rraca të cilët klasifikohen në familjen e madhe të popujve sllavë kanë ardhur si pushtues, duke pushtuar territore krejt të huaja për ta. Padyshim, që mund të themi se pushtimi i një vendi përbën provën e plotë për të njohur zotëruesin. Por kjo provë, a mos vallë është e gjithpushtet-shme për çdo kohë dhe efekti i saj, a duhet të vazhdojë në shekujt

e mëvonshëm në një kohë kur vetë thelbi i kësaj prove do të jetë zhdukur?...”<sup>2)</sup>

“Shqiptarë dhe Sllavë” dëshmon, përpos të tjerave, edhe për erudicionin e autorit. Në faqet e librit, rradhë pas rradhe, ndërthuren ngjarje dhe fakte, flasin shkenca të ndryshme, tentohet drejt pikëtakimeve të popujve, flitet mbi marrëdhënie luftarake të ndërsjellta apo jo, kurdoherë nën një qartësi të manitshme, gati të prekshme. Kjo ndodh, sepse gjeografia dhe diplomacia, historia e afërt dhe e largët, kartografia dhe dokumenti autentik, ndërthuren natyrshëm tek vëzhguesi i thellë Mid’hat duke përcjellë tek bashkombasit e vet mesazhin e dimensionit real për fatin e tyre.

Esseist i një elite të veçantë, ai të habit me lirshmërinë e frazës së shprehur, me thellësinë e mendimit dhe sinqeritetin me të cilin i shpreh ato. Gjithsesi, shqiptarët dhe sllavët, Mid’hati i analizon jo vetëm në aspektin historik, etnik, apo numerik, por edhe terrene disi më të pakapshëm, siç janë veset dhe virtytet. Përmes një pasazhi, si ai që vijon, i dy zonjave angleze, autori tregon se di të qëmtojë në morinë e fakteve për të vizatuar deri karkaterin e popujve.

“... Mackenzie dhe Irbu, dy zonja angleze të cilat kanë udhëtuar në veri-lindje të Shqipërisë në gjysmën e dytë të shekullit 19-të, konfirmojnë urrejtjen e sllavëve të bazuar në ndryshimin racor. Në faqen 166 të librit të tyre ato shkruajnë se në Shkup i kërkojnë një tregtari nga Mali i Zi, kush është më i keq për sllavët, myslimani bosnjak apo shqiptari? Shqiptari, përgjigjet tregtari sepse flet një gjuhë tjetër dhe është armiku ynë edhe, nëse nuk

është mysliman. Po cilët prej tyre e mbajnë fjalën e dhënë? pyetën sërish zonjat. Shqiptari nuk e ka kurrë fjalën, kurse një boshnjaku mysliman nuk i zihet besë”, u përgjigj ai.<sup>3)</sup>

Ideja e këtij apostulli të shqiptarizms që Europa të gjente rrugët e arsyes e të mirëkuptimit midis popujve ballkanik është më se aktuale edhe sot, 80-vjet më pas nga dita kur u botua “Shqiptarë dhe Sllavë”.

Në përpjekjet e mia për t’u dhënë lexuesve këtë libër jam përballuar, jo rrallë, me një brengë të ardhur prej Shqipërie. Pasardhësi i brezit të ndritur të Frashërlinjve, përfaqësuesi i Janinës, Prevezës, Kosturit e Follorinës në Kongresin e Manastirit dhe kryetar i zgjedhur prej tij, anëtar i kabinetit të Ismail Qemalit në nëntorin e 1912 në Vlorë, përfaqësuesi ynë gojëmbël dhe mendimtari i thellë në Konferencën e Paqes në Paris dhe Lidhjen e Kombeve në Gjenevë, ambasadori tepër largpamës dhe tepër korrekt i Shqipërisë në Athinë dhe, më në fund ideuesi dhe themeluesi i organizatës nacionaliste me prirje perëndimore, liberale dhe demokratike “Balli Kombëtar” u përgojua dhe u mohua tinëzisht. Mbi jeten e tij prej martiri u bënë përpjekje, fill mbas fitores së Partisë Komuniste në vitin 1944, të hidhej baltë dhe harrim paprerë. Dhe kjo kuptohet lehtë, nëse i gjykon komunistët e elitës, në rrjedhat e internacionalizmit pervers proletar. Bile, ky denigrim butaforesk u shoqërua nga traktativa të qeverisë së Hoxhës për kthimin e “armikut” të komunizmit nga Italia, ku kishte emigruar në vjeshtën e vitit 1944. Sidoqoftë, këto ishin përpjekje të segmenteve politike shqiptare të atyre viteve, ndërsa në zemrat e shqiptarëve të ndershëm Mid’hati

rendte drejt lirisë me jetën dhe veprën e tij. Nëse diktatura e anatemoi birin e Frashërllinjve, ish-qeveria "demokratike" duhej, së paku, ta nxirrte atë prej mykut të arkivave. Botimet e derisotme nën kujdesin e zotërinjve Butka, Hamiti dhe Delvina janë gjithsesi një ogur i bardhë një parandjenjë optimiste lidhur me të ardhmen e korpusit të veprave Mid'hatit. Në kujtesën e kombit vepra e tij ndriçon në çdo çast. Fjalët e tij të thëna në çdo gjuhë presin të flasin me brezat. Eshtrat e shërbestarit të Shqipërisë dergjen ende në Amerikë, ndërkohë që bustin e tij vlen ta vendosësh në sheshet e disa institucioneve të shkencës shqiptare.

Nëse dikush hamendëson, se me këto tone polemike unë kërkoj të marr në mbrojtje Mid'hatin, do t'i lutem të mendojë, se është i gabuar. Mid'hati ynë, hyn pa më të voglin dyshim në radhët e burrave që askush s'ka nevojë që t'i mbrojë, pasi askush prej shqiptarëve (të pa ngarkuar me artifice ideologjike e partiake) nuk mund ta qortojë atë. Nëse nacionalizmin do ta përfytyronim si një ngrehinë ende të pandërtuar, "Shqiptarë dhe Sllavë" është natyrshëm një gur i rëndë themeli. Të shfletosh Mid'hatin është detyrë. Mendoj se është edhe fat i madh të mësosh prej tij.

**EUGEN SHEHU**  
**BERNE, janar 1998**

- 
- 1) "Letra mbi një udhëtim në Zvicër", Sofje 1915, faqe 7.
  - 2) "Shqiptarë dhe Sllavë", faqe 86.
  - 3) Po aty, faqe 76.

I

**T**omiç në parathënien e një libri<sup>1</sup> që doli në dritë në vitin 1913, thotë tekstualisht:

“Në letrën që ka publikuar tek “Le Temps”, më 3 janar 1913, z. Gregos Jakçiç ka gjetur një formulë të përshtatshme të shtrirjes së shqiptarëve përtej kufinjve të Shqipërisë se vërtetë, në sanxhakun e Novi-Pazarit, Fushë Kosovës, Serbisë së Vjetër dhe Maqedonisë.

Ky ekspansion ka qenë krahasuar me një vërshim lumi shkatërrimtar që del nga shtrati në mungesë të plotë të një force rregulluese. Por ka ardhur momenti që lumi të rifutet në shtratin e vet dhe të bëhet sa bamiës, aq dhe i shtruar. Këtu qëndron dhe misioni i Fuqive të Mëdha të shqetësuar. Duke u prononcuar për kufijtë e Shqipërisë, u takon atyre që ta fusin edhe njëherë lumin, brenda brigjeve nga ka vërshuar, nëse ato do t’i caktonin Shqipërisë kufijtë e saj të vërtetë”.

Asgjë më shumë, vetëm kaq.

Ka patur, në fakt, një çast, ku natyrisht të nesërmen e Luftës Ballkanike, çdo sllav ose më mirë çdo serb, mendonte se e kishte për detyrë të botonte diçka kundër shqiptarëve.

Gazeta pariziene “Le Temps” i kishte vënë këtyre shpifësve në dispozicion kolonat e saja, gjë të cilën e

kishte bërë më parë edhe me grekët, duke i lënë të dy palëve kënaqësinë e shfryrjes të gjithë urretjes së tyre kundër Shqipërisë. Nga ana tjetër ministra dhe ish-ministra serbë, u vunë në dispozicion me një zell tepër të zjarrtë. Z. Protiç, nën pseudonimin Balcanicus, shfrynte bulçitë gjithë vrer, ndërsa një plak i nderuar që mbante tituj të bukur, dr. Vlladan Gjorgjeviç na servirte një kryevepër të vërtetë. Për të krijuar një ide rreth natyrës së këtyre shkrimeve, mjafton leximi i pasazhit mjaft të lezetshëm që pason<sup>2</sup>:

“Tipi arnaut është thatanik dhe i vogël, tek ai gjen diçka prej cigani dhe fenikasi.<sup>3</sup> Por shqiptarët nuk të kujtojnë vetëm fenikasin, por, gjithashtu, edhe njerëzit primitivë që flinin mbi pemë, duke u mbajtur me anë të bishtit. Gjatë shëkujve që pasuan, kur njerëzve nuk iu shërbente më bishti, ky i fundit u zvogëlua, aq sa njerëzit e sotëm nuk kanë, veçse një mbetje të vogël në eshtërzat e kërbishtit. Vetëm ndërmjet shqiptarëve duket se ka akoma njerëz me bisht në shekullin e XIX. Kështu Von Hahn (f.63) thotë: “Ka dy lloj syresh, disa me bishta dhije dhe të tjerët me bishta të vegjël kali. Ata që janë të pajisur me bisht, janë njerëz shumë të fuqishëm me trup të lidhur dhe, gjithashtu, këmbësorë të shkëlqyeshëm. Për njërin prej tyre që ka vdekur para disa vitesh thoshin, se në një ditë kishte përshkuar disa hapësira përrallore. Për të kryer nevojën, ky soj njeriu, që i detyruar ta merrte bishtin në dorë për të mos e ndotur”.

Ne nuk e dimë se për cilën vepër të J. Georg Von Hahn-it bëhet fjalë, por nëqoftëse është fjala për të



famshmen "Albaniesche Studien" (Studime shqiptare) ky autor, në faqen 63 të cituar më sipër, nuk tregon për asgjë të ngjashme dhe vetëm në faqen 163, ai flet thjesht për besime popullore tek shqiptarët e jugut (jo të veriut), të cilët besojnë në kukudhë, në lugatë, në shtojzovalle etj., si dhe në ekzistencën e njerëzve që lindin me një bisht të vogël. Megjithatë këtu nuk bëhet fjalë aspak për ato çka nënkupton ish-ministri i denjë serb. Ndoshta plaku i nderuar, duke shkruar pasazhin e cituar, ka patur, një reminiscencë të origjinës së vet prej majmuni a prej ndonjë lemurieni, që rronte ndër pyje. Në çdo rast, është interesante të dihet se, cili është universiteti që ia ka dhënë titullin e doktorit eruditëve të këtij kalibri?

Por, nuk janë vetëm shkrimtarët sllavë që po përhapin poshtërsi të tilla kundër shqiptarëve. Kolonia serbe e Parisit ka përmbledhur në një vëllith, nën titullin "Çështja shqiptare", artikuj të publicistëve francezë si Cheradam, Bianconi, etj. (botuar nga Hachette, 1913).

Le të ndalemi për një çast tek emri i fundit, z. Bianconi, i cili ka botuar disa letra tek "Le Temps", (në numërat e 27 dhjetorit 1912, 10 janarit 1913), dhe që është autori, nëse nuk më gabon kujtesa, i dy hartave tregtare të Shqipërisë dhe të Maqedonisë, të cilat çdo shkencëtar do t'i kishte zili, por në të njëjtën kohë, gjithnjë, nëse nuk më gabon kujtesa, ai është autor edhe i një broshure më pak të njohur, të botuar në Paris më 1877, me titullin: "Ethnographie et statistique de la Turquie d'Europe". Mirëpo në këto faqe libri dhe në hartën që e shoqëron, F. Bianconi nuk vë re, veçse grekë e

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

---

vetëm grekë në gjithë Maqedoninë dhe, madje, në pjesën më të madhe të Bullgarisë. Si është e mundur që i njëjti autor, i cili para disa vitesh duket se nuk i njihnte fare sllavët, fare papritur sot i zbulon ata gjithandej? Siç duket shkenca e këtij gjeografi paska dy njësi peshe, dy masa dhe, mbi të gjitha, dy arsye?

Dijetarët dhe pseudodijetarët serbë, historianët, gjeografët dhe publicistët janë përpjekur të provojnë një gjë: që, gjoja, në krahinat e njohura me emrat Kosovë dhe Maqedoni Perëndimore nuk ka aspak shqiptarë, por, edhe nëqoftëse ka, ata nuk janë veçse ardhacakë, valë që janë derdhur jashtë shtratit të përroit!

Duke rivalizuar me grekët për këtë, serbët kanë shpikur rastësisht, sipas modelit të dhënë nga politikanët e Athinës, një emërtesë krejt groteske: përshembull, ata quanin "shqiptarë" atë pjesë të shqiptarëve të besimit katolik dhe që banojnë kryesisht në krahinën e Mirditës dhe në rrethinat e Shkodrës. Shqiptarët e Kosovës i thërrisnin "arnautë", një fjalë turke që përcakton të gjithë shqiptarët në përgjithësi, por së cilës serbët, (dijetarë dhe pseudodijetarë) i japin një kuptim të veçantë. Mirëpo vetë këta arnautë, sipas tyre, nuk do të ishin veçse sllavë, domethënë serbë të shqiptarizuar dhe serbë të myslimanizuar. Ka vepra të tilla, ndërmjet atyre të shkruara për këtë qëllim prej serbëve, si ato të Spiridion Gopçeviçit, për shembull, (Makedonien und Altserbien) gjatë leximit të së cilës nuk mund të mbash të qeshurën.

Në këtë drejtim serbët janë ndihmuar nga dijetarë, ose të vetëquajtur të tillë, si rusët: Makushev, Florinski

## *Mid'hat Frashëri*

---

dhe Hilferding, opinionet e të cilëve pasqyrojnë, padyshim tendencat e politikës moskovite. Këta zotërinj janë aq të gatshëm sa të ngatërrojnë shqiptarët me turqit dhe, sipas rastit t'i konsiderojnë ata të huaj, si myslimanë, të cilët herët a vonë duhet që të kthehen edhe njëherë në Azi, në djepin e origjinës së tyre. Dhe atje, ku ata zbulojnë një sllav të vetëm, një fshat të vetëm, sado i papërfillshëm që të jetë, nuk hezitojnë aspak që ta deklarojnë sllavë të gjithë rajonin.

Dhe për t'i dhënë politikës së tyre një peshë akoma më të madhe, sepse, në fakt bëhet fjalë, lidhur me përgatitjet për pansllavizmin, ata shpikën një term gjeografik, "Stara Serbia" (Sërbia e Vjetër) për të emërtuar kështu një pjesë të mirë të Shqipërisë veriore. Themi "shpikën", sepse ky term i ri figuron për herë të parë në vitin 1845 në "Hartën e principatës së Serbisë" të Zhan Bugorskit, e shtypur në Beograd po në atë vit ku, krahina e Bjellopojles, në jug-perëndim të Serbisë, paraqitet me emrin "Serbia e Vjetër ose Shqipëria aktuale", në një kohë kur në gjeografinë e Vuk Karaxhiçit, e shtypur gjithashtu në Beograd më 1827, nuk figuron gjekundi një term<sup>4</sup> i ngjashëm me këtë.

Çuditërisht edhe hartografë dhe gjeografë të tjerë e kanë ndjekur mekanikisht këtë shembull! Ku do të na çonte një praktikë e tillë, nëse ne do të dëshironim të aplikonim me të padrejtë fjalën "e vjetër"? Atëhere, do të ishim të detyruar ta quanim "Turqia e Vjetër" një pjesë të mirë të Europës Juglindore dhe të Ruisë jugore, ndërsa me emrat "Perandoria e vjetër romake" ose "Perandoria

e vjetër e Aleksandrit" do të njësohej një pjesë e madhe e botës së njohur prej të lashtëve! Absurdi do të arrinte deri tek komikja. Po atëhere, mbi ç'bazë e mbështesin një legjendë të këtillë? Sigurisht, jo mbi gjendjen etnografike të vendit, i cili vërtet është një vend i lashtë, i banuar prej shqiptarësh. Të jetë bërë kjo për arsye historike? Ato për t'u bërë qejfin disa shefave serbë që e kishin shtrirë sundimin e tyre në perëndim, ku, ky zotërim nuk ka qenë veçse një llustër? Apo mos do të ishte më fitimprurëse të pohoje gjithshka pa drojtje, për kënaqësinë e diplomacisë moskovite dhe të disa serbëve megalomanë?

Para se të merremi me çështjen e "arnautëve", të "serbëve të shqiptarizuar", të shqiptarëve të ardhur nga shtrati i përroit, etj., le të shohim fillimisht gjëndjen e sotme të asaj që "shkencëtarët" e quajnë Serbi e vjetër, të cilën së bashku një pjesë të Maqedonisë, ne do ta quajmë thjeshtë me shprehjen Shqipëria veriore.

Në lidhje me statistikat, jemi para një vështirësie mjaft të madhe për faktin se Turqia, domethënë zotëruesja e këtyre rajoneve deri më 1912, nuk ka nxjerrë asnjëherë statistika të sakta duke u mjaftuar me një vlerësim të përafërt. Administrata otomane mbi të gjitha e ka injoruar klasifikimin e banorëve sipas gjuhës së tyre, duke mbajtur parasysh në përgjithësi, vetëm besimin e tyre fetar, madje edhe këtë në një mënyrë tepër empirike. Për më tepër, nuk duhet harruar se shqiptarët kanë patur gjithmonë një kundërshti ndaj regjistrimit të popullsisë duke figuruar në regjistrimet zyrtare të autoriteteve otomane në një numër mjaft më të vogël se sa kanë qenë në të vërtetë.

## *Mid'hat Frashëri*

Megjithatë, ne do ta nisim studimin e këtyre rajoneve me shqyrtimin e statistikave turke duke u bazuar sidomos në vlerësimet otomane më të reja, të cilat, natyrisht, janë më afër të vërtetës.

Në kohën e inspektorit të përgjithshëm Husein Hilmi pashës, popullsia totale e vilajetit të Kosovës - dhe është pikërisht pjesa e Shqipërisë së veriut që na preokupon - ka qenë vlerësuar në 1.063.666 banorë, nga të cilët 754.631 muslimanë.<sup>5</sup>

Duhet thënë këtu, se turqit i kanë përcaktuar kurdo-herë shqiptarët me emrin e përgjithshëm "muslimanë", kështu që vilajeti për të cilin po flasim përbëhej nga tre të katërtat shqiptarë dhe një e katërta sllavë (serbë ose bullgarë të përcaktuar sipas interesave politike!). Për më tepër, nuk duhet harruar se vilajeti i Kosovës përbëhej nga Kazà (nënndarja administrative) që e tejkalonin numrin e frymëve të shqiptarëve, si Egri-Palanka, Maleshova, Ishtib, Kuçani, Karatova, Radovishta, Novi Pazar, Novi Varosh, Senica dhe Tashlixhe, që bano-heshin nga sllavë (të krishterë e muslimanë) dhe turq. Në rast se nuk i llogarisim këto Kazà, atëherë numri i shqiptarëve del më i lartë se 85% e popullsisë së përgjithshme të vilajetit të Kosovës.

Në këtë vilajet ka krahina të tilla si Peja, të përmendura si vende të pastra serbe ku në realitet nuk ka, veçse 20.000 sllavë (serbë), kundrejt 162.000 shqiptarëve! Vuçiterni, në kufirin e vjetër të Serbisë, numëronte vetëm 3000 serbë ndaj 42.771 shqiptarëve<sup>6</sup>.

Statistikat e fundit turke të hartuara vetëm pak muaj

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

përpara shpërthimit të luftës turko-ballkanike, e cila i dha fund sundimit osman në këto vise, mund të konsiderohet relativisht si më të mirat e këtij lloji të kryera më me pak gabime. Klasifikimi i popullsisë në këto është bërë, sipas kishës dhe besimit dhe aspak sipas origjinës racore. Vëmë re megjithatë, siç e kemi shënuar gjetkë përse i takon krahinave shqiptare ku kanë infiltruar grekët, se raporti i popullsisë shqiptare duhet të rritet të paktën me një përqind dhe ai i popullsisë ardhacake të pakësohet po aq, meqenëse tek shqiptarët vazhdojnë të ndeshim gjithnjë fenomenin e shmangies të një regjistrimi të saktë, në një kohë që priftërinjtë dhe kryetarët e bashkësive të racave të tjera, punojnë me një zell të pashterur për të rritur shifrën e atyre që përfaqësojnë.

Ja se çfarë na japin statistikat turke:

Gjithë vilajeti i Kosovës (Shkupi), përfshirë edhe krahinat ku nuk banojnë shqiptarë si: Egri-Palanka, Ishtib, Kuçani, Radovishta, Karatova në lindje, si dhe Senica dhe Plevlije në veri, numëron një popullsi totale prej 1.314.499 frymë, të ndarë sipas besimeve, në këtë mënyrë:

829.756	Myslimanë	64.14%
226.528	Serbë (dhe një minoritet i vogël grek)	18.80%
204.021	Bullgarë	15.76%
20.349	Katolikë shqiptarë	1.50%
147	Protestanë shqiptarë	-
3.171	Çifutë	0.20%
10.527	Ciganë	0.60%
<b>1.314.499</b>	<b>Gjithsej</b>	

## Mid'hat, Frashëri

**Shënim:** Në qoftë se nuk përlogariten kazatë e pabanuara prej shqiptarësh të përmendura më sipër e po të pranojmë mendimin që ndërmjet atyre të klasifikuar si serbë dhe bullgarë, domethënë si ortodoksë patriarkistë dhe ekzarkistë, ka një numër të madh shqiptarësh, do të jemi të detyruar të pranojmë se raporti i shqiptarëve në gjithë vilajetin është i barabartë, të paktën, me 85 % të popullsisë totale.

### Ja si paraqitet popullsia e kazave:

#### Kazaja e (Shkupit):

50.061	Myslimanë	55.33%
9.264	Serbë dhe Vllehë	10.34%
29.080	Bullgarë	32.24%
196	Katolikë	-
1.343	Çifutë	1.50%
475	Ciganë	0.60%
<b>90.419</b>	<b>Gjithsej</b>	

Ndërsa përbërja e popullsisë sipas sanxhaqeve do të ishte: Sanxhaku i Novi-Pazarit

52.833	Myslimanë	65.50%
27.814	Serbë	34.50%
19	Çifutë	
<b>80.666</b>	<b>Gjithësej</b>	

**Shënim:** Duhet të bëjmë të qartë se banorët e rrethit të Peshterit, të cilët i përkasin fisit të Kelmendit, formojnë një popullsi kompakte shqiptare në këtë sanxhak, përveç atyre të Rrozhajt, Beranës etj.

## Shqiptarë dhe Sllavë

### Sanxhaku i Prishtinës:

254.605	Myslimanë	70%
102.331	Serbë	28%
-	Bullgarë (nuk ka)	-
3.179	Katolikë	1%
825	Çifutë	-
3.405	Ciganë	1%
<b>364.885</b>	<b>Gjithësej</b>	

**Shënim:** Një numër i madh kristianësh që figurojnë si serbë, janë shqiptarë ortodoksë. Raporti i shqiptarëve me serbët shkon në këtë mënyrë, deri në 80-90%.

### Sanxhaku i Pejës (Ipek):

33.901	Myslimanë	72.50%
31.792	Serbë	15.20%
-	Bullgarë (nuk ka)	-
14.411	Katolikë	9.00%
5.675	Ciganë	3.30%
<b>185.779</b>	<b>Gjithësej</b>	

**Shënim:** Kjo statistikë përmban një numër të madh gabimesh. Kazaja e Pejës numëron 10.000 shtëpi shqiptare myslimane dhe 750 shtëpi sllave. Raporti, pra nuk është më shumë se 7.50% serbë, me kusht që të gjitha këta ortodoksë të jenë sllavë, gjë që nuk është aspak e vërtetë. Përveç kësaj, dihet numri i madh i personave që banojnë nën të njëjtën çati tek shqiptarët. Ka që numërojnë deri në 150 persona dhe më shumë, gjë e cila nuk ndeshet kurrë tek serbët. Por duke qenë se sanxhaku i Pejës ishte një prej më armiqsorët ndaj turqve, banorët e të cilit e kanë shfaqur me forcë armiqtësinë e tyre gjatë viteve 1910, 1911 dhe 1912, është krejt e kuptueshme që regjistrimi të jetë kryer në vija të trasha, shkel e shko.



## Mid'hat Frashëri

### Sanxhaku i Prizrenit:

195.047	Myslimanë	80%
31.491	Serbë	12.48%
19.599	Bullgarë	6.52%
22.295	Katolikë	1%
<b>248.432</b>	<b>Gjithësej</b>	

Dhe ja tani për t'i dhënë fund statistikës së vilajetit të Kosovës, po paraqesim shifrat e popullsisë në vetë qytetin e Shkupit:

22.013	Myslimanë	63.20%
2.073	Serbë, vlllehë, grekë	6.00%
8.725	Bullgarë	25.00%
196.	Katolikë	060%
1.343	Çifutë	4.00%
444	Ciganë	1.2%
<b>34.797</b>	<b>Gjithësej</b>	

Nga ana tjetër, gjithnjë sipas të dhënave turke, numri i serbëve që banojnë në krahinat shqiptare të vilajetit të Manastirit është:

	Numri i Serbëve	Numri i Përgjithshëm i Banorëve
Kazaja e Manastirit	484	123.372
Prilepi	6.404	66.948
Kërçova	10.519	39.772
Ohri	1.566	59.795
Dibra	615	61.015

## *Shqiptarë dhe Slavë*

Tamam në çastin kur ne po shtypnim studimin e morëm "Thirrjen e kolonisë shqiptare në Turqi, drejtuar Fuqive të Mëdha dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës", në të cilën gjetëm një statistikë të krahinave shqiptare, e cila ndryshon paksa prej atyre, që ne iu vumë në paraqitje e që nuk do të ishte pa interes ta riprodhonim këtu:

Krahina	Shqiptarë		Bullgarë	Serbë
	Numri	Përqindja		
Tuzi <sup>7</sup>	7.467	100	-	-
Shkupi	57.258	63,3	24.080	8.363
Kumanova	24.431	47	19.089	8.363
Kaçaniku	9.151	100	-	-
Prizreni	72.469	85,2	-	12.215
Tetova	59.076	78	10.940	5.591
Gostivari	27.197	80,3	2.487	4.032
Prishtina	63.968	86,7	-	8.093
Mitrovica	18.227	83,3	-	6.407
Vuçiterni	58.379	93,9	-	3.357
Ferizaj	25.390	88,2	-	3.151
Gjilani	60.164	79,4	-	14.261
Presheva	28.300	54,8	-	23.137
Peja	56.440	81,3	-	7.303
Gjakova	155.65	99,5	-	687
Tërgovishta	16.32	91,7	-	1.434
Gucia	10.905	93,9	-	812
Manastiri <sup>8</sup>	47.999	28,7	42.521	10.489
Ohri	29.369	47	28.060	4.663
Prilepi	23.308	33,7	33.791	6.604
Resnja	9.827	36,6	11.795	5.004
Kërçova	19.847	49	11.719	8.746
Kosturi <sup>9</sup>	37.118	38,5	30.983	-
Dibra e Sip.	75.292	89,5	8.209	615
Reka	25.037	100	-	-

## Mid'hat Frashëri

Ja sërish një dokument statistikor i hartuar për të njëjtin vend nga autoritetet austriake, në kohën e pushtimit të Shqipërisë së Veriut, gjatë viteve 1915-1918:

Vendi	Numri i përgj. i banorëve	Shqiptarë	
		Numri	Përqindja
Gucia	7.500	6.500	86,7
Peja	75.190	62.490	83,1
Gjakova	64.456	62.595	97,1
Prizreni	94.236	72.458	76,9
Mitrovica	22.800	11.371	49,4
Vuçiterni	32.000	26.550	83,0
Prishtina	77.231	58.884	76,2
Gjilani	54.694	31.110	60,0
Tetova	84.600	37.620	44,5
Presheva	43.352	15.158	34,9

\* \* \*

Mbasi kemi studiuar të dhënat e statistikave të përpunuara prej turqve dhe shifrat zyrtare austriake, do të shohim, gjithashtu, se çfarë thonë bullgarët për Shqipërinë e Veriut dhe atë të Lindjes.

Instituti Hartografik i Sofjes ka botuar në litografi tri harta të mëdha të vilajetit të Selanikut, të Kosovës dhe të Manastirit, ku çdo qytet është i ngjyrosur ndryshe, sipas përbërjes së popullsisë. Në të njëjtën kohë, po ky institut ka botuar një hyrje, e cila përbën në vetvete një vëllim të vërtetë, ku jepet një statistikë e detajuar e tri vilajeteve të cituar. Libri nuk është i datuar, por me sa di unë, ai ka

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

---

qenë i publikuar në vitin 1903.

Të dhënat e kësaj statistike janë shumë interesante, sepse ato jo vetëm hedhim poshtë pretendimet serbe, qëllim i dukshëm i kësaj vepre, por mbi të gjitha, nga ana tjetër dhe vetë pretendimet bullgare.

Ja çfarë shkruhet aty rreth vilajetit të Kosovës:

Qyteti i Shkupit, 4.474 shtëpi, prej të cilave 2.336 janë turke (domethënë shqiptare), 1.687 bullgare (domethënë sllave), 200 cigane, 100 izraelite dhe 60 vllahe.

Kazaja numëron 2.127 shtëpi sllave, 970 shtëpi mikste (domethënë sllave e shqiptare); 561 shtëpi pomake (sllave myslimane); 162 shtëpi turke; 1.461 shtëpi shqiptare.

Pra në gjithë kazanë e Shkupit nga 10.355 shtëpi, nuk ka veçse 4.414 shtëpi të pastra sllave (bullgare ose serbe, sipas politikës së ditës) dhe 5.941 shtëpi shqiptare, turke, vllahe dhe çifutë. Një pjesë e vogël e këtyre shtëpive i takojnë fshatrave me popullsi mikste, gjë që nuk ndryshon asgjë në raportin e sllavëve dhe jo-sllavëve.

Kumanova, qyteti: 2.425 shtëpi, prej të cilave 1.100 bullgare (që do të thotë po aq serbe sa dhe bullgare); 1.110 turke (domethënë shqiptare, përderisa nuk njihen turq në Kumanovë); 130 shqiptare (domethënë katolike); 68 cigane; 17 vllahe. Pra, popullsia sllave qëndron në minoritet.

Kazaja e Kumanovës përmban 3.562 shtëpi bullgare (domethënë sllave); 555 shtëpi bullgare shqiptare, turke, cigane; 85 shtëpi pomake, 25 shtëpi turke, 618 shtëpi shqiptare; 180 mikste (shqiptare dhe

cigane); 30 shtëpi çerkeze.

Sipas këtyre shifrave, në gjithë kazanë, përfshirë qytetin, nga 7.480 shtëpi, 4.662 do të ishin sllave dhe pjesa tjetër jo-sllave. Në këtë mënyrë na jepet një shumicë e elementit sllav; në qoftëse të dhënat do të konsideroheshin të sakta. Por siç do të tregojmë më poshtë, statistika bullgare nuk mund t'i qëndrojë kritikës. Përveç kësaj, pjesa më e madhe e fshatrave të cituar si të pastër sllavë, ndodhen në pjesën lindore të kazasë dhe si rrjedhim janë në kufirin e bllokut të formuar nga elementi shqiptar.

Kazaja e Ohranies (Kaçaniku), numëron 850 shtëpi, nga të cilat 713 shqiptare dhe 77 shqiptaro-serbe.

Kazaja e Lumës numëron gjithsej 2.950 shtëpi (përfshirë 150 shtëpitë e kryeqendrës), që të gjitha shqiptare.

Prizreni, qyteti: 9.787 banorë, prej të cilëve 2.035 serbë; 6.874 shqiptarë; 389 shtëpi shqiptare katolike dhe 489 cigane.

Kazaja, nga 12.764 shtëpi që numëron gjithësej, 10.898 janë shqiptare, 370 shtëpi serbe, 1.866 shtëpi fshatrash miske, ku popullsia shqiptare paraqet një maxhorancë shumë të madhe.

Presheva, qyteti: 200 shtëpi shqiptare.

Kazaja, 5.803 shtëpi (përfshirë edhe kryeqendrën); 3.837 shtëpi bullgare (domethënë sllave, sepse e gjithë popullsia e këtyre shtëpive që nën juridiksionin shpirtëror të patrikut të mëparshëm serb); 860 shtëpi mikste; 906 shtëpi shqiptare. (Statistikat turke dhe shqiptare na projojnë se shifrat e sapocituara janë të gabuara).

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

---

Gjilani, qyteti: 2.341 banorë, prej të cilëve 887 serbë; 1.081 shqiptarë; 373 ciganë.

Kazaja, gjithsej 9.058 shtëpi, prej të cilave 6.451 shtëpi shqiptare; 430 mikste; 2.137 serbë dhe 40 shtëpi çerkeze. Pra, më se tri të katërtat e kazasë e formojnë shqiptarët dhe aty nuk ka as edhe një bullgar.

Prishtina, qyteti: 12.375 banorë, prej të cilëve 1.776 serbë; 8.362 shqiptarë; 1.539 ciganë muhamedanë; 383 ciganë kristianë dhe 305 izraelitë.

Kazaja e Prishtinës numëron 7.274 shtëpi, prej të cilave 6.022 shtëpi shqiptare; 912 serbe; 340 shtëpi mikste.

Mitrovica, qyteti: 1100 shtëpi serbe dhe shqiptare.

Kazaja, gjithsej 3.586 shtëpi (përfshirë edhe qytetin), prej të cilave 1.334 shtëpi serbe dhe pjesa tjetër, domethënë 2.252 shtëpi janë shqiptare ose mikste.

Vuçiterni, qyteti: 650 shtëpi gjithsej, prej së cilave 100 shtëpi serbe dhe 550 shqiptare.

Kazaja, gjithsej 8.684 shtëpi (përfshirë qytetin), prej të cilave 610 shtëpi serbe; 105 shtëpi mikste serbo-shqiptare; 90 shtëpi çerkeze dhe pjesa tjetër, domethënë 7.319 shtëpi janë shqiptare të pastra (7.869 duke numëruar edhe ato të qytetit dhe, duke mos llogaritur këtu shtëpitë shqiptare të fshatrave mikste).

Novi Pazari, qyteti: 1.749 shtëpi serbe dhe shqiptare.

E gjithë kazaja (përfshirë qytetin) numëron 4.566 shtëpi, prej të cilave 1.748 janë shtëpi serbe dhe pjesa që mbetet janë shqiptare ose mikste.

Kalkandeleni (Tetova) qyteti: 3.000 shtëpi, prej të

cilave 1.000 janë bullgare; 1800 turke; 200 shqiptare.

Kazaja përmban gjithsej 13.224 shtëpi (përfshirë qytetin e Tetovës dhe Gostivarit, si dhe fshatrat që më vonë kanë formuar kazanë e Gostivarit), prej të cilave 1.833 bullgare; 4.268 mikste; 3.825 shqiptare; 298 pomake. Ndërmjet 1.000 shtëpive të qytetit, 850 njohin juridiksionin fetar të ekzarkut (domethënë se janë bullgarë)dhe 150 shtëpi atë të patrikut (për rrjedhojë ato pretendohet të jenë serbe). Gjithashtu nga 90 fshatra të kazasë, 61 prej tyre i janë nënshtruar juridiksionit fetar të ekzarkatit, 21 atij të patriarkatit dhe 8 prej tyre njohin përgjysëm pushtetet sa të ekzarkut aq dhe të patrikut.

Qëllimisht ne ekemi lënë në fund kazanë e Kalkandelenit, ndonëse në librin bullgar ajo trajtohet përpara asaj të Prizrenit. Shkaku është sepse qyteti i Kalkandelenit dhe në përgjithësi e gjithë kazaja, duke qenë një nga qendrat më aktive të propagandës nacionaliste shqiptare, ku vullneti për të luftuar kundër tendencave panturke dhe pansllave është manifestuar që herët, na ka bërë që t'ia nënshtrorjmë një llogjike të kujdesshme shifrat e dhëna prej qeverisë bullgare, sepse tri hartat dhe libri në shqyrtim janë botime zyrtare, në të cilat gjejmë shprehje aspiratat e qeverisë bullgare.

Statistika e kazasë së Kalkandelenit (së bashku me qytetin e vogël të Gostivarit dhe fshatrat që më pas formuan nëndarjen administrative turke të Gostivarit), zë faqet 37 deri 42 të pjesës së dytë të tekstit shpjegues të hartave etnografike të vilajeteve të Selanikut, Kosovës dhe Manastirit.

Fillimisht vetë qyteti Kalkandelen, numëron jo më

3.000 shtëpi, siç jepet në librin e Sofjes, por plot 4.000 shtëpi, tri të katërtat e të cilave banohen prej shqiptarësh, sepse jo vetëm popullsia muhamedane e qytetit është e racës shqiptare, por edhe një pjesë e banorëve ortodoksë, të cilët në vatrat e tyre kanë në përdorim vetëm gjuhën shqipe. Autoritetet bullgare e kanë gjykuar të domosdoshme për politikën e tyre të krijohet mendimi se kazaja e Kalkandelenit dhe ajo e Gostivarit të marra së bashku numëronin vetëm 3.825 shtëpi shqiptare të pastra, në një total prej 13.224 shtëpish. Mirëpo, sipas të dhënave që kemi ne, vetëm kazaja e Tetovës, nga 78.000 banorë që ka gjithsej, numëron 52.000 shqiptarë; 20.000 bullgarë dhe 6.000 serbë.

Në kohën e zgjedhjeve për Dhomën Turke, shqiptarët kanë patur 6 zgjedhës të kolegjit të dytë, ndërsa bullgarët dy. Xhonturqit me shumë përpjekje dhe për t'i favorizuar, u shtuan edhe një zgjedhës serbëve.

Statistika bullgare numëron 47 fshatra si të banuar pastërtisht prej bullgarëve (ose sllavëve). Në realitet, katër prej tyre, të treguar në tekstin e statistikës si të tillë, përmes shifrave 9,11,34,43, të quajtur: Otushishta, Glogi, Galati, Zhelezno-Rëçani, janë fshatra mikste të banuara përgjysëm nga shqiptarë dhe bullgarë dhe, një fshat i pestë (numri 36, Novo-Selo, Paprad) është fshat i pastër shqiptar.

Prej 42 fshatrave bullgarë të pastër, 14 prej tyre janë "çifliqe", domethënë të njerëzve që nuk kanë pronësi, por që punojnë tokën e shqiptarëve.<sup>10</sup>

Në katalogun e 43 fshtarave të cituar mikste, bullgarë, turk, shqiptarë etj., ne zbulojmë 9 fshatra (nr.



## *Mid'hat Frashëri*

---

54, 71, 76, 77, 79, 80, 83, 90, të thirrur ndryshe Zhagjinci, Negotinë, Dolno Elovci, Gorno Elovci, Duh, Orkushe, Ginovica, Florinoi dhe Forino), të cilët janë fshatra të pastër shqiptarë. Është e vërtetë megjithatë, që pesë fshatrat e parë brenda popullsisë së tyre numërojnë kristianë, por këta të fundit janë shqiptarë dhe aspak sllavë.

Përveç kësaj, ka shtatë fshatra<sup>11</sup> ndërmjet tyre të quajtur miskt, që nuk numërojnë asnjë të dhjetën bullgarë, në një kohë kur nëntë të dhjetat e tjera janë shqiptarë. Vetë qyteti i Gostivarit, për të cilin libri i Sofjes thotë se figurojnë 750 shtëpi mikste, përmban në të vërtetë 1.000 shtëpi, prej të cilave 900 janë shtëpi shqiptare dhe, ato që mbeten, të cilat mezi bëhen 100, janë formuar nga shtëpi bullgare, serbe dhe vllahe.

Për më tepër, gjashtë prej këtyre fshatrave, ose më mirë minoriteti sllav që banon në këto fshatra mikste, janë njerëz pa prona dhe të pavendosur në toka, - bujq që kultivojnë tokat e shqiptarëve. Përkundrazi, autorët e katalogut janë mashtruar kur kanë bërë listën e 63 fshatrave shqiptare, ku kanë futur edhe dy fshatra që përmbajnë një pakicë të vogël sllave. Këto janë fshatrat e Çelopekut (nr. 29) dhe të Gorno Sedlarcit (nr. 35), çka jep një bilanc pak aktiv në përlllogaritjet e tyre.

Shihet pra, se megjithë gabimet e pavetëdijshme ose të vetëdijshme që përmban statistika e institutit hartografik të Sofjes, pjesa më e madhe e veri-lindjes së Shqipërisë është fort larg së qeni e përbërë nga elementi sllav.

Por kjo nuk është e vërtetë vetëm kundër prete-

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

ndimeve serbe. Paralelisht me serbët, sado që duket sikur ecin në një drejtim të kundërt, takohen bullgarët, të cilët, gjithashtu, kanë ngritur pretendime dhe kanë sajuar një varg argumentesh për të ndërtuar atë që ata e quajnë Bullgaria e Madhe, njëlloj perandorie që shtrihet në gjithë gadishullin e Ballkanit, e famshmja "Çelokupna Bullgaria".

Kjo është një ëndërr e frymëzuar që prej 40 vjetësh nga motra e madhe, Rusia, dhe së cilës i ka mjaftuar traktati i Shën Stefanit për t'i dhënë njëfarë dukje si reale. Ky është projekt i famshëm moskovit që dëshiron të krijojë një pararojë në Ballkan e që akoma ushtron një efekt ngashnjyes mbi politikanët bullgarë, njerëz padyshim të respektuar dhe me një patriotizëm të lavdërueshëm, por me një oreks i cili nuk njeh kufi.

Ata që merren me çështjen maqedonase e dinë shumë mirë që tendencat e dy qeverive, bullgare dhe serbe, përplasen mbi terrenin perëndim-verilindje e asaj që ata e quajnë Maqedoni, domethënë në krahinat lindore dhe verilindore të Shqipërisë, Shkupi, Tetova, Dibra, Manastiri, që kërkohen me të njëjtën këmbëngulje si nga Beogradi, ashtu edhe nga Sofja. Në këtë front një luftë gjithnjë dhe më e ashpër, e shoqëruar me një literaturë shumë interesante mbi etnografinë e këtyre vendeve, bëhet ndërmjet dy viseve.

Por ajo që ka rëndësi për shqiptarët nuk është çështja të dihet në se është elementi bullgar ose serb ai që ka përparësi. Sllav për sllav, natyra e saktë e gjakut që rrjedh në venat e tyre nuk ka shumë rëndësi dhe, ne nuk

dëshirojmë aspak të përzihemi në grindjet e tyre brenda shtëpisë. Ajo që në realitet na intereson ne, është të dijme, nëse me të vërtetë, këto vende janë sllave apo shqiptare dhe, nëse janë këta të fundit apo serbo-bullgarët që kanë të drejta mbi këto krahina.

Për momentin le të vazhdojmë konsultimin e hartave etnografike të Institutit Hartografik të Sofjes. Për kazanë e Ohrit me një total prej 8.893 shtëpish, ka 4.609 shtëpi bullgare dhe ato që mbesin janë shqiptare, vllahe ose mikste. Ja dhe ndarja nacionale e tyre, sipas shtëpive:

Qyteti i Ohrit me 2610 shtëpi, numëron 1600 shtëpi bullgare; 900 shtëpi shqiptare, 110 shtëpi vllahe. Në fshatra: 3009 shtëpi bullgare; 991 shtëpi shqiptare, 125 shtëpi vllahe dhe 2.158 shtëpi mikste.

Këto janë shifra të dhëna nga statistika e Sofjes, mbi bazën e të cilave ndërtohen të gjitha veprimet politike bullgare, të përkrahura prej klerit ekzarkist dhe, sidomos, prej bandave terroriste.

Megjithatë këto shifra, që ne na duken plot gabime trashanike, ku ka shkarje drejt njëfarë doze ekzagjerimi (i pavetëdijshëm apo i vetëdijshëm), nuk mund t'i qëndrojnë kritikës.

Që në fillim duhet thënë se qyteti numëron 3.700 shtëpi (dhe jo 2.610). Nga këto 3.700 shtëpi, 2.100 janë shqiptare myslimane; 150 shtëpi shqiptaro-kristiane-ortodokse; 900 bullgare, 300 vllahe; 210 serbe dhe 39 greke (ndoshta vllahe, bullgarë ose shqiptarë të greqizuar).

Krejt kazaja numëron 38.000 banorë shqiptarë dhe 36.500 jo-shqiptarë sipas shifrave të autoriteteve

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

turke, të nxjerra gjatë ditëve të fundit të sundimit otoman. Mirëpo ndërmjet këtyre jo-shqiptarëve ka: bullgarë, serbë, vllahë, por ka gjithashtu edhe shqiptarë ortodoksë-kristianë që njohin ekzarkartin dhe që turqve u është tekur t'i shohin si bullgarë dhe t'i hedhin si të tillë në regjistra.

Statistikat e Institutit Hartografik të Sofjes japin 73 fshatra bullgarë me 3.009 shtëpi, duke shqyrtuar pak me vëmendje këto të dhëna, ne detyrohemi të bëjmë ndreqjet e më poshtme.

Dy nga këto fshatra janë krejtësisht të pastër shqiptarë: Trapezica (nr.45) dhe Brezhani (nr.69), të cilët janë të banuar nga shqiptarë kristianë-ortodoksë. Trembëdhjetë të tjerë: (Trebenishta, Livada, Tash-Marunishta, Globoçica, Lokvo, Konsko, Elshani, Lubanishta, Vranishta, Veshtani, Godivle, Varbeni, Turje) janë fshatra mikste, me një popullsi më shumë shqiptare se sllave. Besimi i banorëve shqiptarë të këtyre fshatrave mikste është ortodoks, me përjashtim të banorëve të Trebenishtit të cilët janë myslimanë.

Përveç kësaj, nga 83 fshatrat bullgare të cituara, 44 janë çifligje, çfarë do të thotë se e gjithë toka, ose të paktën pjesa më e madhe e saj u përket pronarëve shqiptarë.

Statistika na jep 12 fshatra mikste, me 2.158 shtëpi. Nga numri i fshatrave mikste të përmendura më lart, do të duhej të shkëpusnim pesë: Podgorci, Labunishta, Radozhda, Lini dhe Daboviani, të cilët janë fshatra të pastër shqiptarë; gjithë të tjerët kanë një shumicë shqiptare.

## *Mid'hat Frashëri*

---

Qyteti i Strugës mbi liqen, në vendin ku ujërat e shkëlqyer të liqenit të Ohrit derdhen në lumin Drin, ka një popullsi mikste, dy të tretat e së cilës janë shqiptare.

Përsa i përket 14 fshatrave të njohur si shqiptarë nga harta dhe nga statistika e Sofjes, me një total prej 991 shtëpish, në të vërtetë, sipas informacioneve tona personale, të mbledhura në vend dhe të servirura me shumë saktësi, nuk rezulton që të jenë 991 shtëpi, por, plot 2400 shtëpi.

Duke bërë këto ndreqje, arritëm në përfundimin që për kazanë e Ohrit, përfshirë edhe qytetin, të kemi një total prej 5.336 shtëpish shqiptare 4.347 shtëpi sllavë, domethënë serbe o sè bullgare e vllahe; 1.549 shtëpi mikste, me një shumicë të madhe shqiptare dhe 125 shtëpi vllahe, të ndara përkatësisht në dy fshatra vllahe.

Pra, jemi larg, shumë larg shumicës bullgare (sepse statistikat e Sofjes nuk pranojnë sllavë të tjerë) dhe pakicës shqiptare. Ne ne duhet tani të ndërrojmë termat dhe të arrijmë në një rezultat diametralisht të kundërt.

Përsa i përket tokës, ajo i takon pothuaj tërësisht (nëntë të dhjetat) pronarëve shqiptarë, ndërsa bullgarët kanë vetëm një të dhjetën e tokës-arë.

Larg së qeni mbështetës së sistemit feudal, - sepse vetë ne shqiptarët e dëshirojmë shpërndarjen e tokës dhe shitjen e saj fshatarëve, - deri në çastin kur kjo dëshirë e përgjithshme të na realizohet, ne nuk mund të mos e njohim këtë të drejtë. Sepse këtë të drejtë e njohin edhe ligjet e Anglisë, të Rusisë, të Rumanisë, të Austro-Hungarisë dhe të Greqisë.

Meqë toka, shtëpitë, pronësia e paluajjtëshme dhe pasuria iu takon shqiptarëve, të cilët kanë shumicën numerike, na duket si tepër e guximshme të pretendosh se kazaja e Ohrit është bullgare. Në të kundërtën, ajo, ne na duket, ca më tepër se shqiptare.

Ajo që do t'i habisë më tepër lexuesit tanë, është se ne i quajmë me emrin shqiptar kristianët- ortodoksë. Dideroi pyet se si mund të jetë njeriu persian. Lexuesit tanë, ndoshta, do të pyesin veten se si mund të jetë njeriu edhe kristian edhe shqiptar. Ky emër i fundit, në fakt, i quajtur shqiptar ose arnaut, a nuk është sinonim i një njeriu me çallmë në kokë, në gjendje gjysmë të egër, që mban në dorë një hanxhar në formë gjysëmheñe, i gatshëm të presë me të koka kristianësh të pafajshëm? Të tillë janë të paktën portretet e përshkruara nga sllavofilët dhe filohelenët, të mbushur me një ndjeshmëri të përshpirtshme dhe me një imagjinatë të sëmurë.

Megjithatë, në kazanë me të cilën po merremi, jemi të detyruar të zbulojmë praninë e shqiptarëve, kristianë-ortodoksë, të cilët me të padrejtë i kanë numëruar për sllavë, vetëm, duke u nisur nga motivi, që ata frekuentojnë kishën bullgare në mungesë të një kisha shqiptare. Është i njëti rast me ortodoksët, të cilët janë pak më në jug dhe që për grekët figurojnë gjithmonë në statistikat e tyre si grekë. Por ata (domethënë grekët) tregohen nganjëherë të drejtë, kur për këta shqiptarë ortodoksë aplikojnë epitelin alvanophoni (domethënë grekë që flasin shqip), ndërkohë që stacionet e Sofjes nuk kanë të njëjtin mendim mbi domosdoshmërinë e

një shprehje të tillë, duke shndërruar lehtësisht shqiptarë, ortodoksë në bullgarë.

Por ndërmjet këtyre të vetëquajturve bullgarë, ne njohim disa që ndjehen të fyer nëse thirren me këtë emër. Ata janë tmerri i bullgarëve e, ndoshta më të urrejturit prej tyre se sa shqiptarët myslimanë, arnautë. Nga ana tjetër, ata ndërmjet tyre shkojnë shumë mirë, pra, bëhet fjalë për raportet ndërmjet shqiptarëve kristianë-ortodoksë dhe shqiptarëve myslimanë. Ata mirëkuptohen reciprokisht, respektojnë njëri-tjetrin, sepse ata e dinë se rrjedhin nga i njëjti trung, flasin të njëjtën gjuhë, kanë të njëjtat zakone, ruajnë të njëjtat kujtime nga e shkuara dhe kanë të njëjtat aspirata dhe ideale.

Ekzistenca e këtyre shqiptarëve ortodoksë, të shpërndarë ndërmjet bashkëpatriotëve të tyre myslimanë dhe në fqinjësi me elementë të huaj (bullgarë ose serbë), duket se është injoruar prej gjithë atyre që kanë provuar të shkruajnë mbi problemet e Maqedonisë. Megjithatë, ky është një rast shumë i natyrshëm, meqenëse shqiptarët ortodoksë ekzistojnë në Elbasan, Durrës, Berat dhe në gjithë Shqipërinë jugore deri në Janinë dhe Prevezë.

Autorët e huaj i konsiderojnë si shqiptarë vetëm katolikët dhe kushdo tjetër që është ortodoks, atyre ju duket si sllav (ose grek). Por ne, që po shkruajmë këto rreshta, kemi takuar prej tyre kudo; si në Vuçitern (ku gati të gjithë ata që figurojnë si serbë, janë shqiptarë ortodoksë), si në Pejë. Ne i dallojmë ata shumë lehtë nga ortodoksët sllavë (bullgarë ose serbë), nisur nga veçoritë që paraqesin në zakonet e përditëshme, në të folurit shqip

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

---

me gratë dhe fëmijët e tyre në vatrën familjare, gjë të cilën nuk do ta bënte kurrë një sllav i ardhur nga brigjet e Danubit.

Pra, pasi kemi hapur një parantezë disi të gjatë, le t'i kthehemi statistikave tona:

Kazaja e Kirçevës: në një total prej 5.881 shtëpish; gjejmë 2.795 shtëpi bullgare; 859 shtëpi shqiptare; 1.293 shtëpi pomake dhe 784 shtëpi mikste.

Ndërsa në realitet kazaja e Kirçevës numëron 38.000 frymë, nga të cilat 19.000 janë shqiptarë, 1.000 bullgarë dhe 9.000 serbë. Siç shihet, pra bullgarët janë mjaft larg së qenit shumicë këtu.

Do të ndalemi, gjithashtu, diçka më shumë në kazanë e Kirçevës, sepse është një prej krahinave të cilat mbas luftës turko-ballkanike kanë vuajtur më shumë prej sllavëve; sa nga serbët, aq edhe nga bullgarët. Statistika jonë, dömethënë ajo e Institutit Hartografik të Sofjes, ka rrëshqitur në më shumë se një gabim përsa i takon katalogut të fshatrave.

Për shembull, ndërmjet fshatrave të treguar si të banuar vetëm prej bullgarëve, pesë prej tyre janë fshatra mikste, banorët e të cilëve përbëhen nga bullgarë dhe shqiptarë: Lazarovci (nr.1), Reçani Zajati (nr.5), Popaljani (nr.23), Brod (nr.48), Topolnica (nr.57). Ndërmjet 15 fshatrave të përcaktuar nën emrin mikste, ndodhen tre fshatra të cilët janë të banuar vetëm nga shqiptarë, konkretisht: Krushnica (nr. 87), Arkangjeli (nr.90) dhe Kolari (nr.96). Një i pestë, Tuhini, nga 150 shtëpi (dhe jo 120), numëron vetëm 15 shtëpi serbe dhe një i gjashtë,



## *Mid'hat Frashëri*

Novosela, nga 65 shtëpi që ka gjithsej, 50 shtëpi janë shqiptare dhe 15 të tjera serbo-bullgare. Nga tetë fshatrat që autorët e hartës etnografike dëshirojnë t'i kalojnë për pomakë (bullgarë muhamedanë), të paktën gjashtë prej tyre: Sarbica, Baçishta, Stregomishta e Epërme, Stregomishta e Poshtme, Carivci, Mahmudovci janë fshatra të banuara vetëm nga shqiptarë e jo nga pomakë.

Nga 81 fshatra të quajtur bullgarë në statistikën e Sofjes, të paktën shtatë prej tyre janë çifligje, domethënë prona që iu përkasin në shumicën e tyre shqiptarëve.

Toka e kazasë së Kirçevës në pjesën më të madhe të saj u përket shqiptarëve (më se 70%). Stastika në jep 2.795 shtëpi bullgare. Ne nuk dëshirojmë t'i diskutojmë ato, por do të duhej të zbrisnin një gjashtëdhjetëshe, të cilat i njohim si shqiptare në pesë fshatrat që i kemi emërtuar më lart.

Kundrejt këtyre 2.735 shtëpive, të cilave iu shtohen 50 shtëpi serbe dhe bullgare të fshatrave mikste, kemi një total prej 2.390 shtëpish të pastra shqiptare, në një kohë që në fshatra të tjerë gjejmë rreth 100 shtëpi pomake.

Mirëpo banorët e qytetit të Kirçevës, të vlerësuar si pomakë nga statistika e mësipërme, janë në realitet shqiptarë, nëqoftëse duan të vëzhgojnë, sadopak, zakonet e tyre, mënyrën e jetesës, kostumet, fizionominë dhe konfiguracionin e kafkave; Vetë ata nuk kanë asnjë dallim me shqiptarët. (Shih më poshtë motivet që na shtyjnë të mendojmë se këto gjysëm të turqizuar në dukje, janë në realitet vetëm shqiptarë).

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

\* \* \*

Një vepër bullgare e cituar shpesh, është edhe ajo e Vasil Kençov<sup>12</sup>. Autori bën kujdes të na thotë që në faqen e parë të parathënies se ai u shtrëngua ta botonte librin e tij në një kohë, kur mungonte një vepër e mirë mbi Maqedoninë. Ne po riprodhojmë në fund të librit hartën etnografike të bërë prej V. Kençov, por të dhënat statistikore të tij na dukeh të jenë pak, ose aspak të sakta.

Po i riprodhojmë ato jo vetëm për kuriozitet, por edhe me qëllim që të nxjerrim në pah kontradiktat që mbretërojnë ndërmjet vetë bullgarëve; si për shembull ndërmjet Kençovit dhe autorëve të hartave etnografike të institutit hartografik të Sofjes.

Për gjithë kazanë e Shkupit, Kençovi jep 34.862 bullgarë, 17.024 turq dhe aspak më shumë se 9.032 shqiptarë myslimanë (plus 150 shqiptarë kristianë).

Ja dhe shifrat që ai jep për kazatë e tjera:

<b>Kazaja</b>	<b>Bullgarë</b>	<b>Shqiptarë</b>
Tetova	31.897	27.793
Kumanova	34.191	6.166
Presheva	27.678	9.446
Manastiri	88.811	12.346 <sup>13</sup>
Prilepi	57.213	3.525 <sup>14</sup>
Follorina	37.781	4.344 <sup>15</sup>
Ohri	41.208	7.291 <sup>16</sup>
Kërçova	25.476	6.190
Dibra	15.438	23.695 <sup>17</sup>
Reka	12.015	6.959 <sup>18</sup>
Kosturi	46.783	4.344 <sup>19</sup>

Një autor tjetër bullgar, Jordan Ivanov<sup>20</sup>, jep gjithashtu shifra shumë interesante mbi krahinat e rivendikuara si "shumë bullgar" e që na qenkan pjesë e të famshmes "Çelokupna Bullgarija". Sipas këtij profesori, kazaja e Tetovës, me një popullsi të përgjithshme prej 63.980 banorësh, numëronte vetëm 22.660 sllavë (domethënë bullgarë ose serbë). Gostivari, në një total prej 33.870 banorësh, numëron 10.300 sllavë, Dibra ndër 60.480 banorë llogaritet të ketë 21.550 sllavë.

Vetë kazaja e Manastirit, ndër 125.230 banorë, nuk ka më shumë se 70.550 sllavë.

\* \* \*

Autorët sllavë kanë i janë drejtuar për ndihmë një truku mjaft të njohur prej atyre që i kanë studiuar mekanizmat e propogandës nacionaliste në Ballkan, dhe të përdorur, veçanërisht, krejt haptas prej grekëve, që i njëson me dashje shqiptarët myslimanë me turqit, duke synuar në këtë mënyrë të pakësojnë numrin e shqiptarëve.

Mirëpo, ndonëse në disa kryevende të tilla si në Prishtinë, Shkup, Manastir, ku shqiptarët merren vesh edhe në turqisht, ashtu si edhe vetë bullgarët gjetiu, kjo nuk mund të hedhë asnjë dyshim mbi kombësinë e tyre të vërtetë, e cila është shqiptare. Vetë Jordan Ivanovi, i bindur për këtë, e njih popullsinë myslimane të Bitolit (Manastirit), Ohrit, Strugës, Shkupit etj., si të përbërë kryesisht nga shqiptarë<sup>21</sup>.

Autori tashmë i cituar dhe të cilit ne do të kemi

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

rastin t'i kthehemi shpesh, Vasil Kençov, mbasi ka thënë se qyteti i Shkupit ndër 32.000 banorë numëron 15.000 turq, 13.000 bullgarë, 1.970 ciganë, 800 çifutë, 450 vllhë, 300 serbë, 150 grekë, 150 shqiptarë katolikë, nuk harron të shtojë që një e treta e popullsisë muhamedane e qytetit është me origjinë shqiptare<sup>22</sup>.

Megjithatë, ata që kanë vizituar këto krahina dhe që kanë marrë mundimin të shikojnë përreth tyre, do të njohin lehtësisht që tërë banorët e quajtur turq, të qyteteve të Manastirit, Shkupit, Ohrit, Gostivarit, Kërçovës, Prishtinës, Prizrenit, në total nuk janë gjë tjetër, veçse shqiptarë në origjinë, zakone, në mënyrën e jetesës dhe të sjellurit.

Sllavët nuk bëjnë pra gjë tjetër, veçse kopjojnë procedurat greke, kur ata me qëllim i marrin shqiptarët për turq, me synimin për të hapur në këtë mënyrë mendimin se ata janë të huaj, të ardhur nga Azia, vend në të cilin duhen të kthehen përsëri.

Një njohës i thellë i gjërave në Ballkan ka thënë: "Mund të thuhet, me pak ekzagjerim, se turku vetëm sa ka ngritur shatorret në Europë, ndërsa, sa u takon shqiptarëve, këta janë autoktonë".<sup>23</sup>

Ka madje disa autorë sllavë (veçanërisht serbë), të cilët kanë gatuar njëlloj çorbe, me anë të së cilës pretendojnë të shpjegojnë dallimin ndërmjet termit shqiptar dhe arnaut. Sipas tyre fjala shqiptar nënkupton një shqiptar katolik dhe arnaut një shqiptar mysliman, ose më mirë një shqiptar turk, siç thonë ata.<sup>24</sup> Mirëpo fjala arnaut s'është gjë tjetër veçse forma turke e fjalës

albanais, të rrjedhura që të dyja nga greqishtja, dhe arvanit, e cila në vetvete nuk është gjë tjetër veçse fjala arban (dhe arbër), emër që shqiptarët ia kanë dhënë vetes së bashku me atë "shqiptar".

Por autorët serbë shkojnë edhe më larg. Për ta, arnauti nuk është vetëm shqiptar që i bindet ligjit të Muhamedit, që ka një krah të shkathët dhe që ngre lart kërcënueshëm një jatagan, ai është përveç këtyre një sllav, një serb i myslimanizuar dhe gjithashtu i shqiptarizuar. Ai është, siç e cilësojnë ata, një substancë e gjallë që ka kaluar përmes dy reaksionesh kimike, në përfundim të të cilave ka rezultuar një përbindësh i etur për gjak, në vend të sllavit të ëmbël dhe njerëzor. Po t'i dëgjosh këta, të gjithë shqiptarët e Kosovës, të gjithë arnautët e Pejës, Gjakovës, Prishtinës, Shkupit, Kalkandelenit (Tetovës), Dibrës, Manastirit, s'janë veçse sllavë, më të shumtën serbë në fillim të myslimanizuar dhe më pas të shqiptarizuar. Shpikësi i kësaj teorie kaq të përhapur në botën sllave është i famshmi Spiridion Gopelviç.<sup>25</sup>

Që ka sllavë që e kanë përqaftuar islamizmin, këtë askush s'e vë në dyshim. Pomakët në Bullgari, boshnjakët myslimanë në Bosnjë e dëshmojnë këtë. Ka prej këtyre sllavëve renegatë (ose të konvertuar) deri në sanxhakun e Novi Pazarit, por këta janë të gjithë sllavë, serbë që kanë ruajtur zakonet e tyre, mënyrën e të sjellurit dhe gjuhën. Përshkruhen përgjithësisht me emrin boshnjakë, që është më i preferuar se sa emri serb-myslimanë, dhe vetë këta e quajnë veten e tyre boshnjakë.

Pra, feja mundet t'i ngjitet mirë një kombësie, pa

ia ndryshuar kësaj karakterin etnik. Grekët e konvertuar (ose renegatë) të Kretës na japin edhe një provë më shumë që, megjithëse të myslimanizuar, askush nuk i quan turq.

Mirëpo duke pranuar që shqiptarët e Kosovës (ose arnautët, siç i pëlqen t'i thërrasë Gopçeviçi dhe bashkëpuntori i tij, Cvijiç) janë serbë të konvertuar në Islam, si duhet shpjeguar atëhere fizionomia aktuale, gjuha dhe zakonet e tyre shqiptare?

E shumta, këta do të qenë bërë "turq", duke adoptuar fenë e pushtuesit, gjuhën dhe zakonet e tij, ose do të kishin mbetur gjithnjë sllave, pavarërisht se ndjekin ligjin e Kuranit, sikurse është rasti i atyre të Bosnjës dhe sanxhakut të Novi-Pazarit. Përse pra, Peja flet shqip dhe ndjehet shqiptare, kur disa kilometra më në veri, në Beranë, flitet sllavisht dhe njerëzit aty quhen vetëm boshnjakë? Përse Mitrovica flet dhe ndjehet shqiptare, kur disa orë më në veri, në Novi-Pazar, flitet vetëm sllavisht dhe quhen vetëm boshnjakë?

Përgjigja qëndron në arsyen e thjeshtë se banorët e Kosovës, të Mitrovicës, të Pejës, ashtu si dhe ata të Shkupit, janë shqiptarë, ndërsa ata të Novi-Pazarit janë sllavë.

Nuk është e mundur t'i referohesh forcës asimiluese dhe përthithëse të shqiptarëve, forcë e cila do t'i kishte kthyer këta sllavë në shqiptarë, sepse, sipas dijetarëve serbë, Kosova duhet të ketë formuar qysh me kohë, domethënë përpara pushtimit osman, një bllok kompakt serbësh. Si mund të pranohet pra influenza asimiluese dhe absorbuese e një minoriteti shqiptar, i

cili nuk ka as dhe avantazhin e të qenit fitimtar?

Në të kundërtën, ka qenë influenza e turkut ajo që është ushtruar në mënyrë shumë të ndjeshme mbi racat e nënshtruara. E tillë që bullgarët e Koçanës e të Karatovës kanë marrë gjuhën e pushtuesit bashkë me fenë e tij. Në Bullgarinë e mirfilltë, përveç pomakëve, të cilët janë bullgarë renegatë, por që gjithnjë vazhdojnë të flasin bullgarisht, ka edhe turq të cilët janë me origjinë bullgare, tani krejtësisht të turqizuar.

Ky efekt duhet të jetë ushtruar njësoj edhe mbi shqiptarët. Në qytetet e mëdha lindore dhe veri-lindore të Shqipërisë, si në Prishtinë, Shkup, Tetovë, Ohër, Manastir, turqit kanë hasur kundërshtime të mëdha që në fillim të pushtimit të tyre, për ta shndërruar fizionominë etnike të vendit dhe për t'u imponuar gjuhën e tyre.

Në këto vende ata vendosën shtabet dhe trupat e tyre, dhe u përpoqën të themelojnë organizmin e tyre administrativ dhe ushtarak. Rezultatet e këtyre përpjekjeve nuk do të vononin të ndjeheshin gjatë pesë shekujve të sundimit turk. Një pjesë e mirë e shqiptarëve të këtyre qendrave filluan të përdornin gjuhën turke, pa hequr dorë nga gjuha amtare. Këtu qëndron edhe motivi i shfrytëzuar nga udhëtarë të sipërfaqshëm ose dashakeqë, që i konsideronin si turq banorët e këtyre qyteteve. Por, me më tepër kujdes dhe skrupolozitet do të të zbulohesh shpejt karakteri i tyre i vërtetë etnik.

Këta banorë gjysëm të turqizuar, e quajnë veten pikësëpari shqiptarë dhe turqit e quajnë arnaut këdo që është nga Skupi, Manastiri ose Prishtina. Ky gjysëm-

turqizim është në vetvete vetëm në dukje dhe krejt sipërfaqësor, sepse në të vërtetë këta "turq" jo vetëm ruajnë të gjitha zakonet shqiptare të paprekura, por ruajnë gjithashtu edhe ndërgjegjen kombëtare.

Ka një dallim shumë të madh, një hendek të thellë ndërmjet këtyre gjysmë të turqizuarve në dukje dhe turqve të vërtetë të cilët jetojnë disa hapa më tej.<sup>26</sup>

Dihet që fare pranë Manastirit ndodhen dy fshatra të mëdhenj, Mesxhidi dhe Kenali, popullsia e të cilëve është turke, e përbërë nga turq autentikë të ardhur dhe të vendosur në kohën e pushtimit.

Ata vetequhen turq-osmanllinj dhe njerëzit e rretheve i thërrasin "Konialis" ose "Koniarit", që do të thotë me origjinë nga Konia, një vend i ndodhur në brendësi të Azisë së Vogël. Më në jug, në kazanë e Kajalarit, takojmë një grup kompakt të konianisëve. Ndërsa më në veri, në afërsi të Dibrës, ka një ishull të vogël, një enklavë turqish autentikë, brenda një krahine të pastër shqiptare; këta janë fshatrat e Kaxhaxhikut, turq autentikë. Edhe shikimi më sipërfaqësor dhe më i pavëmendshëm, do të mjaftonte për t'i dalluar pa vështirësi këta turq të vërtete nga popullsia që i rrethon.

Ata është e pamundur që t'i ngatërrosh si nga zakonet e tyre ashtu edhe nga mënyra e të folurit (gjuha turke). Ndërsa të parët flasin një turqishte të vërtetë, të dytët, që e kanë mësuar të detyruar nga kërkesat e jetesës, flasin njëllloj turqishtjeje të keqe, e cila mund të quhet "turçe negri", ku të bie në sy aq shumë fondi shqiptar, që i ka huazuar zhargonit turk format, format e frazës, bile



edhe vetë fonetikën.

Autorët sllavë me qëllim i kanë injoruar këto veçori. Ata shohin vetëm turq që duhet të kthehen përsëri në Azi, ose sllavë të myslimanizuar dhe të shqiptarizuaar, që duhet të kthehen në vathën e madhe sllave!

Por një fakt akoma më domethënës dhe që ndikon në të kundërt të pretendimeve të dijetarëve serbë, është që këta shqiptarë të Kosovës iu përkasin fiseve. Dihet që me këtë emër përcaktohen fiset e Shqipërisë së Epërme dhe dihet gjithashtu që "fise" ka vetëm tek shqiptarët dhe aspak tek serbet.

Mirëpo të ashtuquajturit serbë të myslimanizuar dhe të shqiptarizuar të Kosovës, ata të Pejës, të Mitrovicës e të Gjilanit, iu përkasin fiseve Krasniqe, Shalë, Kelmend, Fan... Dhe këta shqiptarë janë ndjerë dhe ndjehen të gjithë solidare, prej Vranjës e deri në Shkodër, sa ndërmjet vetë myslimanëve, aq dhe ndërmjet myslimanëve dhe kristianëve, pa dallim besimi. Në të kundërt, banorët e Novi-Pazarit ose të Koçanës kurrë nuk janë ndjerë solidare me ata të Lumës ose të Gjakovës.

Duke folur për fiset, nuk mund të le pa kujtuar që ky është mjeti më i saktë për të dalluar një sllav nga një shqiptar, sidomos në pjesët veriore të Shqipërisë. Ky është një reaktiv i pagabueshëm, një kriter shumë i sigurtë.

Por për krahinat e lindjes dhe të veri-lindjes, ky mjet na shpëton nga dora, duke qenë se fisi nuk ekziston në gjithë Shqipërinë. Më mirë ata janë të përcaktuar në veri-perëndim të Shqipërisë, pranë Shkodrës.

Ka një fis me emrin Kuçi, territori i të cilit përfshihet

brenda kufinjve mbretërisë së Malit të Zi, anëtarët e të cilit sot flasin sllavisht dhe konsiderohen përgjithësisht si malazezë. Megjithatë, tek 700 shtëpitë e fisit Kuçi, është akoma e gjallë tradita e atyre që kanë folur shqipen para shtatë brezash. Fisniku nga Kotorri, Mariano Bolica, në relacionin e tij të datës 25 maj 1614, i quan kuçasit (sipas ortografisë së tij, Cuzzi) më se njëherë shqiptarë, çfarë tregon edhe njëherë vërtetësinë e traditës së origjinës shqiptare për të gjithë ata që i përkasin këtij fisi.<sup>27</sup>

Ne jemi kështu përpara një procesi krej të ndryshëm dhe diametralisht të kundërt, prej atij që pretendojnë dijetarët sllavë.

Nuk bëhet fjalë më për sllavë, serbë "të myslimanizuar dhe të shqiptarizuar", por për shqiptarë të sllavizuar nën influencën shekullore të fqinjësisë së pakëndshme malazeze dhe akoma më tepër nën efektin e ngadalshëm të një administrate të përbashkët.<sup>28</sup>

Një influencë e tillë është ndjerë edhe gjetiu përveç zonës në fjalë, të ndodhur në veri të Shkodrës. "Jehona e Bullgarisë" e Sofjes, në një prej numrave të parë të vitit të parë të publikimit (1913), në një studim kushtuar Dibrës, pranonte se "nën influencën e propogandës aktive të bullgarëve, jo vetëm sllavët e Dibrës, por edhe shqiptarët e krishterë kanë filluar të quhen bullgarë"<sup>29</sup>. Autori bullgar Jordan Ivanov thotë se "në Gostivar, popullsia shqiptare e krishterë që jeton pranë minoritetit bullgar, është bullgarizuar".<sup>30</sup>

Më poshtë ne do të riprodhojmë pasazhin e "Jehonës së Bullgarisë". Ky është një pohim që duhet

zbuluar e mbajtur mend, sepse aty mund të gjejmë kyçin e më shumë se të një enigme. Nën këtë influencë, të krishterët e Tetovës dhe të Pejës janë konsideruar shpesh si sllavë, ku me fjalën influencë kuptojmë kishën, klerin dhe shkollat. E përsërisim se, statistikat serbe ose bullgare nuk shënojnë shqiptarë të tjerë, përveç atyre që praktikojnë fenë myslimane ose katolike. Pjesa që mbetet, domethënë ortodoksët, janë të konsideruar si serbë ose bullgarë.<sup>31</sup>

Kështu që popullsia ortodokse e qytetit të Pejës (rreth 50 shtëpi), e cila në vatrat e veta flet shqip, ngatërron me ortodoksët sllavë (gati 250 shtëpi) që flasin serbisht në shtëpitë e tyre. Pikërisht në këtë mënyrë është vepruar, në statistikën zyrtare të institutit hartografik të Sofjes, për katër fshatra të kazasë së Tetovës, popullsia ortodokse e të cilëve flet shqip, e që janë numëruar ndërmjet fshatrave mikste; këto janë: Zhazhinci, Elovci i Epërm, Elovci i Poshtëm, Duhi.

Nuk po përmendim këtu 25 fshatrat e Rekës në Dibër, ku popullsia, ndonëse është ortodokse, flet vetëm shqip dhe e konsideron veten si të tillë.<sup>32</sup>

Një nga argumentet e konsideruar si më me peshë nga bullgarët në pretendimet e tyre, është sfera e influencës së ekzarkatit bullgar, i krijuar në Konstandinopojë nën patronazhin e Rusisë së Shenjtë më 1870. Sipas kësaj, bullgarët dëshirojnë që kudo ku shtrihet juridiksioni i ekzarkatit, ai vend të jetë bullgar ose të bëhet i tillë. Kjo na kujton pretendimet e grekëve, të cilët bien në të njëjtin gabim me anë të patriarkanës së tyre

ekumenike.<sup>33</sup>

Një fakt i tillë nuk përbën ndonjë rëndësi të veçantë, duke qenë se sfera e një juridiksioni të shumtë e herës është gjë e rastësishme e duke qenë se shqiptarët nuk kanë mundur kurrë të fitojnë një kishë autoqefale, meqenëse kanë hasur në kundërshtimin energjik të autoriteteve otomane.

Nga ana tjetër, që kisha nuk mund të konsiderohet si një kriter i pagabueshëm për të përcaktuar kombësinë, këtë gjë e pranojnë edhe vetë serbët. Në shënimin që shoqëron hartat etnografike të vilajeteve të Selanikut, të Kosovës dhe Manastirit, për të cilët ne kemi folur kaq herë, në faqen 24, të pjesës së tretë, lexojmë: "Gjithë popullsia bullgare e qytetit të Ohrit si dhe gjysma e popullsisë vllahe e të njëjtit qytet, është nën juridiksionin fetar të ekzarkut bullgar". Kjo është konfirmuar nga Ishirkovi.<sup>34</sup>

Kështu, fakti i të qenit i nënshtruar ndaj njerit apo tjetrit juridiksion fetar, nuk do të thotë aspak, se nga pikpamja etnografike ato i përkasin kombësisë, kryetari shpirtëror i së cilës merr përsipër t'i ketë në varësi. Kisha nuk mund të jetë sinonim i ndërgjegjes kombëtare. Që kjo ndërgjegje kombëtare është bërë subjekt i lëkundjeve mjaft të shpeshta, janë vetë autorët serbë dhe bullgarë që e kanë pranuar një fenomen të tillë. Vetë Ishirkovi konstaton se "sllavët e Maqedonisë ndërrojnë bindjet etnike sipas prejardhjes së vendit, nga vjen para, duke u quajtur herë bullgarë, herë serbë dhe të nesërmen grekë".<sup>35</sup>

Teza e mbështetur nga Cvijiçi rreket të provojë që sllavët e Maqedonisë nuk kanë karakter të pastër etnik dhe janë të zhveshur nga ndjenja kombëtare, gjë që njihet mirë prej atyre që janë marrë me çështjen maqedonase. Ky autor shprehet tekstualisht: "Masa e popullsisë tek sllavët-maqedonë nuk ka një ndërgjegje kombëtare krejtësisht të pastër; ajo nuk ka të kaluar historike që t'i përkasë vetëm asaj; ajo nuk ka gjuhë letrare".<sup>36</sup>

Vetë Ishirkovi e pranon këtë<sup>37</sup> dhe shton jo pa trishtim se ndjenja kombëtare mungon në një pjesë të madhe të sllavëve të Maqedonisë. Ndërsa maqedonasi Misirkov<sup>38</sup> i njeh sllavët e Maqedonisë sa bullgarë, aq edhe serbe, por që nuk janë as njeri, as tjetri. Ata janë një racë më vete.

Është kisha deri në një farë mase, ajo që u ka ngulitur atyre këtë ndjenjë, që ende është shumë sipërfaqësore, por që mungon në thelb. Cvijiçi, me shumë arsye thotë: "Kur takon tek sllavët maqedonë një ndjenjë kombëtare bullgare ose serbe, duhet kuptuar që ajo iu është imponuar përgjithësisht nga propagandistët"<sup>39</sup>. Edhe një autor bullgar tjetër, i cili ka qenë për shumë kohë mësues shkolle dhe më vonë agjent konsullor në Maqedoni, kujton që, përpara themelimit të ekzarkatit, te sllavët e Maqedonisë mungonte krejtësisht ndjenja kombëtare.<sup>40</sup>

Ndërsa serbët dhe bullgarët, për të imponuar ndërgjegjen kombëtare, patën në shërbim të tyre kishat, bandat e armatosura, thikën e dinamitin dhe, çka është akoma më efikase, mbështetjen e fuqive të huaja, të afta për t'ia imponuar vullnetin e tyre Turqisë. Përpara kaq

shumë mjeteve në dispozicion të sllavëve, shqiptarëve u mbetej vetëm ndjesia e të lindurit në vendin e vet.

Mund të thuhet, pra, se në Ballkan rëndësi kryesore ka feja, e bashkë me këtë kombësia e propaganda e kishës dhe e priftërinjve. Nëqoftëse dikujt i kërkohet të thotë se kush është, ai para së gjithash do t'ju përgjigjet se është i krishterë ose shumë-shumë se është patriarkist ose ekzarkist. Do t'ju mbetej ju atëhere ta merrnit me mend, nëse ai person është serb, bullgar apo grek. Edhe në Rumani, deri në njëfarë mase akoma, edhe sot të vjetrit thonë se janë thjeshtë "të creshtin", që do të thotë të krishterë. Ndërsa një turk do të ndjehej i poshtëruar dhe i çnderuar po të thoshte se është turk, por do të shprehej krejt shkurt se është mysliman.

Përkundrazi një shqiptar, çfarëdo që të jetë ai: mysliman, katolik apo ortodoks, do të thotë para së gjithash se është "shqiptar". Një gjë e tillë është kaq e njohur, sa që banorët e Konstandinopojës kur shikojnë një shqiptar të sapoardhur që zbret nga anija, e pyesin: "Arnaut misin, mysliman misin?" (A jeni shqiptar apo jeni mysliman?), nga kënaqësia për ta parë shqiptarin të përgjigjet me padurim: "Arnaut".<sup>41</sup>

*Të gjitha shënimet në tekst janë të autorit  
Mid'hat Frashërit (S. Xhelo)*

- 1) *"Les Albanias en vieille Serbie et dans le sandjak de Novi-Bazar"* (Shqiptarët në Serbinë e vjetër dhe në sanxhakun e Novi-Pazarit), Chez Hachette, Paris.
- 2) *"Les Albanais et les grandes puissances"* (Shqiptarët dhe Fuqitë

## Mid'hat Frashëri

- e Mëdha), nga Dr. Vlladan Gjorgjeviç, ish kryetar i këshillit të ministrave të Serbisë, ish ministër fuqiptotë etj., përkthyer nga gjermanishtja nga princi Aleksis Karagjorgjeviç. Paris, Calman Lévy, 1913, f. 8-9.
- 3) Shih Jastrébov, Spomenik Srp. Krajl. Akademie, XLI, f. 334.
  - 4) Shih Ishirkov, Prinos kem etnografiata Makedonskite Slavini (në bullgarisht). Sofje 1907, f.9.
  - 5) Një autor politik francez Viktor Berard "Ne mendojmë që Mitrovica, Vuçiterni dhe Prishtina kanë një total prej 100.000 banorë nga ku 78.000 janë shqiptarë dhe vetëm 22 mijë sllavë. Berard "La Macedane" Paris 1897, fq. 141.
  - 6) Shih René Pinon, "L'Europe et l'Empire ottoman" (Europa dhe Perandoria otomane). Paris 1913, f. 143.
  - 7) Çjendet në veri të Shkodrës.
  - 8) Plus 18831 Grekë dhe 41158 Vllahë; Shqiptarët e bashkuar me Vllahët formojnë shumicën e popullsisë së Manastirit.
  - 9) Plus 11865 Grekë dhe 14987 Vllahë.
  - 10) Ne do t'i rikthehem më poshtë kësaj çështjeje, që për nga vlera e saj, është e një rëndësie shumë të madhe, nëse ajo studiohet seriozisht.
  - 11) Këto tregohen me numrat 48, 49, 52, 65, 74, Xhepçishta, Dobroshta, Gojrani, Gradec, Dolno Palçishta, Debrishta.
  - 12) "Makedoniya, etnografiya statistica" (në bullgarisht). Sofia 1900; i shoqëruar me 12 harta.
  - 13) Edhe 14.370 turq, 22.295 vllahë.
  - 14) Edhe 8.150 turq.
  - 15) Edhe 11.410 turq.
  - 16) Edhe 6000 turq; 1960 vllahë.
  - 17) Edhe 10.292 bullgarë-myslimanë; 3.380 turq.
  - 18) Edhe 6.565 bullgarë myslimanë.
  - 19) Edhe 4.340 bullgarë myslimanë; 3.925 turq; 9.590 grekë; 4.280 vllahë.
  - 20) Shih veprën "Blgarite v'Makedoniya" (në bullgarisht), Sofje, 1915, f. CII, CIII, CIV.
  - 21) Jordan Ivanov, vep. e cit. f. LXIII.

## Shqiptarë dhe Sllavë

- 22) Shih "Grad Skopié" (qyteti i Shkupit, në bullg.), nga Vasil Kençov, Sofje, 1898, f. 21, 22.  
Profesori Vajgand duke folur për Shkupin (*Die Aromunen, Leipzig, 1895, f. 43*), thotë se muhamedanët e qytetit janë shqiptarë dhe ndërmjet tyre ka vetëm një numër shumë të vogël turqish (tekstualisht: *Die hiesige muhammedaner sind meist Albanesen; es giebt nur wenige Türken darunter*).
- 23) René Pinon, "L'Europe et le Jeune Turquie". Paris, 1913, f. 334.
- 24) Disa autorë fjalën "beg" (bej, zotëri), e bëjnë sinonim të shqiptarit mysliman.
- 25) Në Bullgari bëhet gjithashtu një dallim ndërmjet Arnaut dhe Arbanas. I pari tregon një shqiptar të klasës së ulët dhe i dyti të një klase më të mirë; është gati e njëjta gjë me fjalët çifut dhe izraelit tek francezët.
- 26) Jos Muller në librin e tij "Albanien, Rumelien und die Ostrumelien", Pragë, 1844, f. 83, jep këto shifra për qytetin e Manastirit: 2400 osmanlli, 5800 sllavë myslimanë; 8000 shqiptarë; 9000 sllavë kristianë; 3500 grekë; 1400 çifutë; 700 vllahë; 1200 shqiptarë katolikë; 2000 ciganë. (statistikë e vitit 1838).  
Vepra anonime "Der aufstand der Griechen in Epirus", Pesth. Vienne et Leipzig, 1854, f. 22, e numëron Manastirin ndërmjet qyteteve shqiptare, sipas të njëjtës logjikë të përfshirjes së gjithë territoreve të tjera që shtrihen deri në gjirin e Artës.
- 27) Relacioni i Mariano Bolicës ka qenë publikuar ndërmjet të tjerash në librin e Lënormanit "Turcs et Monténégrin". Paris, 1866, Didier.
- 28) Vetë dijetari i një shovinizmi intransigent, Cvijiçi, pranon që Kuçi është një fis shqiptar. "Es befindet sich sogar innerhalb der Grenzen des heutigen Montenegro der stamm Kuci, der jetzt serbisch ist, höchstwahrscheinlich aber zueinem bedeutenden Teite aus Albaniern hervorgegangen ist, und daher auf meiner serbischer Albanern bezeichnet wurde". Petermanns Mitteilungen, 1913, vol. 50; Cvijiçi: Die ethnographische Abgrenzung, der Volker auf der Balkan Halbeninsel;



## Mid'hat Frashëri

P. 117, colonn 1.

- 29) "Blgarite v Makidoniya", nga Jordan Ivanov Sofje 1915, f. LXIII.
- 30) Shih gjithashtu më poshtë f. 34 pasazhin që ne kemi dhënë nga vepra Der Neu eröffneten Ottomemichen Pforten. Pettermans Mittelungen, 1913, vol. 53; Cvijici: Përbërja etnografike e popujve të Gadishullit Ballkanik f. 117, kolona 1.
- 31) Shih më poshtë një citim që e kemi huazuar nga G.L. Jaray, f. 40.
- 32) Po riprodhojmë këtu si dokument, një nga telegramet e shumta që kanë qenë dërguar prej shqiptarëve të këtyre krahinave, në kohën e luftës ballkanike, Shkëlqesisë së Tij, Sër Eduard Grej, sekretar i shtetit, kryetar i konferencës së ambasadorëve të Fuqive të Mëdha, Londër. "Ne, të nënshkruarit, shqiptarë me origjinë nga Dibra që banojmë në Rumani, të deleguar prej bashkëatdhetarëve tanë në mbledhjen e sotme të 12 janarit (1912), protestojmë energjikisht kundër presionit të ushtruar mbi bashkëatdhetarët tanë, të cilët ju kanë shprehur telegrafisht se janë të kënaqur nga administrata serbe dhe se refuzojnë të bëjnë pjesë në shtetin shqiptar. Të njohurit e gjuhës serbe në lokalitetet e përmëndura, katërcipërisht të njohura si shqiptarë, nuk provojnë aspak origjinën serbe. Kjo gjuhë është mësuar prej puntorëve shqiptarë që shkonin në Serbi për të ushtruar zanatet e tyre. Kritikojmë si të padenja procedurat serbe dhe deklarohe mi kundra çdo zgjedhë të huaj." (Nënshkruar) Néofit Siméon, Manoli Georges, Manoli Boshko, Niqifor Panteli, Ilija Rafael, Grigor Petre, Vasil Konstandin, Hamdi bej Dibra, Fejzi Ali, Ismail Fetah.
- 33) Shih Lumo Skëndo. "La population de l'Epir". Sofje, 1915, f. 8.
- 34) Ishirkov. "Zapadnata Kraichta na Blgarskata Zemya" (në bullgarisht). Sofje, 1915, f. LXXXII, ku mësojmë se elementi vllah, ka shërbyer shumë shpesh për të përforcuar dhe shtuar numrin e bullgarëve.
- 35) Shih veprën e tij "Prinos Kem etnografiyata na Makendonskite Slavini (në bullgarisht), Sofje 1907, f. 92.
- 36) "Shënime etnografike mbi Maqedoninë" (it.), nga J. Cvijic,

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

---

botimi i dytë, Paris 1917, f.5.

37) *Ishirkov*, vep. e cit., f. 35.

38) *Cituar nga Ishirkov*, vep. e cit., f.39.

39) *Cvijiç*, "Shënime etnografike mbi Maqedoninë", f. 11.

40) *Offeikoff*, "Maqedonia në pikëpamje etnografike, historike dhe filologjike", *Filipopol*, 1887, f. 45.

41) "Shqiptarët, një pjesë kanë qëndruar kristianë, shumica janë kthyer në myslimanë; por myslimani shqiptar ka qëndruar shqiptar... gjë që ilustron thellësinë dhe forcën e ndjenjës kombëtare shqiptare". *Gabriel-Louis Jaray*. "Au jeune royaume d'Albanie", Paris, Hachette, 1914, f. 198.

## II

**Sh**qiptarët formojnë bazën e popullsisë së vilajeteve të Kosovës dhe atij të Manastirit, e me këtë të fundit nënkuptohen kazatë e Dibrës, Ohrit, Kërçovës, Manastirit dhe Follorinës. Ky është elementi vendas, autokton dhe më i rëndësishmi. Ky është kombi që ka më shumë të drejtë në zotërimin e këtij vendi, elementi të cilit i takon e drejta e zotërimit të këtyre viseve. Ai ka me vete të drejtën historike dhe domosdoshmërinë politike, të drejtën natyrore të jetës.

Në një kohë kur sllavët (si serbët, ashtu edhe bullgarët), kanë synime tepër të largëta, ambicje për zgjerim dhe begatim në disa drejtime, shqiptarët pretendojnë, veç për zotërimin e asaj që duhet t'iu takojë, të asaj që do ta formojë Shqipërinë njëherë e përgjithmonë, pa pasur kurrë lakmi për më tepër. Ajo duhet të ketë kufijtë e saj natyrorë, sa etnografikë aq edhe ekonomikë, ose përndryshe do të krijohet një shtet dështak, me farën e vdekjes që në lindje.

Që kjo Shqipëri të jetojë duhet të ketë si kufij: në perëndim detin Adriatik, në veri liqenin e Shkodrës, malet e Tërgovishtës, duke përfshirë Shkodrën, Hotin, Grudën, Gucinë, Plavën, Pejën dhe gjithë fushën që shtrihet deri në veri të Mitrovicës, më saktë, në fshatin Beloçicës, mbi

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

kufirin e vjetër serb, të para luftës turko-ballkanike.

Në lindje ai duhet të ndjekë kufirin e vjetër të Serbisë (domethënë të paraluftës së 1912) deri në Zibefçe; të marrë kthesën drejt jug-perëndimit deri në liqenin Kapllan, në lindje të Shkupit. Në këtë mënyrë kazatë e Kumanovës, Gjilanit dhe Preshevës do të mbesin në Shqipëri; e, duke u nisur nga liqeni i Kapllanit vija do të shkojë në jug, drejt lartësive të Babunës (duke lënë Kyprilin-Velezhin jashtë Shqipërisë) për të prekur vargun e kodrave të quajtura Morihova, në lindje të Manastirit, në atë mënyrë që ky qytet dhe fusha rrethuese të mbeten brenda kufijve të Shqipërisë. Më në jug linja kufitare do të përfshijë Follorinën dhe, duke kaluar në perëndim të Kosturit, domethënë duke e lënë këtë të fundit jashtë kufijve të Shqipërisë, ajo do të përfshijë gjithë kalanë e Bilishtit për t'u bashkuar me vargmalin e Gramozit dhe vazhduar në kreshtën e këtyre maleve deri në Meçovo, mbi Pind, në kufirin e vjetër turko-grek të para-luftës së vitit 1912. Nga Meçovo linja do të zbresë në gjirin e Artës për të gjetur kështu kufirin jugor natyror të Shqipërisë, që është gjiri i Ambrakisë.

Vetëm e përfshirë brenda këtyre kufijve që thamë, Shqipëria mund të ekzistojë, të qeveriset e të qendrojë gjatë. E cunguar dhe e shtrënguar, Shqipëria nuk ka tjetër të ardhme, veçse të kthehet në vasale të shteteve të tjera ballkanike, të cilat e kërcënojnë papushim dhe ia zenë frymën, duke e mbyllur në një rreth të ngushtë. Një Shqipëri e tillë, si ajo që ne përcaktuam më parë, do të kishte tre milionë banorë, ku afro një e dhjeta e të cilëve

do të përbëhej nga elementë të huaj (grekë, serbë, bullgarë, vlllehë, ciganë), çka nuk do të ishte dhe nuk do të mund të konsiderohej aspak si një peshë e përfillshme për vendin e ri, nëse dëshirojmë të pranojmë se në kohën e krijimit të Bullgarisë kishte gati 50% turq brenda kufinjve të principatës saj.

Një Shqipëri si kjo, do të jetonte, sipas nesh, në sajë të kufijve të saj etnografikë dhe ekonomikë. Në fakt, a mund të merret me mend, që Shqipëria e kufizuar nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës më 1913, të jetë një Shqipëri e shëndoshë dhe solide? Asaj i janë privuar tokat më të mira që kishte, fushat më të bukura, qendrat më të rëndësishme dhe i janë shkëputur dy të tretat e popullsisë. Tokat pjellore të Janinës dhe të Prevezës, kullotat e famshme të Çamërisë iu dhanë Greqisë, Serbia mori fushat e Manastirit, Ohrit, Tetovës, Shkupit, ndërsa rrafshi i bukur i Kosovës ishte ndarë ndermjet serbëve dhe malazezëve, për t'i dhënë Shqipërisë një zonë malore gati të shkretë, të privuar nga mjetet e komunikacionit, dhe të bllokuar nag bora gjashtë muajt e vitit. Nga ana tjetër, është treguar kujdes që të lihen jashtë kufijve shqiptarë qytetet, qendrat e natyrshme të furnizimit të këtyre maleve.

Në pikëpamje kulturore dhe etnike, këto kufij janë të domosdoshëm, sepse është pikërisht pjesa e popullsisë që banon në qytetet e mëdha të jugut, të lindjes dhe të veriut, në saj të vendeve të bukura dhe të shëndetshme që ruajnë ato, si edhe të kushteve ekonomike, që formon ndër të gjithë shqiptarët, elementin më aktiv, më të begatë

dhe më të dobishëm. T'ia mohosh Shqipërisë këto, domethënë t'ia mohosh stabilitetin, të grumbullosh një sasi populli, në vend që t'i bashkosh një komb, t'i ngarkosh mbi shpinë mjerimin dhe privacionet një populli që, sapo ka lindur dhe i cili, tani më shumë se kurrë ka nevojë për mirëqënie, në mënyrë që të mund të nisë të zhvillohet.

Kjo Shqipëri, e formuar prej katër vilajeteve të vjetra: të Janinës, Manastirit, Shkupit dhe Shkodrës, është ajo që shqiptarët kërkojnë qysh nga fillimi i zgjimit të tyre kombëtar. Ka më se 40 vjet që këto aspirata u kristalizuan pastër dhe morën formë mjaft të qartë në kohën e lidhjes së famshme shqiptare, të quajtur "Lidhja e Prizrenit". Kërkesat e kësaj organizate kombëtare ndaj Portës së Lartë dhe Fuqive të Mëdha synonin autonominë administrative të Shqipërisë, domethënë të katër vilajeteve: Janinës, Manastirit, Shkupit dhe Shkodrës, me Manastirin si rezidencë, me një guvernator të vetëm të përgjithshëm (valiu), që do të vihej në krye të Shqipërisë autonome, e cila do të gëzonte privilegjin që të kishte të folmen e vet si gjuhë të administratës, si dhe një milici kombëtare.

Që nga kjo kohë, shqiptarët nuk kanë pushuar së konsideruari për asnjë çast si territore të tyre, këto kater vilajete. Fuqitë e Mëdha, duket sikur ua njohën shqiptarëve të drejtën mbi këtë Shqipëri të plotë, që në të njëjtën kohë do ta quanin normale. Është e vërtetë që Konferenca e Berlinit shkëputi pjesë nga tokat e Shqipërisë. Vrania, Kurshumlia, Nishi dhe Leskovaci ia dha Serbisë. Ndërsa Malit të Zi u vendos që t'i jepeshin

distriktet e vegjël të Plavës dhe Gucisë, por duke u ndeshur në rezistencën ngulmuese të shqiptarëve, këto u këmbyen me Ulqinin dhe Tivarin; një humbje kjo tepër e dhimbshme për Shqipërinë. Por nga ana tjetër, Fuqitë e Mëdha e zbatuan me rreptësi vendimin për dhënien e Janinës, Greqisë, kurse lidhur me territorin që do t'i jepej Malit të Zi, atyre iu desh të kombinonin sulmin e forcave të armatosura osmane me manifestimin detar të një flote ndërkombëtare pranë brigjeve shqiptare. Domosdoshmëria politike i bëri ata të veprojnë kundër ndërgjegjes së tyre, sepse burrat e shtetit kishin qenë të bindur se Ulqini dhe Tivari, ashtu si Vrania dhe Nishi, ishin territore shqiptare dhe aspak sllave.

Burri i shtetit, lordi anglez Fitzmaurice, ishte njeriu më i bindur për këtë të vërtetë. Ai ka mbajtur një qëndrim tepër fisnik gjatë krizës lindore të viteve 1878-1880. Korrespondencat e tij me Foreign Office-in, të cilat gjenden në Librin Blu të asaj kohe, meritojnë admirimin dhe mirënjohjen e çdo shqiptari. Ja se si, në një broshurë të vogël mbi çështjen e Orientit përmbledhet vepra e Fitzmaurice:

“Lordi Fitzmaurice ishte një mbrojtës i zjarrtë i të drejtave dhe interesave të shqiptarëve. Në takimin e parë që ai pati me Savas Pashanë, ministrin e Punëve të Jashtme, ai insistoi në domosdoshmërinë që përbënte për Përandorinë Osmane mbajtja parassysh e këtyre të drejtave, duke i shtuar atij se Shqipëria nuk ishte vetëm ajo që jemi mësuar ta quajmë me këtë emërtim gjeografik, domethënë dy vilajetet: i Shkodrës dhe i Janinës, por ajo

që shtrihet në drejtim të lindjes deri në vijën e maleve që ndajnë rrjedhën e ujërave që derdhen në Adriatik dhe në Egje, duke përfshirë një pjesë të madhe të vilajetit të Manastirit dhe atij të Prishtinës ose Kosovës dhe, drejtë veri-lindjes (siç është treguar në mënyrë të veçantë në hartën e Keipertit, e cila është konsideruar përgjithësisht si e favorshme ndaj elementëve sllavë, dhe në atë të z. Stanford, të bërë në interes të grekëve) deri në Prishtinë dhe në qytetin e Vranjës.

Lordi Fitzmaurice, i patundur në pikëpamjet e tij dhe duke sprapsur prerazi pretendimet e ngritura nga serbët mbi origjinën e banorëve të Mitrovicës dhe të Kosovës, përmes letrës që i dërgon Foreign Officeit me datën 22 korrik 1880, përsërit se të gjitha hartat me të cilat ishte konsultuar, dëshmonin origjinën shqiptare dhe jo sllave të këtyre viseve megjithëse, këto rrethe, në fund të shekullit të XVII ishin të banuara prej serbëve dhe përfshiheshin në mbretërinë e vjetër serbe. Banorët vendas të këtyre viseve, sipas Hahnit, konsullit austriak të Janinës, kanë qenë shqiptarë të shpronësuar nga serbët në shekullin XIV."

"Pas përcaktimit të pastër dhe kategorik të terrorit shqiptar, çështja e ekzistencës politike të tij qe diskutuar jo me më pak vendosmëri dhe drejtësi.

Lordi Fitzmaurice, i mbështetur nga qeveria e tij dhe duke patur përkrah lordin Goshen, ambasador i jashtëzakonshëm pranë sulltanit në këto momente, insistonte pranë kolegëve të vet për t'u bërë të njohur domosdoshmërinë e krijimit të një province të madhe



## *Mid'hat Frashëri*

shqiptare, të ndarë në katër vilajete (ose sanxhaqe), të cilët ishin: Shkodra, Janina, Kosova dhe Manastiri.”

“Kabineti i St.Xhejmsit e aprovonte plotësisht mënyrën e veprimit të lordit Fitzmaurice dhe pikëpamjet e gjëra dhe të largpamëse të lord Goshenit, të cilat paraqiten në mënyrë mjaft përmbledhëse në letrën që ai i dërgon lordit Granville më 26 korrik 1880.

Kështu që atij iu duk krejt i natyrshëm zemërimi i shqiptarëve, të cilët krijuan lidhjen e famshme të 1878-ës; shkëlqesia e tij thoshte: Kjo racë e vjetër dhe e shquar ka parë se si racave të tjera fqinje, kombësia iu njoh dhe iu mbrojt në kurriz të saj, prej fuqive të ndryshme europiane dhe se aspiratat e fqinjëve u realizuan, pjesërisht falë ekzistencës së tyre si të pavarur.

Ajo ka parë se bullgarët u emancipuan krejtësisht në Bullgari dhe pjesërisht edhe në Rumelinë lindore. Ajo ka parë dëshirën e zjarrtë të Europës që territori i banuar prej grekëve të hiqte qafe zgjedhën turke. Ajo ka parë që sllavët e Malit të Zi të mbroheshin me entuziazëm dhe në mënyrë konstante nga perandoria e madhe e sllavëve të veriut. Ajo ka parë që çështja e vendeve të Lindjes dukej se po merrte zgjidhje sipas parimit të kombësive dhe se gadishulli i Ballkanit ishte ndarë gradualisht në raca të ndryshme, sipas të njëjtit parim.

Në vazhdim, ajo sheh se vetëm asaj nuk i jepet një trajtim i ngjashëm. Kombësia e saj është e kërcënuar në veri nga malazezët që mbrohen nga Rusia, në jug prej grekëve që mbrohen nga Anglia dhe Franca”.

Mbas kësaj mbrojtje kaq të paanshme dhe të

sinqertë, lordi Goshen hyn në vlerësimin e avantazheve politike që një Shqipëri e fortë do të kishte në të ardhmen, duke shtuar: “Nëqoftëse krijohet një Shqipëri e fortë, motivet e pushtimit nga një fuqi e huaj, në rast shpërbërjeje të Perandorisë Otomane do të zhdukeshin.

Një Shqipëri do të mbyllte rrugën për në veri dhe do të mbante gadishullin ballkanik në duart dhe në autoritetin e atyre që janë në atë vend. E thënë ndryshe, fuqia e shqiptarëve do të krijonte një vështirësi të pakapërcyeshme në çastin kur do të shfaqesin turbullira. Një popullsi, me pjesën më të madhe të saj myslimane, do të ishte një burim vështirësish të mëdha për vendet sllave ose greke që do ta pushtonin atë. Unë mendoj se mundësia e ndërhyrjes evropiane në Gadishullin Ballkanik do të zvogëlohej, në raport me forcimin natyral të kombësisë shqiptare”.<sup>1</sup>

Lidhja e famshme shqiptare, siç e kemi theksuar edhe më lart, nuk mundi të shpëtojë, veçse disa copa të tokës shqiptare. Nga ana tjetër, ajo fatkeqësisht, dështoi në tentativën për të fituar një autonomi për gjithë Shqipërinë, për ta bërë Turqinë ta njohë zyrtarisht egzistencën e kësaj kombësie shqiptare, duke i bashkuar të katër vilajetet në një të vetëm.

Turqia u frikësua nga shfaqja e këtyre aspiratave të reja dhe me të drejtë mendoi se, nëqoftëse ajo i pranonte rivendikimet shqiptare, atëherë ajo do të humbiste mbështetjen e saj të fundit në Europë.

Padyshim, që përveç këshillave të Fuqive të Mëdha evropiane, nuk kanë munguar dhe disa ambasadorë

“dashmirës” duhet t’i kenë pëshpëritur në vesh Abdyl Hamidit të vrenjtur që t’u kundërvihet edhe më tepër shqiptarëve, duke e shtyrë që të përdorë forcën ushtarake kundër “rebelëve”.

Megjithatë, rishikimi i traktatit të Shën Stefanit dhe cungimi i Bullgarisë së madhe të ëndërruar nga Rusia, a nuk përbën një njohje të heshtur të së drejtës së shqiptarëve në Maqedoninë Lindore?

Që nga kjo ditë shqiptarët kanë shtruar vendosmërisht në programin e tyre, autonominë e katër vilajeteve<sup>2</sup>, një administratë që do t’u jepte atyre të drejtën e përdorimit të gjuhës kombëtare në hallka të ndryshme të saj, ushtrimin e kontrollit mbi buxhetin dhe kryerjen e shërbimit ushtarak brenda vendit në kohë paqeje. Më vonë shqiptarët do të mendonin për një kishë autoqefale, e cila do t’i çlironte nga influenza greqizuese e patriarkatit të Konstandinopojës.

Njihet tashmë vargu i persekutimeve të bëra nga ana e sulltanit Abdyl Hamid dyshues, objekt i të cilave u bë Shqipëria. Ky monark i vrenjtur, në dukje kishte dobësi për shqiptarët si individë dhe si racë, shfaqte njëherësh një frikë supersticioze kur bëhet fjalë për kombësinë e tyre dhe veprimet në shërbim të kësaj ideje. Ai mori të gjitha masat dhe e përqendroi të gjithë zgjuarsinë e tij, që disa thonë se ishte gjeniale, për t’ua larguar vëmendjen shqiptarëve dhe për të mbytur çdo shfaqje që tentonte drejt këtij synimi, duke mos u tërhequr përpara asnjë mjeti: internimeve, burgimeve, e çdo mjeti që mund të kishte efekt, deri tek shtypja me gjak e revoltave të

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

paorganizuara, apo tërheqja në Stamboll e personave të aftë për t'u bërë krerët e nacionalizmit, duke i ngarkuar atyre poste honorifike e në të njëjtën kohë duke i mbajtur nën një mbikqyrje të rreptë.

Megjithatë ideja e autonomisë për katër vilajetet nuk u nda asnjëherë nga mendja e shqiptarëve. Veprimtaria e shoqatave të tyre letrare e patriotike të vendosura jashtë Turqisë - larg zonës së influencës së sulltanit - gjenin jehonë në zemrat e të gjithëve dhe botimet patriotike përpiheshin nga rinia. Veprimtaria e fshehtë, e ngadaltë, këmbëngulëse, por depërtuese dhe efikase, po bënte punën e vet, pa njohur asnjë çast shkurajimi, megjithë persekutimin turk dhe kërcënimet sllave, bullgare e serbe, nën patronatin e Ruisë së madhe, gjë që e ndërlikonte çështjen tmerësisht, duke vënë përpara tre armiq njëherësh, në vend të njërit. Kështu shqiptarët kanë shtruar shpesh herë përpara vetes pyetjen se cili prej tyre është më i rrezikshëm për Shqipërinë: turku apo sllavi, ndonëse shumë herë atyre iu është dhuruar t'i bashkojnë forcat e veta me ato të turkut për t'i drejtuar kundër armikut të papajtueshëm shkja,<sup>3</sup> sa herë pretendimet e tyre rrezikonin ekzistencën kombëtare. Autorët e huaj e kanë vënë re këtë fenomen dhe e kanë kuptuar fort mirë. "Urrejtja për sllavin në Kosovë është një çështje race", - thotë Dr. Xhejk,<sup>4</sup> i cili, sidoqoftë, nuk është mik i shqiptarëve; por po ky, një faqe më sipër, këmbëngul se tek shqiptarët mungon fanatizmi. "Unë dëshmoj se kurrë dhe në asnjë pjesë të vendit, shqiptari nuk ka qenë fanatik. Fanatizmi ekziston në Bosnjë, në Bullgari, në Kretë, por

jo tek shqiptarët”.

Konfliktet, pra, që shqiptarët kanë patur me sllavët, të cilët kërcënonin bazën e ekzistencës së tyre, nuk kanë qenë aspak konflikte fetare, dhe as një konflikt i rëndomtë kaçakësh, opinion të cilin kanë synuar ta krijojnë lajmet e agjencive sllave apo sllavofile, por rrjedhojë e natyrshme e një luftë midis një populli që dëshiron të jetojë i lirë në shtëpinë e vet dhe pushtuesve të panginjur sllavë.

G. Muir Mackenzie dhe A.P.Irby, dy zonja angleze, të cilat kanë udhëtuar në pjesën lindore dhe veriore të Shqipërisë gjatë gjysmës së fundit të shekullit të XIX-të, konfirmojnë se kjo urrëjtje është reciproke dhe e bazuar vetëm mbi ndryshimin racor. Në faqen 166 të librit të tyre,<sup>5</sup> ato i pyesin në Shkup një tregtar me origjinë nga Mali i Zi, se kush është më i keq për sllavët, myslimani boshnjak apo shqiptar? - Shqiptari, përgjigjet sllavi, - ai flet një gjuhë të ndryshme nga e jona dhe është armiku ynë, edhe nëse nuk është mysliman. - Po cili prej këtyre të dyve e mban fjalën e dhënë, besën? - e pyetën sërish udhëtarët.

“Shqiptari, nuk e ha kurrë fjalën, kurse një boshnjaku mysliman nuk i zihet besë”, përgjigjet tregëtari. Përveç kësaj, është rasti të kujtojmë se shqiptarët e krishterë (në të vërtetë katolikët), janë kundërshtarët më të paepur të sllavëve, qofshin këta malazezë apo serbë.

Për të parë një shfaqje më të ndritshme të vullnetit të të gjithëve, para së gjithash duhet të studiohen ngjarjet që kanë pasuar atë që Xhonturqit e quajnë Kushtetuta e tyre. Në këtë kohë pati një shpërthim të vërtetë ndjenjash

për kombin, deri atëhere thuajse të padallueshme dhe të shtypura nga regjimi hamidist. Shqetësimi për të konfirmuar të drejtën e vet ndjehej në çdo anë dhe këtë radhë përgatitja bëhej për një luftë të hapur, me nxitim për të rifituar kohën e humbur, të alarmuar tashmë edhe nga pretendimet e zhurmshme të elementëve sllavë, këtyre të huajve që kishin bërë zakon të mbaheshin përmbi zotin e shtëpisë. Nga Follorina në Mitrovicë, përgjatë kufirit të territorit shqiptar u themeluan një seri klubesh shqiptare. Përveç ruajtjes së trashëgimisë së të parëve, organizimi i klubeve kishte si qëllim të luftonte kundër shovinizmit të xhonturqve, të cilët kishin filluar të ëndërronin për një turqizim të të gjitha racave, ashtu edhe kundër ambicjeve dashakeqe të tre fqinjëve të Shqipërisë: Greqisë, Serbisë dhe Bullgarisë. Kjo qe një periudhë e gjatë luftërash të ngadalshme, të durueshme dhe shpesh herë ndonë shenjë të jashtme për të tërhequr vëmendjen.

Këto qendra sa vinte e zgjeroheshin. Të mbushur me pasion, të gjithë shqiptarët e kishin të qartë që këtë herë bëhej fjalë për të luftuar ashpër dhe me vendosmëri për jetën dhe ngadhënjimin. Çdo qytet, çdo fshat i madh, dëshironte të merrte pjesë në luftë dhe të kontribuonte për veprën. Klubi i Follorinës ishte një nga më të lulëzuarit, kurse ai i Manastirit një nga më të fuqishmit ndërmjet gjithë të tjerëve. Lokalitete të tilla si bie fjala Velezhi (Kypri) që numëronte vetëm një numër të vogël shqiptarësh në qytet, por që kazaja e të cilit kishte disa fshatra shqiptare, dëshironte të ishte në vendet e para, duke qenë të vetëdijshëm për detyrën dhe shumë të bindur në rëndë-

sinë dhe seriozitetin e çështjes. "Klubet janë mburoja e nacionalizmit shqiptar", vinte në dukje me shumë të drejtë, Gabriel Luis-Jarai.<sup>6</sup>

Në vjeshtën e vitit 1908 (viti i famshëm e njëherësh fatal i revolucionit xhonturk), në Manastir mbledhjet një kongres i madh, ku merrnin pjesë të gjitha klubet, për të konfirmuar përpara shovinizmit xhonturk vullnetin e shkrimit të shqipes me alfabetin latin. Turqit nuk lanë gur pa luajtur për të mbjellur mosmarrëveshje e për të përçarë pjesëmarrësit. Ata shpresonin se një ditë do të adoptohej alfabeti "katolik" arab (me origjinë hebraike), përndryshe do ta bënë të dështonte këtë vepër nacionaliste të Rilindjes shqiptare. Por përpiqeshin më kot, sepse të gjithë pjesëmarrësit, përfshirë këtu, sidomos myslimanët dhe hoxhallarët e deleguar të klubeve, votuan edhe njëherë për alfabetin latin, jo vetëm, sikurse, është thënë - se ky alfabet është më i thjeshtë për të shkruar një gjuhë indoeuropiane, e të ngjashme me atë latine, por, gjithashtu, e para së gjithash, sepse në këtë mënyrë synohej oksidentalizimi, shkëputja nga Orienti dhe traditat e tij skolastike.<sup>7</sup>

Kjo mbledhje e Manastirit, kryevendit të ëndërruar të katër vilajeteve të bashkuara shqiptare, qe një eveniment, që la pas një jehonë të madhe. Por një tjetër kongres që pati efekt më të madh ishte ai i Dibres, ku xhonturqit kishin thirrur të gjitha kombësitë ballkanike të turqisë europiane. Në të vërtetë, sipas mendjes së oficerëve xhonturq, synimi ishte që të gjithë elementëve t'iu imponohej pikëpamja turke dhe të gjithë kombet të

shpalleshin osmanlli. Por mbas pak, kongresi mori një fizionomi krejtësisht shqiptare, ku xhonturqit u ndodhën përpara shfaqjes së aspiratave të pastra kombëtare, të shprehura me forcë. Në këtë mënyrë nga një mbledhje ndërkombëtare dhe xhonturke që duhej të ishte, kongresi i Dibrës përfundoi në një kongres të pastër shqiptar dhe në disfavor të xhonturqve dhe sllavëve që merrnin pjesë.

Një anglez, gazetar dhe vëzhgues i mirë, i cili ishte njohës i thellë i problemeve turke në përgjithësi dhe i Ballkanit në veçanti, ka ditur të shquajë rëndësinë e këtij kongresi të famshëm. Ja se çfarë shkruan Charles Woods<sup>8</sup>, ky është emri i gazetarit anglez mjaft të njohur atëherë, ndonëse versioni i tij mbi origjinën e mbledhjes së Dibrës ndryshon pak nga ai që ne kemi dhënë më lart:

“Kongresi i Dibrës, që u mbledh në korrik, u organizua prej anëtarëve të komitetit shqiptar për t’u treguar bashkatdhetarëve të tyre mundësinë e diskutimit të çështjeve të mëdha politike sipas pikëpamjes shqiptare.

Rëndësia e këtij kongresi qendron jo vetëm në disa vendime që mori, vendime që në mënyrë të padyshimtë provojnë se populli shqiptar nuk mund të shtypet lehtë, por, edhe se nuk mund të trajtohej në mënyrën se si u trajtua nga xhonturqit... Në fillim kongresi miratoi raportin e paraqitur nga xhonturqit dhe pastaj i shtoi atij klauzola suplementare, të cilat tregojnë më së miri vetë ndjenjat e shqiptarëve. Midis vendimeve të adoptuara nga kongresi, figuronte edhe kërkesa për më shumë drejtësi në gjykata dhe për ngritjen e shkollave të veçanta në Shqipëri.



## *Mid'hat Frashëri*

Diskutimeve energjike u zhvilluan, gjithashtu mbi dobinë e ndërtimit të rrugëve në Shqipëri dhe të fiksimit përfundimtar të kufirit turko-malazez...”

Pak kohë mbas kësaj një mbledhje e tretë, u mbajt në Elbasan, kësaj here për të menduar për mënyrën e organizimit të shkollave shqiptare. Aty përfaqësoheshin të gjitha klubet, bile, edhe ato të qyteteve të largëta si Karaferia, Katerina dhe Drama, të vilajetit të vjetër të Selanikut<sup>9</sup>.

Kongresi u shpërnda duke lënë një takim të ardhshëm për vitin në vazhdim (1910) në Janinë. Dihet mirë se çfarë u bë në këtë vit. Dihet mirë verbëria e turqve dhe kokëfortësia e marrosur e tyre në zellin për të shtypur ndjenjën kombëtare shqiptare.

Pati një seri ekspeditash që kishin si mision vendosjen e qetësisë në Shqipëri, sipas eufemizmës që kishin adoptuar nga Çezari. Kjo ishte një mënyrë për të vendosur rendin si në Varshavë. Gjatë tre viteve shqiptarët nuk u lanë për asnjë çast të marrin frymë. Përveç klerit grek, i cili ka qenë gjithnjë një prej kundërshtarëve të përbetuar të shqiptarëve dhe të ideve nacionaliste shqiptare,<sup>10</sup> këtë herë u panë, gjithashtu, edhe sllavët të lidhen me autoritetet turke dhe të kërkojnë persekutimin e shqiptarëve, të quajtur fajtorë vetëm pse duan të hapin shkollat e tyre e të shkruajnë gjuhën me gërma latine!

Vitet 1910, 1911 dhe 1912 qenë një seri betejash dhe luftimesh ndërmjet shqiptarëve dhe turqve: Xhavid Pasha, Shefqet Dërgut Pasha, Fadil Pasha, për të përmendur veç të mëdhenjtë, të gjithë njerëz të besuar të

famshmit Mahmut Shefqet, e kishin për nder të shkonin e të luftonin shqiptarët në Kosovë, në Shkodër apo në Lumë. Ky ishte një fatalitet që e çonte vetë Turqinë t'i vinte kazmën themeleve të sundimit të saj me Turqinë europiane. Në një çast shqiptarët qenë më të fortë: ata hynin fitimtarë në metropolin e tyre mbi brigjet e Vardarit, në Shkupin e bukur, dhe aty ata u diktonin vullnetin e tyre xhonturqve, të shtrënguar këtë herë të bënin lëshime përballë argumenteve kaq të qartë.<sup>11</sup> Partia "Bashkim Përparim" ishte përmbysur dhe qeveria e re që formonte Ahmed Myftar Pasha dhe më vonë Qamil Pasha, vendoste në programin e saj që të pranoheshin të gjithë kërkesat e shqiptarëve.

Mjerisht, në kohën kur mendohej se çështja shqiptare po hynte në një fazë normale paqeje dhe organizimi, kur shpresohej se kishte ushtuar trumpeta për mbylljen e tempullit të Janus-it dhe fillimin e një epoke të re aktive, që i kushtohej kulturës dhe begatisë, pikërisht në atë kohë shpallej vendimi kundër kombit shqiptar, i prononcuar nga armiqtë e përbashkët të Turqisë dhe Shqipërisë. Ishin shqiptarët ata që e mundën Turqinë dhe tani armiqtë e kësaj Shqipërie vrapuan ta copëtojnë e iu hodhën atyre të ndajnë plaçkën pa pyetur hanxhiun.

Triumfi i shqiptarizmsë e kishte përshpejtuar lidhjen ballkanike.<sup>12</sup> Pa përpjekjet e tre viteve të luftës së shqiptarëve kundër turqve, kurrë aleatët ballkanikë nuk do të kishin guxuar t'i shpallnin luftë Turqisë. Autori i këtyre rreshtave ka kaluar nëpër Serbi, tamam, të nesërmen e shpalljes së mobilizimit, dhe unë e di se qeveria e

kishte ndjerë të domosdoshme të lajmëronte nëpër gazetatat zyrtare se shqiptarët jo vetëm nuk do të marshonin kundër Serbisë, por përkundrazi, ata do të marshonin kundër Turqisë së bashku me serbët. Kjo dukej qartë se ishte një gënjeshtër, por kaq mjaftonte për t'u dhënë zemër të vetëve. Për më tepër, as Greqia nuk do të kishte guxuar të shpallte mobilizimin, nëse xhonturqit nuk do të ishin vënë në pozita lufte me shqiptarët. Mund të thuhet, pra, se lufta turko-ballkanike, në fakt, kishte filluar jo në vjeshtën e vitit 1912, por tri vjet më parë, në vitin 1909, kur filloi ekspedita e famshme turke në Kosovë. Shqiptarët qenë ata që mbajtën peshën e një lufte ngulmuese dhe të pabarabartë. Katër aleatët erdhën vetëm në ndarjen e plaçkës, kur puna më e madhe tashmë ishte kryer. Ata arritën jo për të copëtuar të mundurin, Turqinë e sëmurë të Carit, por fitimtarin e një dite më parë, Shqipërinë, e cila gjithashtu kishte të drejtën e jetës mbi tokën e gadishullit ballkanik, me cilësinë e saj të dyfishtë: si kombi më i vjetër, si dhe për luftën që kishte bërë.

Kur u desh të bëheshin bilancet, aleatët preferuan më mirë të mos i njohin të drejtat e shqiptarëve; ata e injoruan të kaluarën e tyre, megjithëse shumë të afërt, dhe ndokush pyeti i habitur, nëse kishte në fakt një Shqipëri mbi rruzullin tokësor, madje iu duk çudi që shqiptarët e shpallën pavarësinë e tyre pak ditë pas shpërthimit të luftës e që Italia me Austro-Hungarinë ishin të vendosura për ta mbështetur shtetin e ri.

Gjendja aktuale e vilajeteve të Manastirit dhe të Kosovës, domethënë të asaj që sllavët e quajnë Maqedoni

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

Perëndimore dhe Serbi e Vjetër, dy emra që kanë veçse një kuptim shumë të turbullt historik, por që shqiptarët si njerëz të thjeshtë e praktikë e quajnë Shqipëria Lindore, pra, gjendje aktuale e kësaj krahine, themi se, dëshmon për të drejtën e shqiptarëve. Shqyrtimi i statistikave, edhe po t'i pranojmë ashtu siç janë përpiluar ato nga fqinjët tanë, tregojnë zotërimin e madh natyral të elementit shqiptar.

Le të ndalemi pak mbi të kaluarën e këtyre viseve, meqenëse kundërshtarët e shqiptarëve i referohen nganjëherë të drejtës historike për të mbështetur pretendimet e tyre.

Dihet mirë se historia nuk nis nga mesi, por ajo nisët nga origjina e hershme e saj. A ka qenë e banuar prej sllavëve kjo pjesë e kontinentit europian që në agimin e kohëve historike? A janë serbët ose bullgarët që përmenden si banorët e parë të kohëve historike dhe bile prehistorike në krahinën perëndimore të gadishullit Hemus?

Historianët, etnografët dhe gjeografët, na vënë në dijeni se ilirët dhe thrakasit ishin popujt që mbulonin gati shumicën e vendit, që shtrihej nga Danubi deri në Greqi dhe se maqedonasit dhe epirotët janë konsideruar si fise të ngjashme me ilirët. Të njëjtët dijetarë, e në këtë rast teza e tyre mbështetet edhe prej gjuhëtarëve, janë dakord t'i njohin shqiptarët e sotëm si pasardhës të iliro-maqedono-epirotëve të vjetër. Shqiptarëve iu është njohur cilësia e kombit autokton në Ballkan; ardhja e tyre humbet në natën e epokave prehistorike, ndërkohë që antikiteti i

## *Mid'hat Frashëri*

---

tyre është një gjë e pranuar unanimisht nga gjithë dijetarët, pa qenë kundërshtuar kurrë. Janë, pra shqiptarët, që mund të quhen banorët e parë të vendit, dhe janë sërish ata që, si një racë autoktone, kanë të drejtën e atij që zuri për herë të parë këtë vend.

Autoktonisë së shqiptarëve u kundërvihen sllavët e ardhur nga jashtë dhe nga mjaft larg: serbi, djepi i të cilit është përtej Karpateve, dhe bullgari i ardhur nga Azia me një gjuhë të huazuar. Këto dy raca, të cilët bashkësia e gjuhës i klasifikon në familjen e madhe të popujve sllavë, vinin si pushtues dhe merrnin në zotërim territorin që nuk ishte aspak i tyre, në asnjë pikëpamje. Padyshim, që mund të thuhet se pushtimi i një vendi përbën një të drejtë mjaft të fortë, që nuk ka nevojë për argumente të tjerë për të provuar se cili është zotëruesi. Po kjo e drejtë, a mos vallë është e pamohueshme për gjithë jetën dhe efekti i saj, mos vallë duhet të zgjatet në vazhden e pandërprerë të shekujve të mëvonshëm, në një kohë kur vetë thelbi i kësaj të drejte do të jetë zhdukur e asgjësuar? Me fjalë të tjera, nëse humbet një rrip toke të cilin e ke pasë uzurpuar dikur, a mos vallë do të vazhdojë të njihet ende e drejta mbi të?

Është e vërtetë se serbët dhe bullgarët i kanë shtrirë zotërimet e tyre deri në brigjet e Adriatikut e madje deri në kepin e Matapan dhe se në formë hordhish a fisesh të organizuara në shtet ata kanë mundur të pushtojnë pjesën më të madhe të gadishullit ballkanik. Por për këtë çështje kanë interes vetëm historianët, sikurse edhe për pushtimet e gotëvë, sundimin e Shalërmanjit ose pushtimet e

arabëve dhe turqve.

Cili shtet, cila qeveri në mes atyre që ekzistojnë sot në rruzullin tokësor, do t'u rezistonte argumenteve të ngjashëm, nëse papritmas një aeropag do të kishte idenë e për t'i marrë në shqyrtim? Atëherë do të duhej të kapej edhe njëherë në dorë harta e gjithë botës, të shkatërroheshin e rindërtoheshin perandori, për të rifilluar sërish të nesërmen nga zhbërja e asaj çfarë është bërë sot, sipas të dhënave - shumë shpesh të paqarta dhe gjithmonë të diskutueshme - të historianëve. Do të duhej jo vetëm të ndryshoheshin gjithë kufijtë dhe të zhvendoseshin shenjat e tyre por, gjithashtu të hiqeshin emrat aktualë të kombeve, për të risjellë në jetë emërtime të kohëve të ndryshme historike, në mos prehistorike.

T'u referohesh pra të drejtave historike fiktive, do të ishte një vepër shkatërrimi dhe çorganizimi në kundërshtim me të drejtat reale. Sa për këtë, më mirë të mos lodheshin fare e t'i linin dorë të lirë arbitraritetit të pastër, pa pasur nevojë të shtiremi se gjoja kemi të drejtë, ashtu si ujku i fabulës.

Mirëpo, nëse bazohemi mbi të drejtat historike, duhet të njohim si Shqipëri të gjithë territorin që zinin iliro-maqedono-epirotët, atëherë do të duhej jo të kufizohej shtrirja e Shqipërisë, por të zmadhohej përtej kufijve të kërkuar nga vetë shqiptarët. Sepse, çfarë është në fakt, e drejta e grabitur përmes një pushtimi, thuajse, të paqenë të serbo-bullgarëve, në krahasim me të drejtën më të vjetër dhe më natyrale që shqiptarët kanë mbi këto vise? Për këtë racë, e drejta historike gjendet në harmoni

me të drejtat aktuale, ashtu si e shkuara me të tashmen. Sepse, sipas shprehjes së një shkrimtari francez,<sup>13</sup> jo vetëm “nga fushat e Vardarit, në Adriatik, nga Thesalia në Malin e Zi, shqiptari është zot për nga e drejta e atij që e ka zënë vendin i pari, po edhe për nga e drejta e më të fortit”. Për më tepër, ky territor është trashëgimia e tij ligjshme që ia kanë lënë stërgjyshërit, dhe sepse kurrë ai nuk ka hequr dorë nga mbrojtja kundër lakmive të pushtuesve, cilëndo të kishin qenë ata.

Përveç kësaj, kjo tokë, ky dhe, është prona e tij, prona e shqiptarit; qoftë kjo toka e Ohrit, e Gostivarit, e Prilepit, e Manastirit, e Shkupit apo e Pejës, zotëruesi i saj i ligjshëm është shqiptari. Nuk është brezi i sotëm që e ka fituar këtë tokë, ai e trashëgon atë nga babai i vet, i cili nga ana e tij e trashëgon po prej të atit. Kjo është një pasuri, po aq e ligjshme sa edhe çdo tjetër. Meqënëse toka u takon shqiptarëve, në çdo hartë etnografike, kur bëhet dallimi i fshatrave e kombësiëve të ndryshme të krahinave lindore të Shqipërisë, sfondi duhet të ketë ngjyrën e kombësisë shqiptare, gjë që hartografët kanë harruar gjithmonë ta bëjnë. Për shembull, në hartat që ilustrojnë veprën e Kençovit (Maqedonia etnografike e statike, në gjuhën bullgare, Sofie 1900), fshatrat shqiptare të fushës së Manastirit dhe Follorinës (edhe pse nuk janë shënuar të gjitha), figurojnë thjesht si pika mbi një sfond me ngjyrë bullgare. Mirëpo, për të qenë të drejtë, do të duhej të ishte bërë krejtësisht e kundërta, domethënë fshatrat bullgare të këtyre krahinave të shënoheshin si pika me ngjyrë bullgare mbi një sfond shqiptar.

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

---

Ne e dimë që është tjerre shumë tema e qëndrimit ndaj çifliqeve. Disa e kanë cilësuar si barbar, feudal, mesjetar, sistemin e pronave të mëdha. Por, siç e kemi vënë në dukje në një kapitull tjetër, ky është një institucion që ekziston, është një e drejtë e fituar nga më të ligjshmet, të cilën nuk mundesh as të mos e njohësh, as ta përmbysësh me një të rënë të lapsit. Sajues frazash kanë dashur të thonë se çifligjet aktuale nuk janë gjë tjetër, veçse produkt i vjedhjes dhe i përdorimit të forcës. Por, përpara këtyre, një filozof i madh ka thënë se njeriu që e rrethoi i pari arën e tij e tha: "Kjo tokë është e imja", ai që hajduti i parë dhe keqbërësi i parë i botës. Pra, përpara se të mohohet e drejta e pronësisë mbi çifligjet, duhet mohuar çdo pronësi dhe të shpallet komunizmi.<sup>14</sup> Të tjerë kanë pretenduar përsëri se çifligjet janë formuar nga tokat e shkëputura rajave kristianë, të shpronësuar prej pushtuesve turq. Ne nuk kemi të dhëna për të bërë historikun e pronave të mëdha, por, meqë këto ekzistojnë në gjithë sipërfaqen e tokës, origjinat e tyre fare mirë mund të vijë që nga babai ynë Adam. Nga ana tjetër, asgjë nuk tregon se bullgarëve u janë zhvatur tokat e tyre.

Ne mendojmë se, përkundrazi, kjo tokë ka qenë në zotërim dhe është kultivuar gjithnjë nga shqiptarët. Bullgarët ose serbët, atje ku çifçinjët, domethënë bujkrobërit apo mëditësit që punonin tokën, ishin sllavë, - i kanë shtënë në dorë këto prona shumë më vonë, mbas një kontrate të bërë me pronarin, e cila caktonte hisen që ky i fundit duhet të mbajë si pronar i vërtetë, dhe të asaj që duhet të marrë bujku si shpërblim për punën e tij.



## *Mid'hat Frashëri*

Treguesit nga ana tjetër, na bëjnë të besojmë se një pjesë e këtyre bujqve kanë ardhur nga jashtë, të sjellë nga vetë shqiptarët, të cilët i kanë angazhuar në kultivimin e tokave të tyre të mbetura djerrë, në vazhden e luftërave të paprera që i çfarosnin trupat e mobilizuara në Shqipëri e që, për rrjedhojë çonin në pakësimin e popullsisë. Duke qenë së krahu i punës mungonte, pronarëve do t'u jetë dashur të thërrisnin nga larg njerëz që merreshin me punimin e tokës, të cilët, duke mos qenë të detyruar të kryenin shërbim ushtarak, e kishin mjaft për mbarë e me fitim këtë punë paqësore. E përsërisim se jo e gjithë popullsia sllave, e cila aktualisht banon brenda kufijve të territorit shqiptar, ia detyron origjinën e vet këtij sistemi, porse për një pjesë të mirë të saj, kjo është e vërteta e patundshme. Shembulli i bujqve bullgarë, që i famshme Ali Pashai i Janinës i pat shpërngulur nga Bullgaria në Bonila (Shqipëria Jugore), mbas kthimit të tij nga lufta kundër Rusisë, ilustron teorinë tonë.

Vetë autorët bullgarë e pranojnë faktin se pjesa më e madhe e banorëve bullgarë të qyteteve janë të huaj, të ardhur nga jashtë. "Banorët e sotëm të pjesës më të madhe të qyteteve të Maqedonisë janë të rinj, të ardhur nga fshatra fqinje gjatë shekujve XVII dhe XIX", thotë tekstualisht Jordan Ivanovi i Universitetit të Sofjes.<sup>15</sup> Një shkrimtar tjetër bullgar pranon se "qyteti i Shkupit përpara vitit 1689 ishte një qytet i pastër mysliman (lexo: shqiptar) dhe bullgarët filluan të shtohen vetëm paskësaj"<sup>16</sup>.

Shumë sllavë që tashmë janë të pranishëm në territorin shqiptar, janë të sapoardhur dhe larg të qenit

vendas. Fizionomia etnografike e vendit, sidomos, gjatë këtyre dy shekujve të fundit, ka pësuar ndryshime të dukshme; nga njëra anë prej ardhjes masive të sllavëve në krahinat shqiptare, nga ana tjetër prej shtimit të elementit sllav në dëm të elementit shqiptar, i cili zvogëlohej papushim nga mobilizimi i shpeshtë i trupave. Përkundrazi, dihet mirë se në brendësi të Shqipërisë, në pjesën e njohur me emrin Kosovë, ndryshimi është kryer në favor të racës shqiptare, si pasojë e dy eksodeve të famshme serbe të viteve 1690 dhe 1737.<sup>17</sup>

Pra, atje ka patur një shtim të elementit shqiptar, shtim që nuk i detyrohet vetëm emigracionit të sllavëve, por gjithashtu, e mbi të gjitha, karakterit fizik të shqiptarëve, më të fortë, më rezistentë se serbët, e që, gjithashtu shtohen më shpejt se këta të fundit. Kush ka patur rastin t'i vizitojë "shqiptarët" e Rrafshit të Kosovës, e ka parë mirë se ç'burra të pashëm e shtatlartë janë. Kjo shpjegon faktin pse popullsia begaton kaq shumë, pavarësisht nga hakmarrja e ushtarët me të cilët janë furnizuar turqit, ç'ka i ka vënë shqiptarët në kushte shumë të pafavorshme, sidomos, po të kihet parasysh se sllavët gjithmonë kanë gëzuar një paqe e siguri relative, duke mos pasur as rekrutë për të dërguar, as çështje "gjaku" për të ndrequr.

Pikërisht kjo paqe e kjo siguri kanë bërë të mundur që sllavët të zgjerohen në dëm të elementit shqiptar, të ndihmuar nga intitucionet e tyre të kishave të manastireve, të ndihur nga priftërinjtë e më pas nga mësuesit e shkollave. Organizimi fetar i sllavëve i ngjashëm me atë që kanë patur grekët deri në fund të shekullit të nëntë-

mbëdhjetë, u ka dhënë atyre shumë shpesh përparësi kundrejt shqiptarëve. Shqiptarët ortodoksë, të detyruar të frekuentojnë kishat e po ashtu edhe shkollat sllave, - serbe ose bullgare, - shumë shpesh janë njësuar si të tillë dhe numri i tyre ka shërbyer për të rritur atë të sllavëve. Siç e kemi cilësuar edhe më lart, ky është një proces i kundërt me atë që dijetarët sllavë kanë dashur ta quajnë "shqiptarizimi i serbëve". Kjo shpjegon pse udhëtarët dhe etnografët kanë parë në veri dhe në lindje të Shqipërisë veç myslimanë e katolikë, meqenëse ortodoksët i kanë ngatërruar me sllavë. Vetë sllavët pranojnë të kenë bërë një propogandë ngulmuese përmes shkollave dhe kishave të tyre, me tendencë për të dhënë një iluzion të gabuar të gjendjes etnografike, në mos, për t'ia ndryshuar asaj karakterin. Ja çfarë lexohet për Dibërën, në gazetën e Sofjes "Jehona e Bullgarisë", viti i parë (1913), nr. 4, në faqen 2:

"Megjithëse qendër e vetme bullgare e dijes në rajon, manastiri i Shën Zhan Bigorit, ka arritur jo vetëm të mbajë gjuhën dhe shërbimin religjioz bullgar në fshatrat e pastra bullgarë, duke iu dërguar këtyre mësues shkollash, famullitarë, psaltë dhe ikonografë, por ka arritur edhe të ushtrojë një influencë mbi popullsinë e pastër shqiptare të kësaj krahine, aq sa shqiptarët ortodoksë të krahinës së Gorno Rekës (Rekës së epërme) e bëjnë shërbesën fetare, si në të kaluarën ashtu edhe sot, në gjuhën sllavo-bullgare, e, madje që prej 40 ose 50 vjetësh ata edhe ndërmjet tyre flasin bullgarisht".

Pohimi i publicistit bullgar, Jordan Ivanov, që e cituam më lart, i cili pranon se "në Gostivar popullsia

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

---

kristiane shqiptare është bullgarizuar në kontakt me bullgarët”, për ne është, gjithashtu, mjaft kuptimplotë. Shtoni shembujt, shumoni rastet e do të kuptoni si kanë vepruar sllavët, qofshin ata të Ohrit, Bitolit, Prishtinës apo Pejës, të cilët janë të prirur të shohin sllavë, kudo ku gjendet një ortodoks shqiptar. Por ky është vetëm një iluzion i rremë e i paqëndrueshëm, sikurse ai i grekëve të cilëve iu dukej “helen” çdo shqiptar, bullgar, rumun apo serb, mjaft që të ishin të besimit ortodoks. Ashtu si asgjë nuk qëndron sot në këmbë nga këto pretendime greke, ashtu, dhe sot ka ardhur dita që kërkesat serbo-bullgare të zvogëlohen në vlerën që ato kanë.

Për t’i dhënë fund kësaj paraqitje, sa objektive e të paanshme siç kemi mundur ta bëjmë, le të themi se, nëqoftëse ka një “vërshim” dhe “shkretim”, sipas formulës “të kënaqshme” të z. Gregor Jakçiç, ky nuk është shkak-tuar aspak nga ana e shqiptarëve, vendas dhe zotër të vërtetë të tokës shqiptare, të trashëguar prej shumë shekujsh, por nga ana e sllavëve të ardhur prej larg, që përmytën e shkretuan gjithçka, që shpronësuan nga trashëgimia e të parëve banorët autoktonë dhe që tentuan shfarosjen metodike e rrënjësore të tyre. Është shumë e mundshme dhe krejt e natyrshme që pushtimi turk t’i ketë dhënë fund tërbimit shfarorës së sllavëve, çka shpjegon atë që një pjesë e shqiptarëve nuk vajti për të luftuar kundër pushtuesit të ri në betejën e famshme të Fushës së Mullenjave në Kosovë. Këtë qëndrim ata e mbajtën jo nga dashuria për turkun, por thjesht nga instikti i vetëruajtjes; po këta shqiptarë, më pas, do t’u bënin

osmanllinje qëndresën më të vendosur e më të ashpër.<sup>18</sup>

Nëse shqiptarët, gjatë sundimit otoman, kanë shtënë në dorë përsëri një pjesë të territorit që sllavët ua kishin shkëputur më parë, ky është vetëm një proces krejt i natyrshëm e shumë i drejtë dhe nuk mund të bësh akuza për dhunim e dhunë. Dhe kur këta sërish, pas emigrimit serb në Hungari, u ngulën në pozita më të qëndrueshme në fushën e Kosovës, ata nuk bënë gjë tjetër, vetëm se u kthyen në shtëpi të vet, siç e pranon me shumë të drejtë lordi Fitzmaurice në letrën e tij të lartpërmendur.

Por do të ishte një gabim i madh të mbrohej teza se, përpara ardhjes së turqve, shqiptarët nuk banonin fare në krahinat që zënë vilajetet e Manastirit e të Shkupit. Në të kundërt, gjithçka provon se, përballë mbërritjes së pushtesve sllavë, autoktonët nuk ikën aspak në masë, por këmbëngulën të banojnë aty, pranë ardhacakëve, megjithëse i kërcënonte shfarosja.

Dokumentet historike të mbledhura dhe të botuara nga Jireček dhe Mikloshiq provojnë se, edhe përpara mbërritjes së turqve, kishte shqiptarë që jetonin pranë sunduesve serbë në krahinat e quajtura Serbia e Vjetër dhe Maqedonia Perëndimore. Dhe fakti që shqiptarët e Kelmendit kanë ikur nga trojet e veta në të njëjtën kohë me sllavët, në eksodet e viteve 1690 dhe 1737, na forcojnë bindjen se shqiptarët kanë banuar në "Serbinë e Vjetër" shumë më përpara shpërnguljes së famshme të serbëve.

Si mund të jetë ndryshe? Me të rënë dakord se shqiptarët konsiderohen si banorët e hershëm të vendit

dhe sllavët njihen si pushtues të huaj, kjo na detyron të pranojmë se Dardania (Serbia e Vjetër e politikanëve serbë)<sup>19</sup> është një krahinë shqiptare e banuar gjatë të gjitha kohërave prej shqiptarëve. Ashtu si Jean Bugarski në vitin 1845 konstatonte se Bjellopolja aktualisht është shqiptare, tri vjet më vonë edhe serbi Davidoviç pranon se “Kosova e Metohija (krahina e Pejës) janë të banuara prej shqiptarësh”.<sup>20</sup>

- 
- 1) “L’Albanie et la question d’Orient”, nga princ Albert Ghica, Paris 1904. Më poshtë do të sjellim pasazhe të “Librit Blu” anglez, ku shfaqen qëllimet dashamirëse të Britanisë së madhe ndaj Shqipërisë.
  - 2) Për të qenë krejtësisht të qartë, duhet të themi se bëhet fjalë për dy vilajete me territoret e tyre integrale, ata të Shkodrës dhe të Janinës, plus pjesët lindore të vilajeteve të Manastirit dhe të Shkupit. Bëjmë të ditur se shqiptarët nuk kanë formuluar kurrë pretendime mbi krahinat e banuara nga grekë dhe sllavë të këtyre dy vilajeteve të fundit, domethënë mbi Elasona, Serfixhé, Koçana, Rodovishta etj. Rivendimet shqiptare kanë synuar vetëm rrethet e banuara në tërësi prej shqiptarësh, si ato që ne i kemi përcaktuar më lart.
  - 3) Ky është termi i përgjithshëm me të cilin shqiptarët i përcaktojnë sllavët (bullgarë, serbë ose malazezë). Ky term është përdorur sa nga myslimanët, aq edhe nga katolikët dhe, shqiptarët e Greqisë, për çdo grek ortodoks aplikojnë formën **shkla**.
  - 4) Dr. Ernst Jaekh: “Im Tükischen Kriegslager durch Albanien”, Heilbronn, 1911, f. 122.
  - 5) “Travels in the Slavonic provinces of Turkey in Europe”, botimi i dytë, Londër, 1877.

- 6) G.L.Jaray, "Au jeune royaume d'Albanie, ce qu'il a été, ce qu'il est". Paris, 1914, f. 78.
- 7) Duhet të kujtojmë këtu që, kongresi i madh shqiptar, konfirmoi alfabetin latin, përveç kësaj ai nuk mor me çështjen, se cili prej alfabeleve; ai latin apo turk ishte për t'u pranuar. Punimet e tij konstatuan në vendosjen e ortografisë dhe çështja e alfabetit nuk u vendos, ajo tashmë ishte vendosur para tridhjetë vjetëve, nga një shoqëri letrare e cila ishte themeluar më 1878 në Stamboll, e kryesuar prej Sami bej Frashërit dhe, në të cilën bënë pjesë shqiptarë ortodoksë, katolikë dhe myslimanë. Vetë shoqëria letrare e Stambollit nuk kishte bërë gjë tjetër, veçse kishte shenjtëruar shkronjat latine, tashmë të futura në përdorim në Shqipërinë e Veriut që prej tre shekujsh. Me të padrejtë është thënë dhe që vazhdon të thuhet akoma, që shqiptarët kanë në përdorim ca alfabetin turk dhe ca alfabetin grek. Këto shkronja nuk janë përdorur veçse rastësisht dhe nuk kanë qenë kurrë në përdorim të vazhdueshëm. Të parat, kanë qenë përdorur në përkthimin e Shkrimeve të Shenjta në dialektin toskë, ndërsa shkronjat turke kanë shërbyer për transkriptimin e dy ose tri përmbledhjeve me poezi. Victor Bérard gabohet kur thotë (f. 282-283 të veprës së tij "La Turquie et l'hellénisme contemporain", Paris 1893) që Albanophron-ët (it) (domethënë militantët nacionalistë shqiptarë) kishin adoptuar shkronjat turke dhe që më vonë të krishterët kanë përdorur shkronjat latine, duke pritur që vllahët të kishin shpikur për shqiptarët një alfabet ad hoc! Autori padyshim ka bërë një konfuzion, duke mos e pasë studiuar sa duhet çështjen shqiptare, që atij përfundimisht i duket se nuk i ka vlerat për të ekzistuar.
- 8) Në veprën e tij: "Turqia dhe fqinjët e saj", përkthyer nga anglishtja; Guilmot, éditeur Paris, pa datë, f. 101.
- 9) Në territorin shqiptar kishte klube në çdo qytet, nga Preveza deri në Shkodër dhe nga Mitrovica në Janinë. Kishte gjithashtu klube edhe jashtë tokës shqiptare: në Stamboll, në Smirna, Selanik, Drama, Katérina, Elasona, Karaferia, e kudo që të ndodhej një koloni shqiptare me njëfarë rëndësie. Duhet t'i

themi lexuesve tonë që në Katerina dhe Elasona (pranë kufirit të vjetër turko-grek) gjenden me shumicë dhjetëra familje shqiptare, të cilat janë vendosur atje që prej shumë kohësh dhe... zotërojnë aty prona të mëdha. Në Karaferia, përveç pronarëve të tillë, gjenden më se 200 shtëpi shqiptare myslimane, me origjinë nga Lala, që janë detyruar ta lenë atdheun e tyre në kohën e revolucionit grek (1821-1827) dhe nga persekutimet që pësuan në vazhdim.

Në të njëjtën kohë me lulëzimin e jashtëzakonshëm të klubeve, duhet të vemë në dukje edhe shpërthimin e gazetave dhe tipografive, ku shtypeshin libra mësimore. Kishte edhe gazeta shqiptare: dy në Stamboll, një në Selanik (si dhe një revistë), një në Shkup, një në Manastir (si dhe një revistë). Në Korçë, dy gazeta dhe dy revista në Shkodër, një gazetë në Janinë. Në gjithë këto qytete, përveç kësaj kishte edhe shoqëri letrare dhe muzikore.

- 10) V.Bérard, (vep. e cit. f. 282) me të drejtë ka thënë: "Megjithatë, ndërmjet këtyre toskëve, një pjesë albanophone kishte provuar të organizohej rreth vitit 1879. Në Korçë ndodhej selia, ndërsa direktivat vinin nga Stambolli. Por, të denoncuar nga kleri grek, ata qenë shpërndarë me ashpërsi prej autoriteteve turke, të cilëve të gjithë grekët e pasur përreth kishin nënshkruar një lidhje besnikërie.

Per sjelljen e klerit grek, shih gjithashtu edhe broshurën: "La population de l'Épir" nga Lumo Skëndo, Sofje, 1915, f. 37.

- 11) "Por një fatalitet i jashtëzakonshëm do ta humbë Turqinë; përmes një marrëzie të çuditshme ajo shkatërron të vetmen forcë që mbështeste dominimin e saj në Maqedoni. Turku lufton shqiptarin. Ky është fundi. Nacionalizmi turk bëri revolucionin, nacionalizmi turk humbi Turqinë Europiane, gjatë katër viteve arnautët rezistuan, u zmbropsën, u rikthyen edhe njëherë dhe, në një ditë të favorshme hyjnë fitimtarë në Shkup, ku vendosin shtabin e tyre". (G.L.Jaray, *Au jeune royaume d'Albanie*, f. 189).
- 12) "Me këtë përkujdesje shtohet (përkujdesja e shteteve ballkanike për bashkëatdhetarët e tyre të Turqisë) ashtu si në Beograd dhe



në Athinë ish frika e frymëzuar nga kërkesat shqiptare..."

"L'Alliance balkanique", nga Iv E.Geshov, Paris, 1919, f.82.

"Megjithatë asnjë nga këto marrëveshje nuk u bë efektive deri në fund të shtatorit, pas një sërë ngjarjesh në Turqi. Këto ngjarje përkohë me pranverën e vitit 1912 me një revoltë në Shqipëri. Në verë revolta solli frytet e saj që kaloi të gjithë parashikimet. Kabineti dha dorëheqjen. Dhoma u shpërnda, komiteti ekzekutiv i partisë "Bashkimi dhe Progresi" kërcënoi për shkatërrim të plotë, i detyruar që të përgjigjej plotësisht shqiptarëve. Demonstrimi i dobësimit Turk inkurajoi aleatët e rinj, dhe për më tepër premisat për autonominë shqiptare, qe përfshinte të katër Vilajetet e Maqedonisë dhe Serbisë së Vjetër, kërcënuan direkt zhdukjen e nacionaliteteve kristiane. Serbët nxituan të kundërshtonin planin e "Shqipërisë së Madhe" me planin e tyre për ndarjen e Turqisë në Europë nëpërmjet Shteteve Ballkanike në katër sfera influence.

Raport për Komisionin Ndërkombëtar për të hetuar mbi shkaqet e Luftës Ballkanike.

"Carnegie endowment for international Peace", WEashington, 1914, f.47.

"Një dëshmi e paanshme do të provonte qartë se përleshjet e përgjakshme dhe të ashpra për çlirim nga qendërzimi xhonturk (1909-1912) përbëjnë një nga arsyet e vërteta të progresit të madh në luftën kundër aleatëve. Këtë duhet që ta kujtojnë gjithnjë me mirënjohje popujt ballkanikë, sepse kanë qenë shqiptarët që kanë bërë fatin e të tjerëve..."

"Il nuovo Stato di Albania", Antonio Baldacci, Romë, 1913, f. 16.

- 13) René Pinon. "L'Europe et la jeune Turquie", Paris 1913, f. 296.
- 14) Megjithatë, siç kemi thënë në kapitullin e mëparshëm, çështja e pronave të mëdha ka qenë shqyrtuar nga vetë shqiptarët, dhe ka pasë projekte të copëtimit dhe shpërndarjes, fshatarëve që e kanë punuar.
- 15) "Blgarite v'Makedoniya" (në bullgarisht, që do të thotë "Bullgarët në Maqedoni"). Nga Jordan Ivanov, Sofje, 1915, f. LIII.

16) Vasil Kençov, "Grad Skopie" ("Qyteti i Shkupit" - në bullg.), Sofje, 1898, f. 55.

17) Ne duhet të kujtojmë edhe njëherë se nuk është aspak e vërtetë që Kosova është banuar në momente të caktuara vetëm prej serbëve: elementi shqiptar ka qenë gjithmonë atje i bollshëm, në çdo shekull, pranë sllavëve pushtues. Historianët e fushatës së Eugenit të Savojës - domethënë përpara eksodit të famshëm të serbëve, na japin të dhëna mbi popullsinë e vendit (shih më poshtë pasazhet që ne kemi nxjerrë nga vepra "Der Neue eroffneten ottomanischen Pforten").

Çështja e lëvizjes së racave në Kosovë është megjithatë larg studimeve të paanshme. E kemi thënë edhe më lart që, në shumë pika, sllavët nuk janë, veçse të ardhur, në Kosovë dhe në Shqipërinë Lindore (Maqedonia Perëndimore). Ja, se çfarë lexojmë në një botim modern mbi këtë subjekt.

"Malësorët (serbë) të veriut dhe të veri-perëndimit, ata të Bërdës malazeze dhe njerëzit e Ibarit të Sipërm, të këtij vendi që quhet Kolashini i vjetër (në veri-perëndim të Mitrovicës, atje ata bigëzohen, një pjesë vazhdojnë direkt mbi Rashkën dhe Serbinë, të tjerët marrin drejt Kosovës... Shumica kanë ardhur nga se ishin tepër shumë (në malet e tyre) dhe se ishin dëbuaar nga vendi i tyre nga gjakmarrja dhe rivalitetet ndërmjet familjeve brenda fiseve... Të ardhur nga vendi ku të parët e tyre jetonin në grup kompakt, pa depërtuar kurrë ndër ta elementë të huaj, ata kanë ruajtur në Kosovë pjellorinë e tyre të veçantë: ata zotërojnë gjithnjë zadrugat më të shumta dhe, gjithashtu, ia dalin me sukses që në disa pika të shtyjnë elementin shqiptar, veçanërisht në veri. Gjithashtu në rrethet e Vuçiternit, fshatra si Sllatina, Rashniku, krejtësisht shqiptare, ka tetëdhjetë apo njëqind vjet, që janë kthyer plotësisht në serbe".

Gaston Gravier, "La vieille Serbie et les albanais" (Serbia e vjetër dhe shqiptarët), "Revue" de Paris", 1911, novembre, f. 216.

Dhe është i njëjti shkrimtar, f. 219, që thotë përsëri:

"Nga Mitrovica në Kaçanik, gjendet po ky tip i shqiptarit aktiv, plot iniciativë: sa dyqanxhi, sa hotelxhi, sa karvanxhi, xhandar

## *Mid'hat Frashëri*

---

apo ruajtës i hekurudhës.”

- 18) Kujtojmë se shekullin në vazhdim, grekët që ndodheshin të kërcënuar nga shqiptarët thirrën në ndihmë turqit. Nuk duhet harruar gjithashtu se gjatë betejës së Kosovës vetë princat serbë të Kystendilit dhe të Kosturit, si dhe Marko Kraljeviçi i Prelepit, ishin në anën e turqve dhe jo në radhët e heroit fatkeq L Lazar.
- 19) Shih më lart, f. 5.
- 20) Cituar nga Ishirkov “Zopadnata Kraichta na blgarskata Zemlja” (krahinat perëndimore të vendit bullgar), Sofje, 1945, f. LX.

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

---

### III

**D**o të përpiqemi të sjellim disa citime të nxjerra nga autorë të huaj për të mbështetur tezën që ne mbrojmë.

Mbi të gjitha duhet të vëmë në dukje se pjesa perëndimore e Maqedonisë, domethënë krahina që ka formuar vilajetin e Manastirit nën sundimin osman, ka qenë quajtur shpesh Shqipëri, duke u konsideruar si një vend i banuar prej shqiptarëve. Ohria është mbiquajtur epirote për shkak se shqiptarët përbënin pjesën më të madhe të popullsisë së saj. Sipas disa autorëve të tjerë, kjo pjesë perëndimore e Maqedonisë është, gjithashtu, atdhe i shqiptarëve.

Ne do të përpiqemi të mbledhim në këtë kapitull disa citime, të natyrës që e mbështesin tezën tonë, të cilat janë nxjerrë nga autorë të huaj.

Para së gjithash, duhet vënë në dukje që pjesa perëndimore e Maqedonisë, domethënë krahina e cila nën dominimin otoman ka formuar vilajetin e Manastirit, ka qenë shumë shpesh e quajtur me emrin Shqipëri dhe është konsideruar si një vend i banuar prej shqiptarësh. Ohri ka mbajtur emrin e kahershëm epirotas, për shkak të shqiptarëve, të cilët formojnë shumicën e popullsisë aty.<sup>1</sup> Ja se çfarë thotë një autor i shekullit të gjashtëmbëdhjetë: "Bullgarët, një palë banojnë në gjithë vendin

e quajtur "Mëzia e Poshtme", deri në Danub, përkundraill Vllahisë; të tjerë, janë përzier me grekë, banojnë në Thrakë dhe, të tjerë akoma në Maqedoninë, e cila është e banuar nga grekë, serbë dhe shqiptarë<sup>2</sup>. Gjithashtu i njëjti autor na jep të dhëna të çmuara mbi Dardaninë, domethënë mbi vendin për të cilin serbët prej disa dekadash kanë shpikur emrin Serbia e Vjetër. Në faqen 117, paragrafi 105, të së njëjtës vepër, ai na mëson që Dukagjinët (fis gegë) banojnë Dardaninë, e cila është një vend në kufi me Shqipërinë, i banuar më shumë nga shqiptarë, se sa nga serbë.<sup>3</sup>

Në një vepër historike, që daton më tepër se dy shekuj përpara,<sup>4</sup> "Ky e përzuri atë në lulëzimin e madh të viteve dhe të punëve të saj; dhe pikërisht për këtë i pëshpëriste asaj Princi Karl Filipi në Prishtinë, në Shqipëri në fillim të vitit 1690".

Faqja 517 "me pjesën e mbetur të trupave që përbësheshin nga dy regjimente, shkoi vetë zoti gjeneral, pa vënë re ndjenjën e papërshtatshmërisë në Prisseran (Prizren), kryeqytet në Shqipëri, ku ishte vetë kryepeshkopi dhe patriku Kelmendas... ku ishin 5000 arnautë, pjesërisht të krishterë dhe pjesërisht turko-shqiptarë."

Faqja 518 "Ndërkohë armiku kishte filuar të forcohej në Lumë dhe Tetovë, për këtë pjesa e krishterë sapo mori lajmin: në kryeqytetin Priseran (Prizren) u goditën një sasi trupash prej atyre shqiptarë".

Faqja 460 "Jo më pak e etur ishte provinca shqiptare për të hequr zgjedhën otomane si Guzzini (Gucia), Klementini (Kelmendi) dhe banorë të tjerë të

vendbanimeve shqiptare...”

“Ne kemi bërë aluzion më lart për shkrimin e Mariano Bolizza, përsa i përket Kuçit, fis shqiptar sot, i nënshtruar sundimit sllav. Në fakt kufijtë etnografikë të Shqipërisë duhet të përfshijnë të gjithë krahinën e njohur me emrin Zëdda (Zeta). Dijetari i mirënjohur Franz Miklosich në lidhje me këtë subjekt ka thënë: “Fjala Zeta ka shumë mundësi të jetë me origjinë shqiptare, nga që shqiptarët fillimisht kanë qenë shumë më tepër të shtrirë në veri se sa sot, gjë që kuptohet lehtë nga prejardhja ilire e shqiptarëve”.<sup>5</sup> Dijetari Mas Latrîe e quante Janinën qytet të Shqipërisë dhe Zetën një krahinë shqiptare: “Princ i Zetës në Shqipëri. Emrat e Zentës, Zeta dhe Cedda emërtojnë një principatë të vogël të bregut ilir, e cila ruajti pavarësinë që nga shekulli XII deri në shekullin e XV... territori i saj përfshin një pjesë të Shqipërisë së Sipërme ose të Malit të Zi të sotëm...”.<sup>6</sup> Gjithashtu për Zetën një autor tjetër shprehet me këto fjalë: “Është më afër së vërtetës emri Zeta, me të cilin, sipas prof. Hopf-it që pëlqen të emërtojë atë vend me origjinë shqiptare dhe që e pranuan të gjithë ata që me Hahn-in panë te shqiptarët pasardhësit e vërtetë të ilirëve të vjetër, të cilët ndodheshin më në Veri të vendeve ku janë pasardhësit e tyre të sotëm”.<sup>7</sup>

Ja ç’ka thënë për këtë udhëtari aq i famshëm sa i ndërgjegjshëm Ami Boue, për vendet që banojnë shqiptarët, trojet që përmbajnë jo vetëm krahinat që përfshihen në vilajetet e Janinës, të Shkodrës, të Manastirit dhe të Shkupit, por edhe trojet shqiptare që i janë dhuruar mbre-

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

---

tërisë serbe, si rrjedhim i luftës ruso-turke (1877) prej Kongresit të Berlinit, duke mos marrë parasysh protestat e shqiptarëve. Le ta lemë të flasë vetë Ami Boue-në.

“Shqiptarët (banorët e shkëmbinjve) ose albanezët, janë vlerësuar nga demografët në 1,600,000 vetë, vlerësim i arsyeshëm, por që qëndron nën të dhënat reale, kur mendohet se ata shtrihen që nga Epiri deri në pjesën perëndimore të Mësisë, së Sipërme, ku ata përzihen me serbët, në fushën midis Prizrenit dhe Pejës midis Vranjës dhe Mitrovicës, kurse shtrihen pothuajse të vetëm, të quajtur arnaut, në vendet e burimeve të Lepenacit, rrethinat e Cernoleva-Riekës, bregun juglindor të fushës së Prishtinës, në vendi midis Vranjës, Gjilanit, Novo Bërdos, Prishtinës, Kratovos, Kurshumlisë, Prekoplies dhe Medokeş. Nga ana tjetër ata përzihen me boshnjakët në malet midis Shqipërisë dhe Bosnjës, si në Kolashin, në Torë, në Guci, në Plavë, në brigjet e sipërme të Ibarit afër Rozhajës, në distriktin e Sudolit. Ata shtrihen deri në pllajat në perëndim dhe në jugperëndim të Novi-Pazarit, në distriktin e Zetës, gjatë Moraçës dhe në atë të Kelmendit, në Cem dhe takohen me malazezët.”<sup>8</sup>

Ne nuk shtojmë asgjë, sepse autori që kemi zgjedhur për të cituar njihet si nje autoritet dhe veprat e tij të shumta mbi Turqinë Europiane e konsiderohet, me të drejtë, si një nga burimet më të sigurta e besimplotë.

Le të shqyrtojmë me vëmendje vetëm një term: “Serbi e Vjetër” (Starja Serbia). Këtë term duket qartazi se Boue-ja e injoron. Staraja Serbia, sot kaq popullor, është përdorur gjatë propagandës serbo-ruse në një



periudhë gjysmëshekullore.

Në fakt ky është një term, një fjalë e thjeshtë. Por, kush është ai që shmang fuqinë e fjalëve në shpirtat njerëzorë? Vallë, nuk është vetëm një fjalë që ka kryer punë shumë më tepër se armatat serbe dhe influenza ruse së bashku? Përveç kësaj edhe bullgarët përdorin si serbët një fjalë, që me ndihmën e saj i kanë vënë detyrë të sigurojnë epërsinë e tyre në Ballkan dhe, po ashtu, të krijojnë nga ana e tyre hegjemoninë në gadishullin tonë ballkanik. Ky term magjik për bullgarët është termi i vjetër gjeografik "Maqedonia", me anën e të cilit qysh në traktatin e Shën Stefanit janë orvatur të shtyjnë kufijtë dhe ta bëjnë atë sinonim të Bullgarisë iredente. Duhet rikujtuar prapë se bullgarët dhe serbët kane zhvilluar diskutime të gjata dhe të dobishme për të caktuar një vijë demarkacioni midis "Maqedonisë" dhe "Serbisë së Vjetër" domethënë në mes atyre që duhet (në idetë e tyre) t'u përkasin trojet e Maqedonisë një ditë, si Serbisë ashtu edhe Bullgarisë. A nuk është kjo një mënyrë së vepruari e barabartë edhe për grekët që kanë gënjyer mendjet e njerëzve, duke quajtur Epir, jugun e Shqipërisë dhe, duke na bërë të besojmë se kjo fjalë është sinonim i Greqisë, sa për të kaluarën historike, aq edhe për tashmen?

· Por, ndërroni termat dhe bëjini të ditur të gjithëve se Epiri nuk është gjë tjetër, veçse Shqipëria e Jugut: Maqedonia Perëndimore është Shqipëria Lindore dhe Serbia e Vjetër është Shqipëria Veriore. Dhe kështu, ju menjëherë do të ndërroni bindjet tuaja, ju do të konstatooni

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

se në vend që të bëheni një grekofil dhe sllavofili deklaruar, do të ktheheni për të njëjtin fakt, në një albanofil të deklaruar. Të kthehemi tashmë te autorët e huaj që kanë studiuar krahinat që na interesojnë. Ja një dijetar tjetër, Georg von Hahn, i cili, përgjithësisht, çmohet si një autoritet për çështjet që i përkasin Shqipërisë.

Harta që shoqëron veprën e tij "Albanische Studien"<sup>9</sup> përfshin tërësinë e territorit të katër vilajeteve: të Janinës, të Shkodrës, të Manastirit dhe të Shkupit. Në faqen e parë të veprës së tij autori kujdeset të na thotë se Shqipëria shtrihet nga 39 gradë deri në 43 gradë të gjërësisë veriore, domethënë që Preveza deri në Novi-Pazar.

Na vjen keq që nuk mund t'ju sjellim këtu paragrafin e librit të Georg von Hahn-it, ku ai përshkruan territorin e Shqipërisë në dhjetë faqe, me një shkrim të dendur dhe kompakt, (pa llogaritur shënimet që i referohen në fund të kapitullit). Autori aty përcakton në fillim kufirin natyror të Shqipërisë, - sa atë gjeografik aq edhe atë etnografik, - që shtrihet nga veriu në jug prej maleve, deri në Adriatik. Hahni kalon pastaj në përshkrimin e trojeve të banuara nga shqiptarët, territore që ai i ndan në katër grupe. Duke përfunduar (faqe 13), nuk do të lemë pa përmendur që shqiptarët shtrihen në të gjithë krahinën që përfshihet në mes të Moravës (lumë i Malit të Zi, që rrjedh nga liqeni i Shkodrës dhe Toblica, që do të thotë, që nga skaji verior i liqenit të Shkodrës deri në Nish).

Në veprën e tij me titull "Udhëtim nga Beogradi

## *Mid'hat Frashëri*

në Selanik"<sup>10</sup> Hahn pohon se: "Është rrjedha e Moravës ajo që ndan krahinën shqiptare nga ajo e sllavëve". E tërë vepra e tij ka një vlerë të madhe dhe mund të shërbejë si udhërrëfytes për ata që duan të studiojnë çështjen shqiptare sa nga pikpamja etnografike dhe gjeografike aq edhe ajo historike. Në faqet e këtij libri (në pamundsi për ta sjellë të plotë për shkak të gjatësisë së tyre, apo t'u zvogëlojmë forcën me anë të një përmbledhjeje), Georg von Hahn pohon: "pjesa dërmuese e popullsisë në Fushë-Kosove deri në brigjet e Vardarit e në Shkup është shqiptare".

Pastaj, duke iu referuar historisë, autori vërteton që banorët autoktonë të këtyre anëve janë paraardhësit e ilirëve, të epirotasve, të maqedonasve, - të antariatëve, të taulantëve dhe të dasaretëve (shih kapitullin "Historia e sundimtarëve të Moracisë" f. 228, 262 të kësaj vepre). Z.Brailsford - anëtar i rëndësishëm i Komitetit Ballkanik të Londrës - komitet i krijuar nga politikanë, publicistë dhe profesorë që t'u vinin në ndihmë bullgarëve të cilët kishin vuajtur prej kryengritjes së tyre të vitit 1903, ka përshkruar Maqedoninë. Autori ka vajtur atje për të kryer misionin bamirës dhe për të shpërndarë ndihma. Brailsfordi ishte nisur nga Londra me mendimet më të mira për racën bullgare dhe jo pa paragjykime ndaj shqiptarëve.

Mirëpo qenë mjaft disa javë qëndrimi në Manastir dhe Ohër për ta bërë Brailsfordin një albanofil të zellshëm dhe të ndrejte gabimet e tij kundrejt kësaj race duke e quajtur të vetmin element etnografik që gëzon të drejtë

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

---

të pakundërshtueshme lidhur me Maqedoninë. Libri i Brailsfordit është mjaft tërheqës dhe bindës: ne deshëm të nxjerrim paragrafët që i përkasin shqiptarëve, por u kufizuam në paragrafët që vijnë. Na vjen keq nuk mund t'ju sjellim të gjitha pasazhet, ku raca shqiptare është trajtuar me mjaft vërtetësi e simpati: "Në thelb lëvizja shqiptare është si të gjitha lëvizjet ballkanike e frymëzuar nga idealet kombëtare për të realizuar çlirimin e popullit nga sundimi osman; edhe në qoftë se kjo lëvizje merr një pamje armiqësore ndaj Evropës, kjo ndodh vetëm, sepse Evropa është shndërruar vetë në mbrojtëse e sllavëve, me të cilët shqiptarët kanë pasur tradicionalisht armiqësi.

Në bashkëbisedim me shqiptarët, unë jam përpjekur të mbledh disa të dhëna për qëndrimin e tyre ndaj sllavëve. Gegët, zakonisht, kanë pak shkollim për të shpjeguar me qartësi se si është gjendja e tyre reale, çfarë qëllimi kanë dhe çafreë duan. Rritja e zemërimit tek ata është instiktive. Por, në qoftë se një njeri mund të imagjinojë një gegë të pashkolluar që të jetë në një shkallë që të mund të përvetësojë idetë e Isa Boletinit e të anëtarëve të tjerë të fisit dhe të jetë i edukuar sa t'i deklarojë ato qartësisht, kjo, në një farë mënyre, do të na tregojë se ai është në gjendje të shpjegojë qëndrimin e tij kombëtar: "Ne shqiptarët, - do të na thotë ai, - jemi një racë e pastër dhe autoktone e Ballkanit. Sllavët janë pushtues e emigrantë. Ata kanë ardhur kohë më parë nga Azia, kurse bullgarët janë fis mongol, që nuk kanë punë në Evropë. Rusët mund të thonë për veten e tyre se

janë Evropianë, por konsujt e tyre vijnë këtu mbi ne me pastrimet e tyre. Ne vërejmë sytë e vegjël të tyre si dhe mollëzat e tyre të larta të faqeve, kështu që ne kuptojmë se edhe ata janë për më tepër tartarë. Serbët, nën carin e tyre Dushan, pushtuan vendin tonë, të cilin ata kanë paturpësinë ta quajnë "Serbi e Vjetër". Ata u vendosën atje dhe na shpërngulën për një kohë nëpër male. Por pak nga pak, ne e kemi rifituar atë përsëri. "Serbia e Vjetër" është Shqipëri një herë e më shumë sot, pasi ajo gjithmonë ishte edhe do të jetë Shqipëri. Është e vërtetë që minoriteti serb vazhdon të qëndrojë i mbrojtur nga rusët. Rusia, bile, ka dërguar një grusht murgjësh rusë nga mali Athos që të mbajnë manastirin e shenjtë serb të Deçanit. Pse i mbron ajo armiqtë tanë tradicionalë? Sepse ata janë sllavë...

Shqiptari im imagjinar ka thënë diçka që është absurde dhe gjëra të tjera që janë të vërteta. Duhet lexuar nën rreshta. Ai nuk ishte kundër reformave që nxirrnin në dritë shqiptarët, por kundra shtrëngimit të kontrollit turk dhe të kërcënimit më të largët që vinte nga predominimi i Austrisë dhe Ruisë. Evropa bëri një gabim të madh kur i la në dorë fatin e Maqedonisë në duart e dy fuqive. Si Rusia dhe Austria janë partizanë në kaosin Maqedonas. Për vite me radhë ato janë angazhuar në propagandën e tyre, duke mbështetur e interesave të një race mbi tjetrën për të siguruar pozicionin e tyre për të përgatitur pretendimet e tyre të ardhshme. Është absurde të mendosh se ato do të luanin rolin e arbitrit asnjans. Shqiptarët flasin të vërtetën kur insistojnë se ata janë

vetvetja nga shkak i numrit të tyre që përbëjnë popullsinë dërrmuese të "Serbisë se Vjetër".<sup>11</sup>

Ja dhe opiniononi i reverend Noel Buxton-it, kryetar i Komitetit Ballkanik, njeriu që ndjen vetëm fare pak simpati, për shqiptarët dhe që nuk i fsheh pretendimet kundrejt tyre, por që vë në dukje, për më tepër se raca shqiptare formon një faktor të rëndësishëm në Maqedoni dhe që është e pamundur që të zgjidhet çështja e quajtur maqedonase pa marrë parasysh këtë popull të lashtë. Lexuesi le të gjykojë vetë nga pasazhi i mëposhtëm (Europa dhe Turqit e Noel Buxton, Londër 1907, f. 48-49).

"Procesi i çlirimit të Maqedonisë ka shkuar aq larg sa duhet t'i jepet secilit komb një themel me përjashtim të njërit, - Shqipërisë. Populli i lashtë nuk mund të humbasë në komunitetin e kombeve. Maqedonia nuk formon një racë homogjene, grekët apo serbët janë të dallueshëm midis tyre, por Shqipëria nuk mund të ndahet pa u shkëputur si komb. Shqipëria ka një histori, gjithashtu: turqit e mbajtën atë, duke përdoruar ndarjet feudale dhe gjakderdhjen dhe duke i ndarë njerëzit sipas besimit fetar, por në këtë drejtim shqiptarët janë më pak të zellshëm.

Unë takova një bajraktar, mendoni një muhamedan që ndihmonte priftin për t'i shërbyer famullisë së ndodhur në pronat e tij dhe që shpesh bashkohej me të, në lutje për t'u falur shenjtit mbrojtës. Myslimani, i konvertuar në mes të serbëve grekëve, bëhej turk, kurse shqiptari i konvertuar në mysliman mbetet gjithmonë besnik i vendosur, i besës së kombit. Ai ishte besnik ideal dhe mbetet i tillë. Në qoftë se udhëtari falenderon turkun,

ai e bën këtë pasi gjen tek shërbyesi i tij turk kënaqësi, ju do të zbuloni përgjithësisht se ky turk është shqiptar. Shqiptari gjendet shpesh në mes të qeveritarëve më të zot turq dhe në mes të priftërinjve kalotikë më të devotshëm. Ndihma e dërguar nga Anglia për të mbajtur gjallë ata që Sulltani synoi t'i vdiste nga uria më 1903, u bë e mundur vetëm nga shqiptarët besnikë. Një tjetër anglez, publicisti i mirënjohur Charles Woods e bëri të vetën idenë e Fitzmaurice mbi shqiptarët dhe për krahinat e tyre që i jepet atyre si habitat në rajonet e vendosura përtej, si të thuash në lindje të rrjedhës që ndan pellgun e Adriatikut nga ai i detit Egje".<sup>12</sup>

Antonio Baldacci, dijetari italian që përshkoi Shqipërinë disa herë dhe që e njihte mirë atë në të gjitha elementet, ka skicuar në një broshurë të vogël kufijtë e vendet të banuar nga shqiptarët, të cilat duhej përfshiheshin në kufijtë e shtetit të ri.

Për Shqipërinë Baldacci shprehet me saktësi, për arsye se ai e njihte mirë vendin, po ashtu ishte konsultuar me të gjitha burimet e autorizuara. Kufijtë e shënuar nga ky dijetar i Bolonjës ndryshojnë fare pak nga ato që kemi vendosur më lart, përveçse ai na rikujton çka është thënë në paragrafët e tjera për vendet shqiptare që u janë dhënë Malit të Zi dhe Serbisë më 1888; dhe Greqisë në jug të Shqipërisë. Po shkëpusim paragrafët kryesore të veprës së Baldaccit që flasin për shtetin e ri shqiptar.

"Është një rajon që gëzon bashkim të plotë kombëtar dhe që përfshin pjesën më të madhe të katër vilajeteve turke të Shkodrës, të Janinës, të Kosovës dhe

të Manastirit. Sundimi turk jo vetëm që nuk mundi t'i influencojë në karakteristikat e tij politike, por nuk mundi të frenojë kurrë shpirtin e pavarësisë, qoftë edhe feudale, që mbeti gjithmonë cilësia themelore e popullit shqiptar dhe e mënyrës së jetesës së tij kombëtare. Kjo pjesë e Maqedonisë është një zonë qytetërimi patriarkal dhe në kufirin e saj perëndimor ndodhen shqiptarët. Dhe atje në atë pjesë të Maqedonisë, gjenden njerëzit më të fortë fizikisht dhe etnografikisht më të pastërit nga ana racore e Gadishullit... Shqiptarët përbëjnë racën më të bukur të gadishullit ballkanik".<sup>13</sup>

"Kufijtë politikë absolutë të shtetit të ri do të trajtohen në mënyrë përfundimtare pas paqes, e cila do të lërë gjurmët e saj të dhunshme në marrëveshjet e padrejta të kryera kohët e fundit. Në fakt kjo gjë, nuk duhej të ndodhte më. Kufijtë e saj gjeografikë fare lehtë mund të përputheshin me ata etnografikë, por këta kufij padyshim do të mbeten të ndryshuara në dëm të Shqipërisë nga Fuqitë e Mëdha, siç do të ndodhë me vargmalet që ndajnë drejtimin e lumenjve midis detit Adriatik, Jonit dhe Egjeut deri në pjesën e sipërme të Alpeve. Përtej këtyre vargmaleve, që ndërrojnë drejtimin e lumenjve në relievet e theksuara të pandërprera midis Gramozit, liqeneve dhe Sharrit, tërësia etnografike shqiptare shtrihet e fortë dhe e sigurtë në mes të masave greke, bullgare dhe serbe. Kështu ndodh edhe në veri të Alpeve të Shqipërisë dhe në vetë kufirin e Malit të Zi, që ka nën zotërimin e tij qysh më 1879 mjaft vise të pastra shqiptare: "Në të ashtëquajturën Serbi të Vjetër, kufiri



etnografik shtyhet në mes të këtyre Alpeve shqiptare që përfundojnë harkun e tyre madhështor nga ajo anë dhe malit të Sharrit, duke mbërritur deri sipër Ibarit dhe Sinicës. Këto tentakula që populli i fortë dhe simpatik shqiptar dërgon në çdo kohë drejt armiqve të tyre shekullorë, janë mbrojtja natyrore dhe kombëtare me të cilin mbrohet nga çdo anë, duke zhvilluar dhe mbrojtur të drejtat e tij të shenjta dhe pronat e tij. Pushtimi i territorit shqiptar nga ana e shteteve aleate do të përsëritë prepotencën e përdorur nga ana e Fuqive të Mëdha në dëm të Shqipërisë më 1878 dhe Evropa do të jetë fajtoare, pse ka ushqyer shkakun e mosmarrëveshjes".<sup>14</sup>

Për të përfunduar me ndonjë citim po japim këtu një pasazh të një shkrimtari francez Jaray i cili nuk është një veteran por i ri. Ai ka tashmë autoritetin e një të moshuari, sepse udhëtoi në Shqipëri, ka parë dhe ka prekur, rrëfimi i tij nuk është një varg shënimesh të thata dhe të zverdhura që t'i ngjanë me fletët e ditarit të anijes, por një përlllogaritje e ndërgjegjshme dhe gjithë interes. Ai gjithashtu vë re se elementi shqiptar zë një pjesë të madhe të vilajetit të Manastirit, të Kosovës e deri në qytetin e Shkupit. Ne kemi pasur rastin nga ana jonë që të citojmë më shumë se njëherë pasazhe nga libri i fundit i Gabriel-Luis Jaray-it dhe po i rreshtojmë më poshtë këtu.<sup>15</sup>

"Mali i Bugovës ndodhet në trojet shqiptare; në mes Kërçovës dhe Gostivarit ku ka vetëm një fshat bullgar; të gjitha fshatrat e tjera janë shqiptare; përreth malit unë pashë ndonjë fermë të izoluar, u përshëndeta me disa

njerëz, të gjithë ishin shqiptarë. Ne zbritëm në drejtim të luginës së Gostivarit, monopati ishte i ashpër dhe i frikshëm, por piktoresk, një lumë i vogël që bashkohet me Vardarin rrjedh në Gostivar gurgullon gur më gur, formon ujëvara dhe krijon një freski të këndëshme. Në pemët që mbulojnë rrjedhën e saj që zbret dallohen disa shtëpi të ndërtuar përgjatë përroit; janë shqiptarët që na ofrojnë bujari. Monopati bëhet rrugë që ndjek lumin; tokat e mbjella japin një misër kalli plot dhe grurë me bollëk, i cili ende nuk është korrur; në rrugë ka shqiptarë me të cilët përshëndetemi. Në të dalë të luginës malore të Vardarit dhe të degës së tij të Padalishtës, shquhet Gostivari përmes grupeve me pemë të ndodhur në fushën aluvionale, me 1000 shtëpitë e tij. Që prej pak kohe, ai është bërë një qendër e rëndësishme gati krejtësisht shqiptare; nëntë të dhjetat e popullsisë së tij janë arnautë, pjesa tjetër serbë ka dhe ndonjë turk”.

“Shumllojshmëria e tipave dëshmon shumllojshmërinë e kombësive që banojnë në këtë rajon; por këtu gjithashtu shqiptarët kanë fituar pak nga pak terren, duke marrë fshatra dhe duke fituar shumicën në qytet.

Në Kalkandelen, në 5000 shtëpi, numuroheshin në fillim të luftës 3000 shqiptarë, 1200 serbë dhe 800 bullgarë, nga një klub që u organizua nën emrin Klubi Ndërkombëtar, por ai është bërë, në fakt shqiptar. Sipas regjistrimeve të mësuara këtu, nga 100 fshatrat e Kaimakamlik ose të nënprefekturës të Kalkandelenit, 68 janë shqiptarë, pjesa tjetër bullgarë dhe serbë. Në rajonin e Gostivarit, në 60 fshatra, 40 janë shqiptarë, pjesa tjetër

## Mid'hat Frashëri



Shteti i ri Shqipëtar nga Antonio Baldaci, Rome 1913

bullgare dhe ndonjë serbe".<sup>16</sup>

"Unë kam parë shqiptarë në fushën që shkon nga Shkupi në Mitrovicë dhe nga Mitrovica në Prizren, për fat unë pata rastin që më ra në sy fitorja e shqiptarëve mbi serbët e Serbisë së Vjetër dhe jetën e shqiptarëve në qytete: në Shkup, Prishtinë dhe Mitrovicë ata tani janë më të shumtët; janë zotët e padiskutueshëm në Gjakovë, Prizren dhe Pejë".<sup>17</sup>

"Sipas vëzhguesve të mirë lokalë, Shkupi numëronte rreth 45.000 frymë. Nga ky numër 25.000 mund të vlerësohen si myslimanë, ku gati të gjithë janë shqiptarë, bullgarët në 10.000 ose 15.000, serbët në 3.000 dhe çifutët në 2.000".<sup>18</sup>

"Në se vizitón fshatrat e fushës së Shkupit dhe pyet banorët, do të gjesh të vërteta nga më kuriozet, tamam, për të shkatërruar idetë e krijuara. Ja, përshebull një fshat i krishterë. Aty flitet dialekti shqiptar, popi i tij është ortodoks dhe varet nga eksarku. Në rast se i kërkon njerëzve të këtij fshati se çfarë janë, ata përgjigjen: - ne jemi bullgarë. Ja një fshat tjetër: fshatarët janë myslimanë, gjuha e tyre është sllavo-bullgare, tipi fizik është shqiptar dhe ata thonë se janë shqiptarë".<sup>19</sup>

"Peja është sot veçanërisht qytet shqiptar...<sup>20</sup>, Peja është qyteti i madh shqiptar i veriut... që krijon një qendër të populluar dhe një vendbanim të pasur. Ai është vendqëndrim i bejlerëve më të pasur të veriut, në këtë vend kishin qendrën, apo jetojnë rreth tridhjetë familje fisnike, kryetarë të trashëgueshëm të fiseve të mëdha të brendësisë së vendit".<sup>21</sup>

“Në Gjakovë lidhjet ndërmjet shqiptarëve katolikë dhe shqiptarëve myslimanë janë të shkëlqyeshme... Përsa i takon raporteve me serbë, nuk është nevoja të flitet: në Gjakovë, ndër 3.000 shtëpi që ka qyteti, mezi numërohen një duzinë shtëpi serbësh të varfër dhe asnjë në rrethina. Vendi, pra është i pastër shqiptar”.<sup>22</sup>

“Nga Gjakova në Prizren bën gjashtë orë rrugë. Kjo është një ditë marshimi e ngjeshur dhe, gjatë dy orëve të fundit të udhëtimit tim, kam ndeshur në rrugë të paktën treqind apo katërqind fshatarë, gati të gjithë shqiptarë”.<sup>23</sup>

Ne nuk mund t'i rezistojmë ngasjes që të riprodhojmë këtu disa të dhëna statistikore, të cilat i detyrohen një përfaqësuesi zyrtar të Greqisë, Epaminondas Mavromatis, konsull helenik në Shkodër nga viti 1876-1881. Ai e ka publikuar studimin e tij në gazetën Akropolis të Athinës, nga ku ajo ka qenë dërguar tek Pettermans Mitteilungen, 1884, vol. 30. Mavromatis, i cili nuk mund të ketë asnjë opinion dhe, as të dyshohet si shqiptarofil, thotë që Shqipëria përfshin pesë krahina:

1. Shqipëria e jugut që shtrihet deri në Pargë;
  2. Shqipëria qëndrore, ndërmjet Shkumbinit dhe Matit;
  3. Shqipëria e Epërme, ndërmjet Matit dhe Malit të Zi;
  4. Krahina e veri-lindjes.
  5. Maqedonia Perëndimore.
- Krahina veri-lindore përfshin gjithashtu pjesët e dhëna Serbisë nga traktati i Berlinit si dhe:

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

Vendi	Shqiptarë		Serbë		Bullgarë	
	Muslim.	Krist.	Muslim.	Krist.	Muslim.	Krist.
Prizreni	35.900	1.700	13.000	15.500	-	-
Gjakova	25.000	9.800	-	500	-	-
Peja	20.000	2.200	-	15.000	-	-
Tetova	52.000	-	-	-	2.500	26.000
Luma	32.000	-	-	-	-	-
Prishtina	19.000	-	-	11.000	-	-
Gjilani	22.000	1.300	1.200	21.300	-	-
Vuçiterni	12.000	-	-	5.500	-	-
Mitrovica	6.000	-	-	5.000	-	-
Novi-Pazar	30.000	-	26.000	80.000	-	-
Vranja	23.000	-	-	60.500	-	-
Shkupi	18.000	-	-	-	3.000	31.000
Kumanova	10.500	-	-	-	2.000	29.000

Maqedonia Perëndimore përfshin, sipas autorit grek: Bitolin (Manastirin), Prilepin, Kosturin, Follorinën, Kërçovën, Kolonjën, Korçën, me një popullsi totale prej 220.000 banorësh, prej të cilëve 140.000 myslimanë dhe 80.000 ortodoksë.

Shqipëria gjeografike është e përbërë nga territori që shtrihet prej Malit të Zi në gjirin e Artës, prej Pindi deri në Sharr.

Këtu po krahasojmë disa shifra të gjetura në një vepër anonime mbi Shqipërinë e Veriut<sup>24</sup>:

## Mid'hat Frashëri

Vendi	Nr. i banorëve	Muslimanë	Kristianë
Gjilani	39.545	24.545	15.000
Prishtina	60.993	40.000	20.993
Vuçiterni	24.290	19.636	4.654
Mitrovica	13.690	5.600	8.090
Rrozhaji	10.944	8.436	2.508

**Shënim:** Autori anonim dallon vetëm besimet, çfarë duhet të na kujtojë ne që, në numrin e banorëve të cilësuar si të krishterë, ka një popullsi të rëndësishme shqiptare.

Nuk ka asnjë dyshim se shifrat që dhamë më lart janë me origjinë austriake. Ja dhe një statistikë tjetër të dhënë nga Lipich<sup>25</sup>, kosull i përgjithshëm i monarkisë. Lexuesi është lutur t'i krahasojë këto shifra me ato që ne kemi publikuar më lart dhe të kujtohet se ne i kemi sjellë këto, thjesht si dokument, pa iu dhënë atyre rëndësinë që meritojnë:

Prizreni 45.000 shqiptarë myslimanë; 1.700 shqiptarë katolikë; 15.000 serbë myslimanë; 15.500 serbë të krishterë.

Gjakova 25.000 shqiptarë myslimanë; 9.800 shqiptarë katolikë; 500 serbë kristianë.

Peja 20.000 shqiptarë myslimanë; 15.000 serbë të krishterë.

Gucia 5.000 shqiptarë myslimanë; 2.200 shqiptarë katolikë; 2.500 serbë të krishterë.

Kalkandelen 55.000 shqiptarë myslimanë; 2.500

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

---

bullgarë myslimanë; 26.500 bullgarë të krishterë.

Luma 35.000 shqiptarë myslimanë.

Prishtina 21.000 shqiptarë myslimanë; 11.500 serbë të krishterë.

Gjilani 24.000 shqiptarë myslimanë; 1.300 shqiptarë katolikë; 20.500 serbë të krishterë.

Vuçiterni 13.000 shqiptarë myslimanë; 5.500 serbë të krishterë.

Mitrovica 6.000 shqiptarë myslimanë; 5.000 serbë të krishterë.

Vranja 25.000 shqiptarë myslimanë; 60.000 bullgarë të krishterë.

Leskovci 24.000 shqiptarë myslimanë; 22.000 bullgarë të krishterë.

Prokople 15.000 shqiptarë myslimanë; 9.500 serbë të krishterë.

Kurshumlia 19.000 shqiptarë myslimanë; 1.500 serbë të krishterë.

Shkupi 20.000 shqiptarë myslimanë; 3.000 bullgarë myslimanë; 30.000 bullgarë të krishterë dhe 14.500 turq.

Kumanova 11.000 shqiptarë myslimanë; 2.000 bullgarë myslimanë; 29.000 bullgarë të krishterë.

Dibra e Sipërme 68.000 shqiptarë myslimanë.

Dibra e Poshtme 35.000 shqiptarë myslimanë, 500 shqiptarë katolikë; 500 bullgarë.

Novi-Pazari, Berana dhe Rrozhaj, të bashkuar 30.000 shqiptarë myslimanë; 26.000 serbë myslimanë; 80.000 serbë të krishterë.



## *Mid'hat Frashëri*

---

\* \* \*

Ne po riprodhojmë këtu, edhe njëherë, disa nga korrespondencat diplomatike angleze më interesante lidhur me Shqipërinë, fill mbas luftës ruso-turke të vitit 1878, të cilat i kemi nxjerrë nga Libri Blu i epokës:

Lord E. Fitzmaurice për Earl Granville.  
Konstandinopojë, Maj 26, 1880

*“Për të bërë pyetjen e mësipërme u influencova nga konsideratat e mëposhtme:*

*Shqiptarët, një pjesë e Turqisë, të ardhur në sferën e Komisionit për Rumelinë Lindore, sipas Nenit XXIII të Traktatit të Berlinit. Ky vend i pasqyruar nga një term gjeografik përbëhet kryesisht nga dy Vilajete, ai i Shkodrës dhe i Janinës, por që shtrihet edhe në një drejtim lindor tej derdhjes së ujërave të maleve duke ndarë përrenjtë të cilët derdhen në detin Adriatik që vijjnë nga deti Egje, dhe Kosova. Shtrirja e popullsisë shqiptare në drejtim Veri-Lindor drejt Kosovës dhe Vranjës vërehet në mënyrë të veçantë dhe është e pranueshme plotësisht edhe nga hartat e Kiepert-it, në përgjithësi të konsideruara si të pafavorshme për elementin sllav, dhe të botuara nga Messrs-Stanford në interes të pretendimeve të popullsisë kristiane greke. Përgjithësisht, këtu besohet që lëvizja e fundit e shqiptarëve ka pasur një qëndrueshmëri më të madhe në këtë rajon lindor, se sa në ndonjë rajon tjetër. Gjakova, Peja, Prishtina janë të gjitha qendra me aktivitet, duke qenë komshi jo vetëm me territorin e Malit të Zi,*

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

---

por edhe me atë të Serbisë, kundrejt të dytës, aq sa edhe të parës nga të cilat popullsia shqiptare konsideronte probleme të lidhura me ngjarje të fundit.

Nëse megjithatë, mund të ishte bërë ndonjë përpjekje keqdashëse për të aplikuar për Shqipërinë një rregullore mundësisht të adoptuar për Vilajetet e Selanikut apo Andrinopojës, por jo për të, rezultatet ndoshta do të jepnin një vitalitet akoma më të madh të shqetësimeve në atë rajon. Banorët e vilajetit të Kosovës, me pritjen e një shtrirjeje të rajonit serb në pjesën lindore nga Mitrovica, pretendohet të jenë shqiptarë.

Pozita e vet gjeografike e bën të ardhmen e këtij vilajeti të një rëndësie të pazakontë, meqë është një rajon maJOR, i përshkruar nga pjesë të luginave të Ibarit dhe Moravës, nëpër të cilat disa pjesë të linjave hekurudhore të destinuara për të lidhur kalimin e sistemit hekurudhor të Austro-Hungarisë me Selanikun, Mitrovicën. Kështu unë propozoj, duke u nisur nga aprovimi i Madhërisë së saj Ambasadore, dhe deri sa të marrë drejtime të kundërta nga Lartësia e Juaj, të kalojmë në aplikimin e menjëherëshëm të Rregullores së Vilajetit të Shkodrës dhe Janinës dhe Kosovës apo Prishtinës, duke marrë parasysht që rrethanat në këto zona kërkojnë vëmendje të veçantë”.

Lord E. Fitzmaurice për Earl Granville  
Buyukdere, Korrik 29, 1880

“Gjatë fjalës së tij të 27-të që shkoi, Mr. Green kundërshton idenë e një Shqipërie të Madhe, por bie

*dakort në idenë që Shqipëria Veri-Lindore duhet patjetër të vihet në një Ligj të ri, dhe një Komision Lokal duhet të hartojë një projekt në bazë të nenit XXIII për këtë qëllim. Ai vëren se edhe Shqipëria Qendrore dhe Jugore mund të vihet në operimin e një Statuti menjëherë.*

*M. Aubaret, i cili njihet mjaft mirë me vendin, ka opinione të njëjta, por nuk e sheh të nevojshëm një komision në Shkodër.*

*Unë hezitohj që të jap opinionin tim në kundërshtim me ata që kanë njohje konkrete të zonës, por do të isha më tepër i kënaqur në se kufijtë e vilajeteve të kishin mundësi të ndryshoheshin aq sa të ndanin zonat shqiptare nga pjesa tjetër, dhe t'i bashkonin ato në një, apo nën qeverisjen e një qeverie zonale. Në këtë mënyrë mund të përgatitej një rrugë për Shqipërinë e Madhe, dhe ligji i ri mund të aplikohet në Shqipërinë Veri-Lindore, Qendrore dhe pjesën e poshtme, ndërsa disa parashikime të veçanta do të ishin të nevojshme për Sanxhakun e Shkodrës dhe për pjesën malore në përgjithësi”.*

*Lord E. Fitzmaurice për Earl Granville  
Buyukdere, Qershor 27, 1880.*

*“Dëshiroj që të shtoj disa konsiderata për ato çfarë kam thënë më përpara në favor të vendosjes së Shqipërisë Veri-Lindore nën ligjin e ri, pa asnjë vonesë të mëtejshme. Ne fjalën time të 26 Majit unë shpreha opinionin që i gjithë vilajeti i mëparshëm i Prizrenit, që përfshinte edhe Dibrën, Gjakovën, Pejën, Kosovën, Prizrenin dhe*

Prishtinën ishte një zonë nga vendet sllave që shtriheshin në lindje dhe në jug të tij, ku predominonin muhamedanët dhe shqiptarët si karakter. Duke u nisur nga këto dhe rrethana të tjera, unë theksova rëndësinë e madhe politike dhe sugjerova se në vazhdimësi kjo duhet të trajtohet e ndarë nga Komisioni. Në fjalën time të datës 21 unë informova zotërinë tuaj që zonat e Prizrenit dhe Dibrës janë ndarë nga vilajetet e mësipërm dhe i janë shtuar Manastirit; ndërsa në krahun tjetër Sanxhaku i Shkupit i është shtuar mbetjes së Vilajetit të Prizrenit dhe duke u quajtur së bashku Vilajeti i Kosovës. Në fjalën time të dytë unë hyra në detaje të mëtejshme në lidhje me karakterin shqiptar të Prizrenit dhe vendeve përreth.

Por, kur propozova aplikimin e një ligji të ri për Shqipërinë Veri-Lindore, unë dëshiroj që të shpresoj se Komisioni do të, shoqërojë në të njëjtën kohë propozimin e tyre në fjalë të tilla, si ato të përmendurat në fjalët e mia të mëparshme (shih shtojcën), duke njohur në mënyrë të qartë që zonat e mësipërme formojnë pjesë të Shqipërisë. Unë besoj se në mënyrë ultimative Shqipëria e tërë mund të bashkohet në një Vilajet të madh nën një Guvernator të Përgjithshëm, dhe të ndahet në katër sanxhakë, në: Shqipëri Veri-Lindore, të Sipërme, të Mesme dhe të Poshtme, me disa përjashtime të veçanta për pjesën që jeton në malet veriore dhe në kufirin me Malin e Zi.

Z.. Goschen për Earl Granville  
Therapia, Korrik, 26, 1880.

## *Mid'hat Frashëri*

---

*"Situata është komplikuar nga mënyra se si fati i një pjese të banorëve të territorit Shqiptar që janë në procesin e lëshimit të tokave në territorin e Malit të Zi, gjithashtu acarimi i shkaktuar mes shqiptarëve nga propozimi i lëshimit të tokave të zonës së Janinës dhe të pikave të tjera, të pretenduara nga shqiptarët si të banuara nga njerëz të racës së tyre, në Greqi. Dhe nëse unë kam ngurruar që t'ju drejtohem im Zot, për çështjen kryesore të së ardhmes së territorit shqiptar që do t'i mbesë Turqisë, kjo sepse kam shpresuar që të shikoj pak dritë në përcaktimin e kufijve, që të kisha mundësi që të vlerësoja të gjithë çështjen në tërësi, si në referimin e politikës së përgjithshme, ashtu edhe në kërkesat e veçanta të zonave në fjalë.*

*Sido që të jetë historia e lëvizjes, unë kam frikë që t'ju sugjeroj zotërisë suaj, siç kam bërë më përpara, se acarimi i shqiptarëve nuk mund të kapërcehet duke thënë se ajo është një manovër e vërtetë e udhëhequr nga Turqit me qëllim që të zhgënjente Europën dhe të shmangte dëshirën e saj. Ashtu siç edhe nuk mund të mohohet se lëvizja shqiptare është pikërisht e natyrshme. Shqiptarët duke qenë të lashtë dhe të veçantë si racë, sa edhe të tjerët që i rrethojnë, kanë parë se si kombe të këtyre racave fqinje të jenë marrë nën mbrojtjen e Fuqive të ndryshme Europiane, dhe të favorizohen në aspiratat e tyre për një ekzistencë të pavarur. Ata kanë vënë re se Bullgarët janë emancipuar krejt në Bullgari duke u bërë zotër në Rumelinë Lindore. Ata kanë vënë re dëshirën e zjarrtë të Europës për të çliruar territore të banuara nga*

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

---

grekët nën sundimin turk. Ata kanë vërejtur sllavët e Malit të Zi janë mbrojtur nga Perandoria Sllave e Veriut me një entuziazëm të vendosur. Ata po shohin se si Çështja Lindore po zgjidhet mbi bazën e parimit të kombësisë, dhe se Gadishulli Ballkanik po ndahet gradualisht, ashtu siç ka qenë, në mes shumë racash po me atë princip. Në të njëjtën kohë ata shohin se nuk marrin të njëjtin trajtim. Nacionaliteti i tyre injorohet, dhe territori i banuar nga Shqiptarët i jepet në veri malazezëve, për të kënaqur Malin e Zi, kanakarin e Ruisë, dhe në jug Greqisë, të mbrojturës së Anglisë dhe Francës.

Janë propozuar një numër ndryshimesh të territoreve, por pengesa të reja po dalin, që vazhdojnë t'i kushtojnë shqiptarëve, dhe shqiptarët janë ata që duhet t'u dorëzohen sllavëve dhe grekëve pa iu referuar principit të nacionalizimit.

Unë jam duke u shtruar mjaft fort çështjen e shqiptarëve, me qëllim që të ilustroj karakterin e natyrshëm të rezistencës së tyre ndaj dëshirës së Europës. Mua nuk më duket që të jetë një qëndrim artificial, apo edhe i fajshëm. Kjo është një rrjedhojë e natyrshme e lëvizjes së përgjithshme të Gadishullit Ballkanik.

Konsiderata analoge më çojnë mua në përfundimin, që me modesti guxoj t'ju paraqes Zotërisë Suaj, se kombësia shqiptare është një element që nuk duhet të neglizhohet në kombinacionet politike të së ardhmes. Në të kundërt, unë besoj që kjo duhet të shihet me një përparësi më të madhe për interesin e përgjithshëm, dhe, gjithashtu, do të kundërshtoja çdo masë të pjesshme që

## *Mid'hat Frashëri*

do të kishte për qëllim të pengonte formimin e një Province të madhe shqiptare.

Nëse është e parakohshme apo e pamundur për të ndërtuar një provincë të tillë tani, unë do të abstenoja për çdo lloj mase që do ta bënte të përhershme pamundshmërinë, apo që të paktën do të shkaktonte vështirësi për të ardhmen. Unë do të rekomandoja që formimi i një Province të bashkuar shqiptare, duhet, të paktën, të kihet gjithmonë parasysh.

Zotëria e juaj do të shikonit menjëherë se përparësitë e mëposhtme do të mund të ishin të siguruara, nëse do të ishte formuar një Shqipëri e fuqishme, dhe justifikimi për pushtimin e saj nga një fuqi e huaj në rastin e shthurjes së Perandorisë Otomane do të dobësohej mjaft.

Një Shqipëri e bashkuar do të ishte pengesë për ndërhyrjet e mëtejshme nga veriu, dhe Gadishulli Ballkanik do të mbeste në duart dhe kontrollin e racave që banojnë aty. Në të kundërt, shqiptarët do të ishin një pengesë e pakalueshme në kohën kur shqetësimet të rriteshin. Një popullsi, me shumicë myslimane, do të ishte burimi i vështirësive të mëdha për vendet sllave apo greke përreth. Dhe një fuqi europiane e vetme do të ishte mjaft e fortë për t'u marrë me to dhe për të mbajtur rregullin. Unë mendoj se, në raport me stabilizimin e nacionalitetit Shqiptar, mundësia e një ndërhyrjeje europiane në Gadishullin e Ballkanit do të zvogëlohej".

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

- 1) Shih "Roma e l'Oriente", Badia di Grotta Ferrata (province de Rome), nr. 26, f.100: "A lui si deve la conversione del Patriarca Atanasio di Ocrida nella Macedonia albanese avvenuta nel 1659".  
Id., p.103: "E la sede metropolitana di Ocrida in Macedonia che in vari documenti romani di quel secolo vien detto di Epiro, perché abitata da Albanesi ossia Epiroti".
- 2) "L'Ottomano" nga Lazaro Soranzo, Ferrara, 1598, f.100, paragrafi 89. Ja teksti: "Bullgarët, disa banojnë në te gjithë atë vend, që quhet Mëzia e poshtme gjer në Danub, takohet me Vllahinë, disa në Traki bashkë me Grekët, dhe të tjerë në Maqedoni, tashmë ende e banuar nga grekë, serbë dhe shqiptarë".
- 3) Tekstualisht: Dukagjinët banojnë në malin Sharr në kufi me Preseremo (Prizreni aktual) Parreopoli apo Prenopoli i quajtur kështu, që ndodhet në Dardani në kufijtë e Shqipërisë, e banuar më shumë nga shqiptarë se serbë.
- 4) Der neue eröffneten Pforten (it.), aus Ricaut, Donado, Foscarini, Berengano, etc., übersetzt. Augspurg 1701, gjejmë disa paragrafë që na duken jo pa rëndësi. në faqen 62, duke folur për princin Karl Filip.
- 5) Die serbische Dynastie Crnojevic, von Franz Miklosich, Wien 1886, f. 29.
- 6) Trésor de chronologie, Paris, 1889, colonne 1783.
- 7) La Zedda e la dinastia dei Balsidi (it), nga profesor XHuzepe Gelshiq, Split, 1889, f.18.
- 8) La Turquie d'Europe (it), Ami Boué, Paris 1840, 4 vol.; vol. II, f. 13.
- 9) Jena 1854.
- 10) Vienne 1868.
- 11) Macedonia ist races and their future (it) H.N. Brailsford, London 1906, faqe 271.
- 12) Shih "La Turquie et ses voisins", f. 83.
- 13) Il nuovo stato di Albania (it.), nga Antonio Baldacci; estratto



## *Mid'hat Frashëri*

---

- della "Rivista Militare Italiana", Roma 1913, f.4.
- 14) *Id. po aty*, f. 18.
  - 15) *Au jeune royaume d'Albanie (it.)*, ce qu'il a été, ce qu'il est. Paris, 1914, f. 170-171.
  - 16) *Au jeune royaume d'Albanie (it.)*, ce qu'il été, ce qu'il est. Paris, 1914, f. 80.
  - 17) *Gabriel-Loiu Jaray, L'Albanie inconue (it.)*, Paris 1913, f. XXI.
  - 18) *Id. po aty*, f.9. Më lart f. XIV (hyrje) ai ka thënë: "Shkupi është në të njëjtën kohë një nga qytetet e avancuara dhe një nga metropolet e tyre (shqiptarëve)".
  - 19) *Po aty*, f. 10.
  - 20) *Po aty*, f. 52.
  - 21) *Po aty*, f. 56.
  - 22) *Gabriel-Louis Jaray, "L'Albanie inconnue"*, f. 71, Paris 1913.
  - 23) *Po aty*, f. 73.
  - 24) "Novi-Bazar und Kossovo" Wien 1892, f. 11.
  - 25) Raportuar nga Karl Saksi në studimin e tij "Erlauterung zu der Ethnographische Karte der Europe. Türkei", botuar në *Mitteilungen der K.K. Geogr. Gesellschaft in Wien. Bd. XXI*, 1878, f. 177-183. Më poshtë po riprodhojmë hartën e C.Sax.

## IV

**M**ë mirë se pazazhet e nxjerra nga autorë të huaj, janë hartat e tyre që na vënë në dijeni dhe na japin tregues më të saktë. Hartat etnografike mbi Turqinë Europiane nuk mungojnë; ka shumë prej tyre dhe mund të bëhet një vepër shumë interesante duke i përmbledhur të gjitha.


Kjo do të ishte gjithashtu zhgënjuese, për shkak të kontradiktave, hileve që do të binin në sy, sepse grekët dhe sllavët kanë rivalëzuar me zell të ekzagjeruar njëri me tjetrin, duke vizatuar letrat e tyre pafajshme shumëngjyrëshe, me këto "brumëra të ngjyrave nacionale që bëjnë një njollë vaji", siç thotë me shumë humor një udhëtar në Turqi.<sup>1</sup>

Ne zgjodhëm pra, vetëm disa prej tyre, ato që ne na duken më pak të njollosurat nga gabimet (ose nga hilet), jo sepse ato janë të favorshme ndaj elementit shqiptar, por pikërisht sepse ato gjithashtu vënë në lojë besimin e sllavëve.<sup>2</sup>

### **Harta etnografike e Lëzhanit**

Harta që po riprodhojmë përbri ka qenë publikuar më 1861 tek "Les Petermanns Mitteilungen" të Gotha-s,

# Mid'hat Frashëri



Harta e Lëzhanit

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

---

me shënime në frëngjisht dhe në gjermanisht. Ne nuk mund të akuzojmë autorin se është armik i shqiptarëve, sepse në një relacion të vogël të një udhëtimi të shkurtër që ai ka bërë në Shkodër dhe që ai e ka publikuar në "Tour du monde" (tremujori i parë, f. 68-87) ai flet me simpati për këtë racë. Në këtë hartë nuk ka patur, pra, veçse, gabime të thjeshta dhe, ja më kryesoret:

1. Ai nuk i sheh shqiptarët që shkojnë deri në Manastir dhe Shkup;

2. Vë një njollë shumë kompakte dhe homogjene për serbët ndërmjet Prizrenit dhe Pejës.

Por gjithashtu ne tërheqim vëmendjen e lexuesit në atë që sipas Lëzhanit:

1. E gjithë "Serbia e Vjetër" deri në Novi-Pazar, Leskocv dhe pranë Vranjës, është tokë shqiptare;

2. Janë gjithashtu shqiptarë banorët e vjetër të Ulqinit dhe të Tivarit;

3. Gjithashtu edhe lugina Moraça (në veri-lindje të liqenit të Shkodrës);

4. Gjithë Epiri.

## **Harta etnografike e F.Mirkoviçit**

Kjo hartë është bërë në Moskë në vitin 1867. Ajo duhet të jetë një kopje e asaj të mëparshmes, me disa ndryshime të lehta.

Këtu përsëri autori rus, një pansllavist i deklaruar, sepse harta është punuar me qëllim që të bëjë të njohur



botën sllave<sup>3</sup>, nuk i ka shënuar shqiptarët që shtrihen nga Ohri në Manastir, as ata prej Manastirit në Shkup dhe Vranjë.

Nga ana tjetër ai i shënon shqiptarët në jug dhe në lindje të Kosturit.

Megjithatë ai vë një njollë pak të shtrirë të serbëve ndërmjet Pejës dhe Prizrenit, duke njohur në këtë mënyrë që e gjithë fusha e Kosovës deri krejt pranë Nishit, Leskovcit dhe Vranjës, si dhe bregu i Adriatikut deri në veri të Tivarit, luginës së Moravës dhe Moraçës janë krahina gati tërësisht të banuara prej shqiptarësh.

## **Harta e Bradaskës**

Ne e kemi parë këtë hartë si një nga më të mirat që janë bërë dhe, vetë autori duke qenë sllav, nuk mund të dyshohet që të ketë punuar në favorin e shqiptarëve.

Tërheqim vëmendjen e lexuesit:


1. Në viset ndërmjet Prishtinës, Gjakovës dhe Prizrenit, të paraqitura prej vijave shqiptare e sllave dhe, që autori i tregon si të banuara prej shqiptarëve dhe serbëve.

2. Shqiptarët shkojnë drejt Malit të Zi deri në Tivar dhe gati në luginën e Moraçës.

3. Nga ana e Serbisë, gati deri në Moravë.

4. Rrethet e Kumanovës, Shkupit, Velezhit

# Mid'hat Frashëri



Harta e Bradaskës

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

(Kyprilit), Manastirit, Follorinës, janë në më të shumtën të treguara si të banuara prej shqiptarësh.

Kjo hartë e ka parë dritën e botimit tek "Petermanns's Mitteilungen" 1869, dhe shoqëron artikullin "Die Slaven in der Türkei".

## **Harta etnografike e H.Kiepert**

Kjo është një hartë e shtypur në Berlin në maj 1876.

Një shikim i thjeshtë mjafton për të vënë re që hartografi dhe udhëtari gjerman ka korrigjuar harresat e paraardhësve të tij, përsa i takon Manastirit dhe Shkupit.


Vija të forta shqiptare janë shënuar atje, ndonëse njollat sllave janë bërë me dashamirësi të bollshme. Kjo njollë bullgare ndërmjet Ohrit dhe Manastirit na duket e zhvendosur, në një krähinë që është zënë nga mali Peristeri, përreth të cilit, janë grupuar mjaft fshatra vllahe dhe jo pak fshatra shqiptare.

Megjithatë mund të thuhet se Kieperti krijon një territor shqiptar me vilajetet e Shkodrës, Shkupit dhe Manastirit si dhe gati, gjatë gjithë vijës rrethuese të liqenit të Shkodrës.

Përsa i përket jugut bën gjithashtu gabime; dhe kjo lidhur me pasionin e tij për Greqinë që e bën t'i marrë për helenë himariotët dhe e pengon t'i shohë shqiptarët të shkojnë deri në Prevezë.



# Mid'hat Frashëri



Harta e H.Kiepert

## **Harta etnografike e Carl Sax**

Sipas thënies së vetë bullgarëve, Saksi ishte personi më kompetent për të bërë një hartë etnografike të Turqisë Europiane, duke qenë gjatë shtatëmbëdhjetë vjetëve në qytete të ndryshme si konsull i Austro-Hungarisë.

Harta që po riprodhojmë përkundruall është publikuar në vitin 1877 në buletin e Shoqërisë Perandorake dhe Mbretërore të gjeografisë, në Vienë.

Etnografia e Shqipërisë është trajtuar më mirë këtu, pa marrë nën mbrojtje megjithatë gabimet e mundshme. Tivari, Podgorica dhe Plava, mbi kufirin malazez, janë treguar si vende të banuara prej sllavësh. Janë lënë mënjanë gjithashtu fshatrat shqiptare përreth Shkupit. Por Manastiri dhe Janina si dhe gjithë bregu i detit Adriatik, janë trajtuar mirë në këtë hartë.

Përfundimisht, kjo hartë bën me katër vilajetet e Janinës, Shkodrës, Shkupit dhe Manastirit një vend tërësisht shqiptar, me një popullsi shqiptare kompakte, gjë e cila nuk është as për Maqedoninë, as për Bullgarinë, as për Rumelinë lindore, dhe as për bregun e detit Egje.



## **Harta e “Komitetit Shqiptar” të Londrës, 1912-1913.**

Komiteti Shqiptar i Londrës ka qenë krijuar nën kryesinë e Aubrey Herbert, anëtar i Parlamentit, me bashkëpunimin e personaliteteve politikë, njerëzve të kishës dhe të publicistëve.

Po riprodhojmë këtu hartën që ky komitet ka publikuar më 1913, në një fletëpalosje të titulluar “The Plea of Albania”, të shtypur në Londër, në atelietë Mc Corquodale & Co.

Për ta kuptuar më mirë këtë hartë duhet lexuar edhe njëherë citimet e autorëve të huaj që kemi bërë më sipër dhe studjuar mirë hartat e ndryshme etnografike paraardhëse të kësaj.



## Harta e Constatin Noe.

Harta në vijim i është aneksuar veprës "Les Roumains Koutzovalaques", nga Constatin Noe, Bukuresht 1913. Ky është një libër i destinuar për propogandën rumune, gjë e cila shpjegohet me njollat e gjëra vllahë në fushën e Myzeqesë.

Përveç kësaj, autori harron të ngjyrosë me ngjyrat shqiptare:


1. Ulqinin, Tivarin dhe rrethin në jug të Moraçës.
2. Viset ndërmjet Loskovcit dhe Vranjës.

Por vihen mjaft mirë në dukje:

1. Shqiptarët e Shkupit, Manastirit dhe Kosturit;
2. Që shqiptarët së bashku me Kucovllahët (rumunë) formojnë shumicën në Manastir.



# Mid'hat Frashëri



## Harta etnografike e Maqedonisë nga Kençov

Më mirë se të gjitha hartat e tjera etnografike së bashku, është kjo këtu, pasi na jep nocione më ekzakte mbi krahinat lindore të Shqipërisë, sepse duke qenë një hartë e bërë nga një bullgar, ajo nuk mund të quhet kurrë e njëanshme, prej nga sllavëve të Ballkanit. Harta të cilën po e paraqesim në vazhdim është riprodhuar prej asaj që shoqëron librin "Makedonija, etnografia i statistika" nga Vasil Kençov, Sofje 1900. Autori deri në njëfarë pike, ka pasur çiltërsinë të shënojë fshatrat shqiptare që ndodhen në fushën e Manastirit dhe përreth Shkupit. Megjithatë ky sinqeritet nuk shkon deri tek e vërteta absolute. Autori ka bërë kujdes të ngjyrosë sfondin me ngjyra bullgare dhe të vendosë një pikë atje ku ka një fshat shqiptar ose vllah.


Mirëpo, siç e kemi vënë në dukje më lart, toka në këto vise, gati tërësisht iu përket shqiptarëve. Do të duhej, pra të ngjyroset i gjithë sfondi me ngjyrën e shqiptarëve dhe fshatrat bullgarë të shënohen vetëm si pika të thjeshta.

Kjo dredhi që në vështrim të parë e shtrembëron të vërtetën, nuk është i vetmi gabim i hartës së Kençovit. Ai harron të shënojë shumë fshatra shqiptare, bile dhe qytete: si p.sh. Follorinën (Lerina në origjinal), e cila numëron një shumicë shqiptare, as Manastirin, popullsia



Mid'hat Frashëri

CARTE ETHNOGRAPHIQUE  
DE LA  
MACÉDOINE  
d'après Vasil Kăncov  
Sofia 1900.



e të cilit në një pjesë të rëndësishme të saj është shqiptare. Fshatrat e Magarovës, Tërnovës, në lindje të Manastirit, janë ngjyrosur me ngjyrat vllahe, në një kohë kur popullsia e këtyre dy fshatrave, tregon për atë që është vllahe, është dygjuhëshe, që flet shqipen po aq mirë sa dhe vllahishten; si burrat ashtu edhe gratë.

Por përveç vllahëve dygjuhësh, ka gjithashtu shqiptarë të krishterë, të dalluar mirë nga të parët; në Tërnov ka përveç tyre edhe shqiptarë myslimanë si dhe në Nizopoli (Xhinxhopol).

E gjithë kjo është neglizhuar nga Kençovi, i cili pak më në veri, në fshatin Bratindol, nuk sheh më asnjë shqiptar. Janë harruar gjithashtu shqiptarët e qytetit Krushovo, ndërmjet Kërçovës dhe Kyprilis, siç kanë harruar të shënojnë pesë fshatrat shqiptarë në perëndim të këtij qyteti të fundit, dhe sa të tjerëve të shpërndarë në fushën ndërmjet Manastirit dhe Prelepit dhe Manastirit e Follorinës.

Ne nuk dëshirojmë të shtrihemi shumë mbi gabimet lidhur me trevat e Kërçovës (Kiçevo në hartë) që kemi folur më lart, të gjithë atyre fshatrave shqiptarë që statistika e institutit hartografik të Sofjes, i ka lënë mënjanë.

Tetova na duket relativisht e trajtuar më mirë dhe lexuesi do të shohë që ky qytet, të cilin autori gabimisht e shënon si turk, është rrethuar nga një popullsi shqiptare mjaft kompakte.

Por qyteti i Shkupit, jo vetëm është shoqëruar me një njollë të fortë turke, por është patur kujdes të izolohej nga një rryp i gjerë sllav, prej pjesës së popullsisë

## *Mid'hat Frashëri*

---

shqiptare që e mbështjell. Mirëpo është një bullgar, një nga shkrimtarët propogandistë modernë më të palodhur, Jordan Ivanovi, i cili na thotë që "Shkupi është i rrethuar nga të gjitha anët nga fshatra shqiptarë: në Cerna Gora (Karadak), Marko Reka".<sup>4</sup>

Pak më poshtë ai vazhdon:

"Podrimja e Dibrës është krejtësisht shqiptare, si dhe gjysma e Pollogut të sipërm dhe të poshtëm".

I njëjti autor, një faqe më lart, thotë që Mali i Zi (Karadak) i Shkupit, sidomos, në pjesët veriore dhe lindore të tij, është krejtësisht shqiptar (tekstualisht: Skopskata Crnagora, osobeno severo iztotchnija i del e tsel albanski).

\* \* \*

Shqiptarët shënohen përreth Shkupit edhe në hartën e dijetarit serb Cvijiç, që ai e ka publikuar në vitin 1913.<sup>5</sup> Cvijiçi, si dijetar, duke mos qenë edhe aq i paanshëm, shkencën e tij e vë në shërbim të politikës.

Ai jo vetëm që nuk i do aspak shqiptarët, por preferon më mirë t'i quajë ata "serbë të shqiptarizuar". Megjithatë ai nuk mund të bëjë gjithmonë sikur nuk i sheh shqiptarët dhe shpesh i vendos paqëndrueshmëri me keqardhjen e madhe të tij. Kështu në një vepër tjetër mbi një hartë politike dhe etnografike,<sup>6</sup> ai vendos një njollë të madhe shqiptare ndërmjet Shkupit dhe Tetovës (Kalkandelen) si dhe ndërmjet Shkupit dhe Vranjës, përgjatë hekurudhës që lidh këto dy qytete.

## *Shqiptarë dhe Sllavë*

---

- 1) *Souvenirs des Balkans*, nga Réne Millet, Paris, 1891, f. 127.
- 2) Gati të gjitha këto harta kanë qenë riprodhuar gjithashtu në librin e D. Rizov, "Bullgarët në kufijtë e tyre historikë, etnografikë dhe politikë", Berlin 1917.
- 3) Titulli i saj është: *Etnografitcheskàja Karta Slavijanskich Narodnostei* (hartë etnografike e kombeve sllave).
- 4) J.Jordanov, "Blgarite v'Makedonija", f. LXIII.
- 5) *Die ethnographische Abgrenzung der Völker auf der Balkanhalbinsel*, par Cvijici, *Petermans Mitteilungen*, f. 113-118, 185-189, 244-246, me një hartë të bukur me tendeca panserbe.
- 6) Kjo hartë shihet në faqen 48 të vol. I të veprës "Osnove za gheografija i gheologhija Makedonije i Stara Serbije (në serbisht), Beograd 1906.

**SHTËPIA BOTUESE "LUMO SKËNDO"**  
**FALENDERON**  
**ZOTIN AJET RUSHITI NGA KËRÇOVA,**  
**AKTUALISHT ME BANIM NË**  
**SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS,**  
**QË MUNDËSOI RIBOTIMIN E KËTIJ LIBRI.**

**A**mund të merret me mend, që Shqipëria e kufizuar nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës më 1913, të jetë një Shqipëri e shëndoshë dhe solide? Asaj i janë privuar tokat më të mira që kishte, fushat më të bukura, qendrat më të rëndësishme dhe i janë shkëputur dy të tretat e popullsisë. Tokat pjellore të Janinës dhe të Prevezës, kullotat e famshme të Çamërisë iu dhanë Greqisë, Shkupit; ndërsa rrafshi i bukur i Kosovës është ndarë ndërmjet serbëve dhe malazëzve, për t'i lënë Shqipërisë një zonë malore gati të shkretë, të privuar nga mjetet e komunikacionit, dhe të bllokuar nga bora gjashtë muajt e vitit.

450L